

Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.365 | Shkurt 2022 | Xhumadël Ahir - Rexheb 1443 | Çmimi 50 den



Kryetari i BFI-së në Kajro:

ISLAMI ËSHTË FE QË I BASHKON NJERËZIT



تحت رعاية

السيد الرئيس / عبد الفتاح السيسي رئيس الجمهورية

المؤتمر العام الثاني والستون

عقد المواطنة وأثره في بقاء السلام المجتمعي العالمي

مختار جوهري



جمهورية مصر العربية
وزارة الأوقاف
المجلس الأعلى للشئون الإسلامية



URIME PËR FILLIMIN E TRE MUAJVE

Kam kënaqësinë dhe nderin që të gjithë opinionist islam, besimtarëve në vend dhe më gjerë, t'u uroj natën e parë të muajit Rexheb, që është më 1 shkurt, 2022. Dita e nesërme (2 shkurt, e mërkurë) është dita e parë që shënon fillimin e Tre Muajve të Shenjtë: Rexheb, Sha'ban dhe Ramadan.

Qofshin të bekuara netët dhe ditët e këtyre muajve dhe le të jenë një ngritje e lartë e besimtarëve drejt formimit të personalitetit të pastër dhe të shëndoshë, për të qenë sa më afër kënaqësisë së Allahut fuqplotë dhe me këtë, në shërbim më të madh të paqes, të mirëqenies, të lutjeve, të faljes dhe të ngritjes shpirtërore.

Paçim bekimin e Allahut fuqplotë.

Reisul Ulema i BFI në RMV, h. hfz.

Shaqir ef. Fetahu

(1.02.2022)



PREJ TREGIMEVE MË TË BUKURA ISLAME



Një grua franceze e merr djalin e saj 14-vjeçar dhe e dërgon te Qendra Islame për të hyrë në Islam.

Kur arritën te Qendra, djaloshi hyri tek Imami i Qendrës dhe i tha atij: "Nëna ime ju thotë juve 'më ndihmoni mua, që të hyj në Islam'."

Imami e pyeti: "E ti, a dëshiron të hysh në Islam?"

Ai tha: "Unë nuk kam menduar për këtë, por nëna ime është ajo e cila dëshiron që unë të hyj në të."

Imami u habit nga përgjigja e tij dhe i tha: "E, nëna jote, a është muslimane?"

Djaloshi ia ktheu: "Jo, dhe nuk e di përse dëshiron që unë të hyj në Islam!"

Imami i tha: "Ku është nëna jote?"

Ai tha: "Ajo është me mua tani, jashtë xhamisë."

Imami i tha: "Shko thirrë të vijë këtu, që të flas me të." Djaloshi doli dhe u kthye me nënën e vet.

Imami i tha asaj: "A është e vërtetë ajo që e dëgjova nga djali juaj, se ju nuk jeni muslimane dhe kërkonin prej tij që të hyjë në Islam?"

Ajo tha: "Po, kjo është e vërtetë."

Imami u habit nga përgjigja e saj dhe e pyeti: "Atëherë, përse?"

Ajo tha: "Sepse, unë jetoj në një ndërtesë në Paris dhe në banesën para tonës jeton një grua muslimane dhe ajo ka dy djem, të cilët studiojnë në Universitet, dhe i shoh këta dy djem çdo mëngjes e mbrëmje. Kur dalin dhe kthehen në shtëpi, nënës së tyre ia puthin kokën dhe duart dhe sillen ndaj saj me respekt të madh, sikur ajo është kryetare e shtetit. Andaj, dëshiroj që djali im të hyjë në Islam, që kur të plakem, mos të më hedhë në shtëpinë e pleqve dhe të kujdeset për mua shteti, por të silltet me mua si sille muslimani me nënën e vet..."

Sa e bukur është feja jonë, Islami!

Veprat tua i ftojnë njerëzit në Islam, ose i largojnë prej Islamit!

Përktheu nga gjuha arabe: Muhamed Sadiku

FESTAT ISLAME GJATË VITIT 2022 = 1443/44H

Lejletul-Regaib, 02/03 Rexheb 1443 = 03/04.02.2022
Lejletul-Miraxh, 26/27 Rexheb 1443 = 27/28.02.2022
Lejletul-Berat, 14/15 Shaban 1443 = 17/18.03.2022
Fillimi i Agjërimit, 1 Ramazan 1443 = 02.04.2022
Nata e Kadrit, 26/27 Ramazan 1443 = 27/28.04.2022
Dita e parë e F. Bajramit, 1 Sheval 1443 = 02.05.2022
Dita e Parë e K. Bajramit, 10 Dhulhixhe 1443 = 09.07.2022
Viti i Ri i Hixhretit, 1 Muharrem 1444 = 30.07.2022
Dita e Ashureve, 10 Muharrem 1444 = 08.08.2022
Mevludi, 11/12 Rebiul Evvel 1444 = 07/08.10.2022

2022=1443/44 HICRI YILI BAYRAMLARI

Regaib Kandili, 02/03 Rexheb 1443 = 03/04.02.2022
Mirac Kandili, 26/27 Rexheb 1443 = 27/28.02.2022
Berat Kandili, 14/15 Shaban 1443 = 17/18.03.2022
Ramazanin Başlangıcı, 1 Ramazan 1443 = 02.04.2022
Kadir Gecesi, 26/27 Ramazan 1443 = 27/28.04.2022
Fitir (Ramazan) Bayramı, 1 Sheval 1443 = 02.05.2022
Kurban Bayramı, 10 Zulhixhe 1443 = 09.07.2022
Hicri Yılbaşı, 1 Muharrem 1444 = 30.07.2022
Aşure günü, 10 Muharrem 1444 = 08.08.2022
Mevlid Kandili, 11/12 Rebiul Evvel 1444 = 07/08.10.2022

ИСЛАМСКИ ПРАЗНИЦИ ВО 2022 = 1443/44 X

Лејлетул Регаб, 02/03 Рехеб 1443 = 03/04.02.2022
Лејлетул Мирац, 26/27 Рехеб 1443 = 27/28.02.2022
Лејлетул Берат, 14/15 Шабан 1443 = 17/18.03.2022
Почеток на Постот, 1 Рамазан 1443 = 02.04.2022
Ноќта на Кадер, 26/27 Рамазан 1443 = 27/28.04.2022
Фитер Бајрам, 1 Шеввал 1443 = 02.05.2022
Курбан Бајрам, 10 Зулхиџе 1443 = 09.07.2022
Нова Хиџретска година, 1 Мухарем 1444 = 30.07.2022
Ашура, 10 Мухарем 1444 = 08.08.2022
Мевлуд, 11/12 Ребиул-Еввел 1444 = 07/08.10.2022



Shoqata e ulemave "Ilmije" e BFI të RMV paraqet festat islame për vitin 2022 (1443/44 H) në gjuhën shqipe, turke dhe maqedonase.

EDITORIAL

RRUGËTIM DEVOTSHMËRIE DREJT RAMAZANIT...

Në këto ditë të fundit të muajit Rexheb përjetuam madhësinë dhe mrekullin e Natës së Miraxhit, e cila është njëra nga katër netët e mira dhe të zgjedhura në të cilat myslimanët i shtojnë ibadetet dhe veprat e mira të tyre, duke e përkujtuar udhëtimin e të dërguarit të Allahut (xh. sh.) nga Mesxhidi Haram (Meka) në Mesxhidi Aksa (Jerusalem), që njihet me emrin Isra, e prej atje, pastaj, ngritjen e tij për në qiej, për te prania e Allahut (xh. sh.), e cila njihet me emrin Miraxh.

Për rëndësinë e kësaj nate flet edhe Kurani fisnik, ku Allahu (xh. sh.) na tregon ndodhin e kësaj nate, duke thënë: **"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës nga Mesxhidi Haram (Qabe) deri në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjues (i fjalëve të Muhamedit), pamës (i punëve të Muhamedit)."**

Tanimë para nesh është muaji Shaban, i cili është pararendës i muajit Ramazan. Rrugëtimi ynë i devotshmërisë vazhdon edhe gjatë ditëve dhe netëve të këtij muaj të bekuar, duke shfrytëzuar nga rasti për të përfituar shpërblime të mëdha si dhuratë nga Allahu (xh. sh.) për veprat e mira të bëra gjatë këtij muaji.

Ky muaj, në dallim nga muajt tjerë, karakterizohet me dy ngjarje të mëdha dhe të rëndësishme. E para është **Nata e Beratit**, e cila bie në natën e 15-të të muajit Shaban (17 mars, 2022) dhe e cila na paralajmëron ardhjen e shpejtë të muajit Ramazan, muajit tonë më të dashur, kështu që sa më mirë duhet të përgatitemi shpirtërisht dhe fizikisht për agjërim dhe për ibadete të tjera. Se çfarë nate është dhe çfarë rëndësie ka kjo natë, këtë më së miri na e përshkruajnë hadithet e Muhamedit (a. s.): **"Në natën e pesëmbëdhjetë të muajit Shaban të gjitha veprat nxirren përpara Zotit të Gjithësisë; për këtë arsye, unë dëshiroj që veprat e mia të nxirren para Tij deri sa unë jam duke agjëruar."**

Karakteristika e dytë është ndërimi i Kibles së myslimanëve prej Mesxhidi Aksasë në Jerusalem, në drejtim të Qabesë në Mekë, që është një ngjarje shumë e rëndësishme. Lidhur me këtë ja se çka i thotë Allahu (xh. sh.) Muhamedit (a. s.): **"Ne, shumë herë po e shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli e Ne gjithëqysh do të të drejtojmë ty në drejtim të një Kibleje (Qabesë) që ti e do atë. Pra, kthehu drejt anës së xhamisë së shenjtë (Qabesë) dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni kah ajo anë. E, atyre që u është dhuruar libri, ata e dinë sigurisht se kjo (kthesë) është e vërtetë nga Zoti i tyre. E, Allahut nuk mund t'i fshihet ajo që veprojnë ata."** (El-Bekare: 144)

Mësuesi ynë, i dërguari i Allahut, e madhëronte këtë muaj me shtimin e adhurimeve dhe veprimeve të mira, si: agjërim dhe forma të tjera të adhurimeve. Duhet theksuar se më së shumti që agjëronte Pejgamberi (a. s.) ishte në muajin Shaban, respektivisht e agjëronte shumicën e këtij muaji. Agjërimin gjatë këtij muaji ai e shoqëronte me shtim të ibadetit, e veçanërisht me namaz nafile gjatë natës.

Në një hadith të transmetuar nga Aisheja (r. a.) thuhet: **"Pejgamberin (a. s.) nuk e kam parë që ka agjëruar ndonjë muaj të plotë, përveç Ramazanit, e as nuk e kam parë Pejgamberin (a. s.) se ka agjëruar ndonjë muaj më shumë se sa në muajin Shaban."**

Duke pasur parasysh veprimet e Pejgamberit (a. s.), në muajin Shaban përjetim për besimtarët është të rritin vëllimin e punëve të mira, duke lexuar Kuran, duke shpërndarë lëmoshë dhe sadaka, duke u solidarizuar me të varfrit dhe njerëzit në nevojë, me qëllim që edhe ata të ndihmohen për pritjen e muajit të Ramazanit.

Përpjekjet e çdo besimtari për ta ngritur nivelin e devotshmërisë personale dhe për të arritur kënaqësinë e Krijuesit tonë gjithësesi do të shtohen edhe gjatë muajit Shaban, si një rrugëtim devotshmërie drejt muajit të madh, muajit të Ramazanit.

Q. Osmani



KRYETARI I BFI-së FLET PËR TOLERANCËN ISLAME NË KAJRO



Më 11 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, udhëtoi për në Kajro të Egjiptit, për të marrë pjesë në Konferencën e përgjithshme të Këshillit të Lartë për Çështje Fetare Islame nga data 12 deri më 13 shkurt, organizuar nga Ministria për Çështje Fetare Islame të Egjiptit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Sot, i shoqëruar nga h. Ismet ef. Ademi, Drejtor për Marrëdhënie me Botën Arabe, arritëm në Aeroportin e Kajros, ku u pritëm nga nikoqirët e Ministrisë për Çështje Fetare, në krye me Shejh EsSeid Abdumexhid, i autorizuar i Ministrisë dr. Muhamed Xhum'a, dhe pas një pushimi të shkurtër u vendosëm në hotel”, ka shkruar Kryetari i BFI-së në faqen e vet në Facebook më 11 shkurt.

Sipas protokollit, thuhet më tej në njoftim, namazi i xhumasë u krye në Xhaminë e Muhamed Ali Pashës, ku hytben dhe fjalimin i kreu dr. Muhamed Xhum'a, Ministër për Çështje Fetare Islame të Egjiptit, i cili edhe na udhëhoqi në namazin e xhumasë. Pastaj, nën udhëheqjen e Ministrisë vizitua Kalanë e Muhamed Ali Pashës, si dhe Muzeun, që përfshinte të gjitha epokat historike dhe civilizimet e Egjiptit - prej epokës së faraonëve, epokës romake, islame, osmane e deri në kohën e sotme.



Më ra në sy, ka nënvizuar Reis'ul-Ulemaja, periudha e vendosjes së bazave të reformave të Egjiptit të ri në kohën e sundimit të Muhamed Ali Pashës dhe pasardhësve të tij, të njohur si shqiptarë, familja e të cilit udhëhoqi Egjiptin me dekada në mënyrën më të mirë dhe, si i tillë, e ka marrë emrin 'Reformator i Egjiptit'.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 13 shkurt, të dielën, në Seançën e shtatë, pati pararaqitjen e tij në Konferencën ndërkombëtare të Kajros. Tema e kumtesës së tij ishte me titull "Toleranca në Islam, dëshmi e fuqisë dhe jo e dobësisë", thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Dy ditët e Konferencës kaluan në një nivel të lartë, me tema të ndryshme nga e gjithë bota, duke iu qasur nga të gjitha aspektet temës boshit 'Kontrata e atdhetarisë dhe ndikimi i saj në vërtetimin e sigurisë shoqërore dhe botërore'. Në Konferencë kishte pjesëmarrës nga e gjithë bota islame, të cilët me një kapacitet të lartë shkencor shqyrtuan aspekte të ndryshme të temës, si dhe çështje aktuale që kanë të bëjnë me rrjedhat e përgjithshme”, ka shkruar në Facebook Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu pas paraqitjes së kumtesës në Konferencën e Kajros.

TAKIM ME DY MINISTRA



Me Përfaqësuesin e Ministrisë së Vakëfit të Egjiptit, Shejh Seid Abdumexhid, gjatë pritjes në Aeroportin e Kajros, në shkuarje në Konferencë.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të premten, më 11 shkurt, 2022, u takua me Ministrin për Çështje Fetare të Egjiptit dr. Muhamed Xhum'a, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë këtij takimi Reis'ul-Ulemaja u njoftua me mënyrën dhe praktikën që i aplikojnë Qeveria e Egjiptit në menaxhimin dhe organizimin e jetës fetare në vend. Po ashtu, edhe Reis'ul-Ulemaja pati mundësinë që ta njoftojë Ministrin për Çështje Fetare të Egjiptit me funksionimin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe me organizimin e jetës fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ata këmbyen eksperiencën të përbashkët

dhe ndërruan mendime rreth çështjeve të ndryshme fetare, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë qëndrimit në Kajro, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i shoqëruar nga Drejtori për Marrëdhënie me Botën Arabe, h. Ismet ef. Ademi, më 12 shkurt realizoi një takim zyrtar me Shkëlqesinë e tij, Ministrin e Vakëfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, dr. Abdul-Latif Bin Abdul Aziz Al Shejh, në Rezidencën e tij të përkohshme në kryeqytetin e Egjiptit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ishte një takim i këndshëm, gjatë të cilit Reis'ul-Ulemaja e njoftoi Ministrin me punën e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, si dhe me bashkëpunimin e saj me

institucionet e ndryshme të Arabisë Saudite në përgjithësi. Reis'ul-Ulemaja e falënderoi Shkëlqesinë e Tij për konkluzionet e miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Mbretërisë së Arabisë Saudite për bashkëpunimin e mirëfilltë dhe institucional me BFI-në dhe institucionet e saj.

Interesimi i Ministrisë së Vakëfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, dr. Abdul-Latif Bin Abdul Aziz Al Shejh, ishte që të ketë bashkëpunim të ngushtë me BFI-në dhe këtë e vërtetoi edhe me vendimin se shumë shpejt do ta vizitonte Bashkësinë Fetare Islame të RMV, ku do të bisedohet për bashkëpunimin tonë në të ardhmen. Në fjalën e tij ai i dha rëndësi të veçantë kultivimit të vlerave fetare islame, me qëllim të vendosjes së paqes, të solidaritetit dhe afritit mes njerëzve dhe popujve kudo në botë, duke theksuar se këto janë edhe qëllimet kryesore të tij. Kjo mundëson evitimin e radikalizmit dhe të ekstremizmit ndër popuj, tha ai.

Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, Kreu i BFI-së, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i dhuroi nikoqirit të tij emblemën e BFI të RMV, ndërsa Ministri i nderuar i dhuroi Reis'ul-Ulemaja publikimin e ri të Kuranit famëlartë, botim ky i bërë në një standard të lartë, dhuratë prej Mbretit Salman bin Abdulaziz Al Saud.

Kryetari i BFI-së e falënderoi Ministrin e nderuar për këtë takim kaq të rëndësishëm dhe kohën që ndau për ta takuar delegacionin nga Maqedonia e Veriut, thuhet në njoftimin e BFI-së.



Kajro: Takim zyrtar i Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me Ministrin e Vakëfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, dr. Abdul-Latif Bin Abdul Aziz Al Shejh.

ME DIPLOMATËT DHE STUDENTËT SHQIPTARË

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 12 shkurt, 2022, bashkë me h. Ismet ef. Ademin, Drejtor i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe, në orët e pasdites u takua me diplomatët shqiptarë në Kajro: z. Eduard Sulo, Ambasador i Republikës së Shqipërisë; dr. Beqir Ismaili, Ambasador i Republikës së Kosovës dhe z. Enis Xhemaili, Konsull i Lartë në Ambasadën e Republikës së Kosovës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Një takim vëllazëror dhe i këndshëm me Ambasadorët shqiptarë në Kajro. Kaluam një mbrëmje të bukur, ku biseduam për shumë çështje, në veçanti për kohën e artë të Egjiptit gjatë udhëheqjes së Muhamed Ali Pashës, me kombësi shqiptare, i cili njihet si reformator i madh i Egjiptit dhe themelues i Egjiptit modern. Njëherësh, biseduam me kuriozitet për Dinastinë Shqiptare, e cila me dekada udhëhoqi Egjiptin, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e këtij vendi. Mbetëm të kënaqur me vizitën e Ambasadorëve tanë dhe këtë e konsideruam si një respekt të veçantë. Zoti i bekoftë”, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe h. Ismet ef. Ademi, një ditë më parë, më 11 shkurt, patën mundësinë që të realizojnë një takim të këndshëm me studentët e Unionit të Studentëve Shqip-



E ardhmja e bartjes së amanetit të Islamit u takon gjeneratave të reja - u tha Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu studentëve shqiptarë të Universitetit të Ez'herit në takimin që pati me ta më 11 shkurt, 2022.

tarë të Ez'herit në Kajro, të cilët u bënë një pritje shumë të ngrohtë dhe emocionale, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Përshtypjet nga ky takim ishin se studentët tanë janë të lumtur që mësojnë në Universitetin e famshëm të Ez'herit dhe se maksimalisht bëjnë përpjekje që të jenë të zellshëm në sjelljen e tyre dhe me vetëdije të lartë të punojnë në studime. U bisedua gjerë e gjatë për punën që bën Bashkësia Fetare Islame me të gjithë faktorët e saj dhe për të gjithë studentët si në vend, po ashtu edhe jashtë vendit, në veçanti ndaj studentëve të Ez'herit.

Në këtë rast, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i porosi studentët: “E ardhmja e bartjes së amanetit të Islamit u takon gjeneratave të reja. Pra, kërkohet që ata të profesionalizohen në mënyrën më të mirë.”

Nga ana e tyre, studentët shprehën vullnetin që të jenë sa më afër BFI të RMV dhe thanë se do ta vizitojnë në mënyrë të organizuar institucionin fetar islam – BFI të RMV.

Reis'ul-Ulemaja po ashtu u premtoi studentëve se BFI do të interesohet maksimalisht për studentët kudo që i ka në botë, në veçanti për ata që kanë nevojë. Ai u shpreh se është i kënaqur dhe shumë i lumtur që studentët tanë kanë formuar edhe Unionin e tyre, që tregon për vetëdijen e tyre të lartë për një organizim sa më të mirë gjatë studimeve.

Gjatë bisedës u hodh edhe ideja për të bërë një studim mbi ‘Ez'herin’, për të analizuar historikun e studentëve dhe numrin e tyre nga Maqedonia e Veriut deri në kohën e sotme, si dhe të gjurmojnë traditën e personalitetëve të shquara nga Ballkani, që është një thesar i madh i popullit tonë, e këtë me kënaqësi do ta realizojnë përfaqësuesit e Unionit të Studentëve të Ez'herit: Amir Sinani, Miran Alija, Ardit Mahmudi, Ensar Çajani, Burim Amdiu dhe Arifton Zeqiri.

I bëjmë lutje Allahut Fuqiplotë që studentëve t'u japë shëndet dhe suksese në jetë, thuhet në njoftimin e BFI-së.



Me përfaqësuesit diplomatikë shqiptarë në Kajro.

TOLERANCA NË ISLAM, DËSHMI E FUQISË DHE JO E DOBËSISË

Nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve, i cili na nderoi me Islamit dhe na nderoi duke na bërë prej atyre që përfaqëson vlerat e tij të larta të bukura.

Paqja dhe përshëndetjet qofshin mbi zotriun tonë Muhamedin (a. s.), i cili na mësoi mënyrën e saktë se si t'i zbatojmë këto vlera dhe virtyte, që përfaqësojnë llojet më të larta dhe më të mira të qytetërimit dhe civilizimit, dhe mbi familjen dhe shokët e tij dhe ata që e ndoqën atë në mënyrën më të mirë dhe i futën mësimet e tij të tolerancës në zemrat e njerëzve.

Zoti thotë në Kuran: **“O njerëz, në të vërtetë, Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”** (El-Huxhurat: 12)

I dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) thotë: **“Allahu ka shkruar bamirësi mbi të gjitha gjërat.”**

I nderuar Ministër i Vakëve, dr. Muhamed Muhtar Xhuma;

Të respektuar dijetarë të botës islame dhe ju të pranishëm;

Jam i nderuar që jam sot mes jush, në këtë konferencë shumë të vlefshme dhe të rëndësishme. Me këtë rast, përshëndes organizatorët dhe ju dëshiroj punë të mbarë në të dhe në aktivitetet shoqëruese të saj.

Islami, të nderuar të pranishëm, siç e dihet, është fe e tolerancës, e dashurisë dhe e paqes. Zoti i ka thirrur robtë e tij në tolerancë në shumë ajete në librin e Tij të shenjtë dhe feja jonë e pastër bën thirrje për falje me të mirë, për falje kur ke fuqi për ndëshkim, për sjellje të mirë dhe



ruajtje të të drejtave të të tjerëve. Thotë Allahu i lartësuar: **“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë dhe atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë miku yt i ngushtë.”** (Fusilet: 34)

I Dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) na nxiti në tolerancë dhe në falje. Edhe biografia e tij është plot falje dhe tolerancë. Islami e bëri faljen dhe përmbajtjen nga bërja keq ndaj të tjerëve moral të lartë islam. E ka urdhë-

ruar Allahu të dërguarin e Tij (a. s.) të thërriste për përlulësi, për mirësi dhe ulje të krahut. Dhe kjo, jo vetëm me njeriun, por edhe me kafshët, siç thuhet në hadith: **“Zoti shkroi bamirësi mbi të gjitha gjërat.”**

Përveç që është fe e tolerancës, Islami është gjithashtu edhe fe e krenarisë, e drejtësisë dhe e ndershmërisë. Thotë Allahu i lartësuar në Kuran: **“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kun-**

PËR PAQE NË VEND DHE NË BOTË

Nga Ismet ef. Ademi

Mbi një qind përfaqësues të shteteve me popullsi myslimane më 12 dhe 13 shkurt, 2022, u mbledhën në Kajro të Egjiptit në një konferencë të nivelit të lartë botëror, organizuar nga Ministria e Vakëfit e Egjiptit, në krye me Ministrin dr. Muhamed Muhtar Xhum'ah.

Tema bosht e Konferencës titullohej "Kontrata e atdhetarisë, shtyllë e paqes në shoqëri dhe në botë".

Pa dyshim, kjo konferencë dëshmoi vlerën e saj për nga forma, për nga përmbajtja dhe për nga kuptimi i saj. Ishte një organizim i nivelit të lartë si për nga pritja, po ashtu edhe për nga rregullia dhe organizimi. Organizimin e përshkonte një frymë e buzëqeshjes, e respektit, e fisnikërisë dhe e ambientit që thaujse nuk i mungonte asgjë. Gjithçka ishte e kompletuar për të ndier rehati për paraqitje para qindra udhëheqësve dhe dijetarëve me renome botërore.

Tema bosht u zhvillua me një hapje solemne nën udhëheqjen e Ministrisë për Çështje Fetare, dr. Muhamed Muhtar Xhum'ah, i cili me kënaqësinë më të madhe përshëndeti mysafirët e niveleve të larta, duke iu dëshiruar mirëseardhje



Burimi: <https://www.almasryalyoum.com/news/details/2523762>

dhe në mënyrë të thuktë dhe racionale shpjegoi synimet e mbajtjes së kësaj konference, me qëllim që të diskutohet ajo që është më e nevojshme sot në kohën bashkëkohore, jo vetëm në botën myslimane, por në tërë globin. Ai potencoi se takimet e këtilla janë të domosdoshme kudo në botë, e në veçanti në Egjipt, me qëllim të konsultimit për t'i dhënë kahe paqes në rajon dhe në botë në përgjithësi.

Edhe bota islame, u tha, duhet të marrë pjesë me qëndrimet e veta fetare dhe të tregojë se Islami është fe e paqes, e tolerancës, e bashkëjetesës dhe e solidaritetit botëror, sepse këtë e kemi edhe obligim moral-njerëzor, kështu që si pjesëtarë të Islamit bashkërisht duhet të japim kontributin, duke shkëmbyer përvojat me vende të ndryshme të botës.

Në fjalimet e tyre morën pjesë dijetarë të mëdhenj të botës, duke filluar nga Egjipti, Arabia Saudite, Pakistani, Algjeria, Kameruni, EBA, SHBA, Evropa, Ballkani, Indonezia, Malajzia, Xhibuti, Kazakistani, Azerbajxhani, Rusia, Greqia, Bosnjë e Hercegovina, RMV etj.

Gjatë dy ditëve u zhvilluan plot 10 seanca, me kumtesa të ndryshme. Pas paraqitjes së kumtesave, diskutimeve dhe debateve konstruktive, me rëndësi për temën bosht, mund të konkludojmë se të

gjitha rrotulloheshin rreth këtyre vlerave me sa vijon:

1. Islami është realitet i botës dhe si i tillë është i gatshëm të japë kontributin e tij në sfera të ndryshme të zhvillimit njerëzor kudo në botë;

2. Islami është fe e besimit të vërtetë dhe burimor dhe si i tillë jep definimin e plotë të njëshmërisë së Allahut Fuqiptotë, duke qenë udhëzimit të tërë botës në përgjithësi;

3. Islami obligon dhe është në shërbim të kultivimit të paqes, të tolerancës, të mirëkuptimit, të bashkëjetesës, të humanizimit të shkencës, të kulturës, të artit dhe të dialogut ndërfaqësor;

4. Radikalizmi, ekstremizmi dhe terrorizmi janë dukuritë më të shëmtuara, që i pjellin grupet e ndryshme në botë, të devijuara nga interesa të ndryshëm individualë dhe gruporë, andaj ato nuk kanë aspak lidhje me parimet e shenjta të Islamit dhe me moralin e pastër islam dhe, si të tillë, duhen evituar dhe luftuar me të gjitha mjetet shkencore, shpirtërore dhe fizike;

5. Organizimi i konferencave në mbarë botën, si në mes të myslimanëve, po ashtu edhe me konfesionet tjera, është domosdoshmëri e kohës, me qëllim të njoftimit me vlerat e besimeve të ndryshme, si dhe me traditat e popujve të botës, me qëllim të afrimit në mes vete.

6. Konfliktet, luftërat, gjenocidet, diskriminimi etj. janë rezultat i interesave politike, ekonomike dhe aspak nuk kanë të bëjnë me besimet e pastra e as me besimtarët e pastër në botë, sepse të gjitha ato (besime) ftojnë në paqe e tolerancë, në mirëkuptim e në bashkëjetesë, në afrim me njëri-tjetrin etj.

Në fund, u krijua një përshtypje se pjesëmarrja në konferencën ndërkombëtare është një nevojë e domosdoshme, sepse kjo mundëson njohjen me personalitetet e njohura të sferës fetare dhe kulturore, si dhe me rrjedhat islame në kohën bashkëkohore në përgjithësi.

(Autori është Drejtor për Marrëdhënie me Botën Arabe në Rijasetin e BFI të RMV)

dër jush për shkak të fesë dhe nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët." (Al Mumtehane: 8)

Allahu urdhëroi të jemi të drejtë me jomyslimanët paqësorë dhe nga kjo bëhet e qartë toleranca. Islami është një fe që i bashkon njerëzit, jo fe e shkatërrimit dhe e rrënimit, siç bëjnë disa nën emrin e Islamit. Islami është vërtetues i asaj që thuhet në hadithe: "Kush privohet nga dhembshuria, privohet nga mirësia" dhe: "Dhembshuria nuk është në diçka, përveç se e rëndon peshoren e vet; dhe se, nuk nxirret nga diçka, përveç se e shëmtton atë" – madje, edhe në polemikë me kundërshtarin.

Kjo është feja e Zotit, të nderuar pjesëmarrës; kjo është feja e tolerancës, edhe nëse kriminelët e urrejnë atë - fe të cilën disa përpiqen ta shtrembërojnë, por që është shumë larg, se Zoti është mbrojtësi më i mirë i fesë së tij.

PËRKUFIZIMI TERMINOLOGJIK I TOLERANCËS: Toleranca në aspektin terminologjik është: tejkalim dhe falje, e cila është një nga shtyllat e marrëdhënieve njerëzore islame. Thotë Allahu: "... pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, Allahu i do bamirësit." (El-Maide: 13)

Kjo do të thotë, gjithashtu, tolerancë ndaj të tjerëve, në marrëdhënie të ndryshme, që është për t'i lehtësuar gjërat dhe për të qenë me sjellje të mirë, të cilat do të vijnë në shprehje në lehtësimet ndaj tyre dhe jo të ketë shtypje.

SHFAQJET E TOLERANCËS NË MËSIMET E ISLAMIT ME JOMYSLIMANËT: Njerëzimi nuk njih një fe që është më e gjerë në tolerancë dhe më përfshirëse në mirëkuptim me të tjerët nga Islami. Edhe i Dërguari i Zotit na dha shembujt më të mirë të tolerancës: duke jetuar me pjesëtarët e feve të tjera, duke i siguruar ata në besimet, adhurimet, tempujt, ritualet dhe kryqëzimet e tyre dhe i ka lënë ata të lirë t'i praktikojnë ritualet e tyre, pa siklet apo shqetësim.

Allahu i ka urdhëruar myslimanët të bashkëjetojnë me njerëzit e feve të tjera, që të bashkëjetojnë paqësisht me ta, duke u sjellë mirë dhe me përkëdheli. Siç thotë në Kuran: "Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët." (El-Mumtehane: 8)

Islami i ka fshirë injorancën dhe ta-

butë dhe falsitetet e tij, duke përfshirë edhe fanatizmin etnik apo rajonal; qoftë për shkak të ngjyrës së bardhë apo të zezë të personit, apo për shkak se ai është arab apo joarab; apo se kjo është nga Lindja, apo nga Perëndimi. Islami e ka bërë të qartë se nuk ka dallim midis një arabi dhe një joarabi, përveç se në devotshmëri dhe të gjithë ata janë të barabartë si dhembët e krehrit. Ka thënë i Dërguari (a. s.): "O ju popull, zoti juaj është një, e babai juaj është një; nuk ka kurrfarë privilegji për arabin mbi joarabin, as për joarabin mbi arabin; as të të kuqit mbi të ziun, as të të ziut mbi të kuqin, përveç se në devotshmëri".

Islami e ka lejuar të hash ushqimin e ithtarëve të Librit dhe të martohesh me gratë e tyre. Thotë Zoti në Kuran: "Sot ju janë lejuar gjërat e mira e të pastra. Ju janë lejuar edhe ushqimet e ithtarëve të Librit; po ashtu edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ata. Të lejuara për ju janë femrat e ndershme besimtare dhe femrat e ndershme të atyre që iu është dhënë Libri para jush, nëse ju u jepni pajën e kurorëzimit duke u martuar me ato e jo duke bërë kurvëri, as duke i marë për dashnore. Kushdo që mohon besimin, veprat e tij, do të zhvlerësohet dhe në jetën tjetër ai do të jetë i dështuar." (El-Maide: 5)

ARGUMENTI PËR FUQINË: Prandaj, është e gabuar të besosh se toleranca është provë e dobësisë së pronarit të saj dhe e impotencës së tij, por më tepër një ngritje për pronarin e saj dhe krenari për popullin e tij. Siç thuhet në hadith: "Nuk është i fortë ai që ngutet, por ai që e mban veten gjatë hidhërimit." Edhe në hadithin: "Zoti nuk ia rriti njeriut krenarinë, përveç se me falje."

Ja shembulli i Jakubit (a. s.), kur fëmijët e vet kërkuan prej tij që t'i falte dhe të kërkonte falje për ta: nuk bëri dua kundër tyre, as shfaqti dhunë ose ndëshkim ndaj tyre, por ai i trajtoi ata me amnistie dhe falje të bukur.

Nga që, toleranca ka të bëjë me bashkimin e njerëzve para se të vijë në shprehje interesi personal. Nuk mund të arrihet bashkimi dhe tubimi që ka urdhëruar Allahu pa zbatuar dhe ndjekur shkaqet e bashkimit. Dhe, njëra nga arsyt më të mëdha është toleranca. Toleranca gjithashtu është virtyt i personaliteteve të mëdha. Ajo është sjellje e njerëzve besnikë, metodologji e njerëzve me karakter të lartë. Këto ne duhet t'i përkthejmë në realitetet e jetës sonë të përditshme, të kuptojmë qëllimin e saj fetar, përkatësisht harmoninë dhe kohezionin, dhe të jemi si

një strukturë e cila na e rrit forcën dhe stabilitetin - qoftë psikologjik, apo atë shoqëror, social. (...)

Ky parim islam është rrënja që do të na mbrojë nga ata që me ambicie kërkojnë shkatërrimin dhe bëjnë kërdrinë në tokë. Një shoqëri tolerante e pranon tjetërën dhe i bashkon duart me të për të ndërtuar dhe për të dhënë; ajo beson se Allahu i Plotfuqishëm i urdhëroi njerëzit që të njihen, e jo të bien ndesh me njëri-tjetrin. Siç thotë i Plotfuqishmi: "O ju njerëz, vërtet ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete; s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat); Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." (El-Huxhurat: 13)

Kështu, rezulton që toleranca është rruga e të fuqishmëve dhe jo përzgjedhje e të dobtëve. Ata janë të fortë me falje dhe nuk u ngushtohen kraharorët duke pranuar tjetrin, kundërshtarin.

Dhe, meqë jemi në kontekstin e tolerancës në Islam, theksojmë rëndësinë e përhapjes së Islamit të vërtetë te të tjerët, duke treguar madhësinë e kësaj feje në tolerancë dhe nxitjen e saj për vlera të larta etike duke afirmuar parimin e paqes, duke refuzuar urrejtjen, diskriminimin dhe terrorizimin e njerëzve dhe duke shkaktuar humbjen e të drejtave të tyre. E gjithë kjo është në kundërshtim me tolerancën e Islamit dhe origjinën dhe qëllimet e tij. "Në këtë ka përkujtim për ata që mendojnë."

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut kontribuon shumë dhe është e kujdesshme në përhapjen e këtyre vlerave të larta islame, duke marrë pjesë gjithmonë në takime të rregullta midis përfaqësuesve të të gjitha Bashkësive Fetare në Republikën e Maqedonisë, si inicuese e shumë projekteve të përbashkëta për të zhvilluar bashkëjetesën midis pjesëtarëve të bashkësive fetare dhe kulturave të ndryshme. Për më tepër, institucionet arsimore të BFI-së kontribuojnë në kultivimin e këtyre vlerave fetare në të gjitha nivelet e shkollimit.

Në fund, unë ju falënderoj që patët durimin dhe më dëgjuat dhe i lutem Zotit që t'ju bekojë dhe të shpërblejë organizatorin me shpërblimin më të mirë.

(Kumtesë e paraqitur në Konferencën e përgjithshme të Këshillit të Lartë për Çështje Fetare Islame të Egjiptit në Kajro nga data 12 deri më 13 shkurt të vitit 2022)

MUAJT E SHENJTË, MESAZH PAQEJE PËR NJERËZIMIN

**“O Zoti ynë! Na beko në muajt Rexheb e Sha’ban dhe na mundëso ta arrijmë muajin Ramazan.”
(Hadith)**



Shkruan:
Prof. dr. Abdylxhemil Nesimi

Nga mirësitë e Zotit të Madhërishtëm ndaj robërve të Tij, është se për ta zgjedh stinë të të mirave dhe bekimeve, në të cilat i shumëfishon veprat e mira dhe i shlyen të këqijat, siç thotë i Lartësuar: “dhe përkujtoju atyre të mirat e Allahut (që u dhuroi), se vërtet në ato (përkujtime) ka argumente për secilin që është shumë i durueshëm dhe shumë falënderues.” (Ibrahim: 5)

Pejgamberi ynë, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, thotë: “Vërtet, Zoti juaj sjell momente gëzimi gjatë jetës suaj. Kështu që, ekspozohuni ndaj tyre; ndoshta ndonjëri prej jush do të merrte ndonjë mirësi prej saj, pas së cilës ai kurrë nuk do të brengoset.”

Sipas kalendarit islam, që si pikënisje

ka hixhretin e profetit Muhamed (a. s.), muajt Rexheb, Shaban dhe Ramazan janë muajt shumë të dobishëm dhe të bekuar, madje, në shoqërinë islame këta muajt njihen edhe si Tre Muajt.

VLERA E MUAJVE TË SHENJTË

Nga këto stinë besimi janë muajt e shenjtë, të cilët Zoti i Plotfuqishëm i përmendi në përgjithësi në thënien e Tij: “Te Allahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e Allahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë. Kjo është fe e drejtë. Pra, mos e ngarkoni (me mëkat) veten tuaj në ata (katër muajt)!” (Et-Tevbe: 36)

Ndërkaq, Pejgamberi (a. s.) duke i komentuar muajt e shenjtë të përmendur në Kuran, thotë: “Sigurisht që koha rrjedh

ashtu si e ka krijuar Allahu i Lartësuar që nga dita e parë. Viti ka dymbëdhjetë muajt. Katër prej tyre janë të shenjtë, tre prej të cilëve vijjnë njëri pas tjetrit. Ata janë: Dhu’l-Ka’deh, Dhu’l-Hixhxheh, Muharrem dhe muaji Rexheb, që vjen ndërmjet muajve Xhumadije’l-Ahir dhe Sha’ban, e që është muaji i fisit Mudar.” (Buhariu, Tefsir, suret 8, 9)

Nisur nga kjo, komentuesi i Kuranit, Abdullah bin Abas (r. a.) në interpretimin e thënies së Plotfuqishmit: “Fe la tedhlimu fihin-ne enfusekum - mos bëni padrejtësi ndaj vetes tuaj në ata (katër muajt)”, thotë: “Padrejtësia në të gjithë muajt është e ndaluar, mirëpo i veçoi katër muajt dhe i bëri të ndaluar dhe madhështoi shenjtërimin e tyre. Madje, mëkatin në to e bëri më të madh, kurse veprën e mirë e shpërbleu me shpërblim më të madh.”

Nga e tërë kjo mund të konstatojmë se padrejtësia që është përmendur në ajet, ka dy shpjegime: një, mos i bëni padrejtësi vetvetes duke i konsideruar këta muajt si muajt ku s’ka ndalesa, dhe së dyti, duke mëkatuar gjatë këtyre muajve.

Duhet të kemi në konsideratë se Allahu i Lartësuar kur e madhëron një gjë, duhet kuptuar se ajo ka rëndësi të veçantë, e nëse e madhëron në disa forma - pa dyshim se kjo gjë peshon edhe më shumë. Përkundrazi, dënimi i veprave të këqija shumëfishohet në këta muajt, ashtu sikurse shumëfishohet shpërblimi i veprave të mira. Ai që e respekton Allahun në muajin e shenjtë, në vend të shenjtë, në shtëpinë e shenjtë, nuk është i barabartë me atë që e adhuron në muajt tjetër, apo në vend tjetër.

I dërguari i Zotit në këta muajt të bekuar bënte ibadet më shumë se çdo muajt tjetër dhe ia bashkëngjiste këtë lutje: “O Zoti ynë! Na beko në muajin Rexheb e Sha’ban dhe na mundëso ta arrijmë muajin Ramazan!”

OBJEKTIVI KRYESOR I ISLAMIT

Nga provat bindëse që tregojnë madhësinë e Islamit, është se në çdo kohë dhe në çdo vend, madje, brenda periudhës dymbëdhjetë muajshe, qofshin ata hënor apo diellor, e ndaloi padrejtësinë.

I Madhërueshmi fillimisht padrejtësinë ia ndaloi vetes së Tij, me qëllim që njeriu t’i shmanget asaj, që mos të bëjë në këtë interval kohor mëkate dhe vepra të këqija. Megjithëse, mëkati është e keqe dhe e ligë në çdo kohë për vepruesin e saj, meqë është në kundërshtim me Madhërinë e Zotit. Mirëpo, në muajt e shenjtë fatkeqësia është më e madhe, sepse e kombinon veprimin kundër Zotit të Plotfuqishëm dhe mosrespektimin e asaj që i Madhëruari e lartësoi.

Katër muajt e shenjtë që i përmend Kurani, edhe në kohën paraislame janë respektuar si të shenjtë dhe në ta ka qenë ndaluar lufta, bastisja e plaçkitja dhe secili e ka ndjerë veten në rreth të sigurt. Me ardhjen e Islamit, nderi e respekti ndaj tyre vazhdoi akoma. Vallë, a nuk është e denjë për ata që i përkasin Islamit që të angazhohen dhe t’i madhërojnë këta muajt, kur dimë se moto e Islamit është paqja?! Nëse njerëzit në kohën pagane ulnin armët për hir të muajve të shenjtë, atëherë, çka me njerëzit e kohës moderne?! Nuk i japin rol arsyes që të ulin tensionet, urrejtjen, luftërat vëllavrasëse; më së paku këtë ta bëjnë për hir të muajve, vendeve dhe ditëve të shenjta. Madje,

jemi dëshmitarë ku nëpër ekrane, rrjete sociale shpërndahen propaganda luftënxitëse, urrejtje, racizëm, islamofobi, duke u përpjekur ta prezantojnë Islamit si vrasës, gjakatar, fe e terrorizmit etj. Megjithatë, muajt e shenjtë i demantojnë akuzat që padrejtësisht i vishen Islamit. Në fakt, atë që Islami e ka miratuar si mjet për sigurimin e paqes dhe të stabilitetit, e kanë paraqitur si element apo mjet të prishjes së paqes në botë.

Islami nuk ka ardhur për të shuar jetë, por për të mbrojtur jetën. Miratimin e luftës e ka bërë mjet për të ruajtur stabilitetin politik, ekonomik dhe shoqëror, për të ndihmuar të shtypurit, për të përcuar mesazhin e Allahut te njerëzit.

Muajt e shenjtë kanë shenjtëri dhe status të veçantë të Zotit i Lartësuar. U quajtën të shenjtë (el-hurum), për shkak të madhësisë së shenjtërisë së tyre. Për këtë arsye, Sheriati e ndalon luftën në to, dhe shkelja e shenjtërisë është ndalesa më e rëndë, siç thotë Madhështia e Tij: “Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: ‘Luftimi në atë kohë është gjynah i madh.’” (El Bekare: 217)

Muajt e shenjtë bartin mesazh paqeje për mbarë njerëzimin, se Islami është fe e paqes. Një nga emrat e bukur të Zotit të Madhëruar është “Selam”: “HuvAlluhuledhi la i lahe il-la huve, el-Melik, el-Kud-dus, es-Selam” – “Ai është Allahu, pos të Cilit nuk ka zot tjetër; Sunduesi, i Shenjti, i Pastrit (prej të metave që i vishen); Siguruesi.” (El-Hashër: 23)

Një nga lutjet e Pejgamberit tonë finisnik pas çdo namazi ishte: “O Zot, ti je paqja dhe prej teje është paqja; je i bekuar, o zotëruar i Madhërisë dhe i Nderit.”

Islami nuk është i etur për të luftuar apo për të derdhur gjak; përkundrazi, ai heq dorë prej tij për sa kohë që gjen një mënyrë për ta bërë këtë, dhe anon drejt paqes dhe e thekson atë: “Në qoftë se ata anojnë kah paqja, ano edhe ti kah ajo, e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di.” (El Enfal: 61)

Islami nuk ka ardhur për të shtypur njerëzit, por për t’i ndihmuar të shtypurit. Në këtë kontekst i dërguari i Allahut ka thënë: “Si do ta shenjtërojnë (pastrojë) Allahu një popull, në të cilin nuk ndihmohet i dobëti (i shtypuri) ndaj të fortit (të padrejtit)?!”

Është e vërtetë se në muajt e shenjtë promovohet një lloj lufte e cila është përherë në fokus të Islamit - ajo është lufta kundër vetes (nefsit), smirës, xhelozisë, dhunës, urrejtjes, hakmarrjes; lufta kundër së keqes; është lufta kundër nënshtrimit ndaj neftsit, ku pushtetin e neftsit ndaj

njeriut Allahu Fuqiptotë e quan dhunë. “Prandaj, mos i bëni vetes dëm, duke i shkelur këta muajt!”

Pra, të bësh mëkate është padrejtësi ndaj vetes, është poshtërim i vetvetes, është sikur ta hedhësh veten në greminë me duart tua. Andaj, nga këta muajt duhet të mësojmë se mëkatet janë neveritëse, nga të cilat duhet larguar.

MUAJI REXHEB

Muaji Rexheb është muaji i shtatë sipas kalendarit hixhrij. Është një nga muajt e shenjtë (Muharrem, Dhul Hixhah, Dhul Qi’da dhe Rexheb). Pozita e tij është e madhe të Zotit i Lartësuar, pasi e bëri një nga katër muajt e shenjtë, të cilin Fuqiptoti e veçoi me potencim në Librin e Tij. Ndryshe, muajt Rexheb cilësohet si muaji i mbjelljes, muaji Shaban si muaji i ujitjes, kurse muaji i Ramazanit si muaji i korjes apo i mbledhjes së prodhimeve. Njeriu korr çka mbjell; merr barasvlerën e asaj që ka bërë.

Rexheb në gjuhën shqipe do të thotë i Madhëruar. Ndryshe quhet “mudir”, sepse fisi Mudir e respektonte dhe e nderonte shumë këtë muajt. Arabët nuk e ndryshonin dhe nuk e zëvendësonin këtë muajt me të tjerë, siç vepronin me muajt tjerë të shenjtë. Gjatë këtij muaji nuk dëgjohej tingulli i armëve, prandaj e quanin “el-esem - i shurdhët”.

Është detyrë e myslimanit që ta njohë vlerën e këtij muaji të shenjtë, sepse njohja dhe lavdërimi i tij janë nga feja e drejtë në të cilën nuk ka shtrembërim, as ka mashtrim e as devijim. Duhet të kemi kujdes nga mëkatet në të, sepse mëkati në të nuk është njëjtë si mëkati në muajt tjerë. Përkundrazi, mëkati në të është shumë më i madh, meqë vlera e tij është shumë e madhe; siç ka thënë i Plotfuqishmi: “Të pyesin ty për muajin e ndaluar, për luftën në të. Thuaj: luftimi në të është gjynah i madh.” (El-Bekare: 217)

Rëndësia e muajit Rexheb: Në këtë muajt ndodhi mrekullia më e madhe pas zbritjes së Kuranit Famëlartë - Israja dhe Mi’raxhi. Po ashtu, Zoti i Plotfuqishëm urdhëroi ndërrimin e Kibles së myslimanëve nga Jerusalemi, drejt Qabesë në mes të muajit Rajab në vitin e dytë të migrimit, siç raportohet nga Ibn Abasi (r. a.).

MUAJI SHA'BAN

Pas muajit Rexheb vjen muaji Shaban. Aisheja (r. a.) thotë: “Nuk e kam parë të dërguarin e Allahut të mbajë më shumë agjërim se sa në muajin Shaban.” (Muslim, Sijam, 175)

Transmetohet nga Enes b. Malik se Pejgamberi (a. s.) pyetet: “O i dërguar i Allahut! Në cilin muaj është agjërimi më i mirë përveç Ramazanit? Pejgamberi përgjigjet: “Për nder dhe respekt të Ramazanit, është agjërimi i mbajtur në muajin Shaban.” (Tirmidhi, Zekat, 28)

Pejgamberi dhe sahabët punonin shumë për të kapur mirësitë e këtyre tre muajve. E shtonin shumë më tepër përkujtimin (dhikrin), lartësimin (tesbihun), falënderimin (hamdin & shukrin) ndaj Allahut Fuqplotë, kërkonin falje, ndihmonin të varfrit, gëzonin jetimët, të vetmuarit dhe të moshuarit. Gjatë muajve Rexheb dhe Shaban i kushtonin vëmendje agjërimin të ditëve të hëna dhe të enjte.

Është e preferuar që myslimani në këta muaj të shtojë më tepër namaze suplementare (nafile), agjërim i të hënës dhe të enjtes, dhënia e lëmoshës dhe vepra të tjera të mira. E sa për farzet, as që duhet të bisedohet.

Ebu Hurejra transmeton se i dërguari i Allahut ka thënë: “Kushdo që tregon armiqësi ndaj mikut Tim, unë do t’i shpall luftë. Me asgjë robim nuk mund më mire të më afrohet, pos me atë me çfarë Unë e kam obliguar (farzet) dhe vazhdimisht robim më afrohet me vepra vullnetare (nafile), derisa Unë ta dua; e kur ta dua, Unë bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon; syri i tij me të cilin sheh; dora e tij me të cilën sulmon fuqishëm; këmba e tij me të cilën ecën. E nëse më kërkon diçka, do t’ia jap; e nëse kërkon mbrojtje nga Unë, do ta mbroj atë.”



AGJËRIMI NË MUAJT E SHENJTË

Njerëzit në të kaluarën e kishin traditë agjërimin e muajit të Rexhebit për shkak të vlerës së madhe të tij dhe se ky muaj ka gjashtëmbëdhjetë emra, duke përfshirë: Rexheb, el-As’hab, el-Hurum, el-Muali, el-Mukim, Shehrul Atirah etj. Veçohet me emrin Rexheb, sepse madhërohej në kohën e injorancës. Pra, e konsideronin si muajin e tyre më të mirë dhe më të famshëm.

Për sa i përket agjërimin të tij pas ardhjes së Islamit, nuk ka asnjë hadith të saktë që flet se është i pëlqyeshëm agjërimi në këta muaj.

Disa as’hab kanë folur dhe kanë konsideruar të pëlqyeshme agjërimin e muajve të shenjtë. Prej tyre është Ibn Omeri (r. a.), mirëpo ky nuk e sheh të pëlqyeshme përveç për atë që agjëron gjatë tërë vitit - d.t.th. një ditë po, një ditë jo.

Ibn Tejmijje thotë: “Veçimi i muajit Rexheb dhe Sha’ban me agjërim ose i’tikaf, nuk kemi asnjë argument nga Pejgamberi (s.a.v.s) për këtë vepër, as nga sahabët e as nga prijatarët e myslimanëve. Për sa i përket agjërimin të muajit Rexheb, të gjitha hadithet që flasin për këtë temë janë të dobët ose të trilluar.”

Ibn Sibki ka transmetuar në Nil el-Avtar të Shavkanit (4/331), nga Muhammed bin Mansur el-Sam’ani, se ka thënë: “Nuk është potencuar hadith i saktë në preferimin e agjërimin të Rexhebit në mënyrë të veçantë, madje hadithet e transmetuara në lidhje me të janë të dobët.”

Hafiz ibn Haxheri el Askalani, Zoti e mëshiroftë, thotë: “Nuk është transmetuar asnjë hadith që flet për vlerën e mua-

jit Rexheb, as për agjërimin e tij, apo agjërimin e ndonjë dite të veçantë, apo në faljen e ndonjë nate të veçantë që mund të merret si argument.”

Është i vërtetë fakti se Omeri (r. a.) u mëshonte duarve atyre që agjëronin në muajin Rexheb dhe thoshte: “Hani, sepse është muaj të cilin e madhëronin injorantët.” Sidoqoftë, gjatë këtyre muajve nuk parashihet ndonjë ibadet i veçantë, nga fakti se i dërguari i Zotit nuk na rekomandon diç të tillë; as shokët e tij të nderuar nuk bënë një gjë të tillë.

Kjo, për shkak se u transmetuan shumë hadithe të dobëta, për të treguar dëshirën e rigjallërimin të disa netëve në këtë muaj, ose preferencën për vazhdimin e agjërimin, pagimin e zekatit gjatë këtij muaji. Këto hadithe nuk janë të përshtatshme për t’u mbështetur për të provuar ligjshmërinë e adhurimit të këtij muaji me adhurime të tilla, sepse ibadetet në Islam nuk justifikohen përpos me dëshmi të qarta nga Libri i Shenjtë, ose nga Sunneti i saktë i Pejgamberit.

Është e arsyeshme që të agjërojmë ditë nga këta muaj si përgatitje për muajin e shenjtë të Ramazanit. Mirëpo, adhurimet si: namazi, agjërimi, namazet vullnetare (nafile), leximi i Kuranit e kështu me radhë, duhet bërë në çdo kohë dhe në çdo vend, pa përfshirë dhe pa u përkufizuar në muaj të caktuar, siç është muaj Rexheb apo Sha’ban.

Sa bukur është për ne që të përfitojmë nga muajt e shenjtë në bindje ndaj Zotit të Plotfuqishëm, duke ndërtuar tokën, duke përsosur punën, shtimin e veprave të mira, duke siguruar ushqim për skamnorët dhe duke përhapur shpirtin e solidaritetit dhe të mëshirës. Siç thotë Pejgamberi ynë: “Njerëz më të dashur tek Allahu janë më të dobishmit për njerëzit; vepra më e dashur tek Allahu i Plotfuqishëm është gëzimi që i sjell myslimanit, duke e lehtësuar nga shqetësimi, duke i shlyer borxhin, ose duke ia larguar urinë. Të eci me një vëlla në nevojë, është më e dashur për mua sesa të bëj I’tikaf në këtë xhami, domethënë xhamia e Medinës, për një muaj. E kush e ndrydh zemërimin, të cilin po të donte do ta realizonte, Zoti ia mbush zemrën në Ditën e Kiametit me kënaqësi. Kush ecën me vëllanë e tij në nevojë derisa t’ia plotësojë atë, Allahu do t’ia forcojë këmbët atij ditën kur do të rrëshqasin këmbët.”

Nuk ka dyshim se këta muaj janë shans i mirë për t’i qetësuar shpirtin tanë të trazuar me punët e rënda të dynjasë, për t’u strehuar në mëshirën dhe faljen e Allahut Fuqplotë.

(Autori është Profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)

SHKUPI SHËNON TRE MUAJT NË XHAMINË “IKRE”

Myftinia e Shkupit më 1 shkurt, 2022, pas faljes së namazit të akshamit, në Xhaminë Ikre të Sarajit me një program të begatë fetar shënoi hyrjen në Tre Muajt, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Në këtë program i pranishëm ishte Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, operativa e Myftinisë së Shkupit, kryetari i OH “Hilal” h.Fadil ef. Ramadani; sekretari i Myftinisë së Shkupit mr. Nexhmi ef. Ferati; referenti i arsimin fetar pranë Myftinisë së Shkupit, hfz. Irfan ef. Sulejmani, hatibi i xhamisë Burhan ef. Ramani; hatibi i xhamisë “Husein Shah” në Saraj, Orhan ef. Saliu; hatibi i xhamisë “Haxhi Imer” në fshatin Luboten Nimet ef. Aliu; hatibi i Xhamisë së Vjetër në fshatin Çajlanë Hasip ef. Saqipi; hatibi i xhamisë “Hixhri” në Kondovë, Ali ef. Ziberi, hafëzllarë e xhematlinj të kësaj ane.

Nuk mungoi, si gjithëherë, mirëpritja e veçantë, nderi dhe respekti nga hatibi i xhamisë Burhan ef. Ramani dhe këshilli udhëheqës i xhamisë.

Në fillim, hatibi i xhamisë Burhan



ef. Ramani i’u drejtua të pranishmëve me fjalë rasti, i cili falenderoi Myftiun, referentët e Myftinisë, hoxhallarët e pranishëm dhe gjithë të pranishmit për prezencën e tyre në këtë program.

Me një program të pasur, me Kuran, pjesë nga Mevludi e ilahi të interpretuara nga hfz. Bejtulla ef. Selmani; Besim ef. Azemi dhe Burhan ef. Ramani që me zërin e tyre të bukur xhematit të pranishëm i ofruan freskinë shpirtërore.

Pastaj, fjala kryesore i takoi nikoqirit të këtij organizimi, Myftiut të Myfti-

nisë së Shkupit, dr.Qenan ef. Ismaili.

“Të nderuar të pranishëm,

I lutem Allahut të Gjithdijshëm që këta tre muaj të jenë arsye e ripërtirjes sonë imanore dhe pasurimit shpirtëror, t’i kalojmë me sa më shumë ibadete, me sa më shumë vepra të mira.

Pa mëdyshje, për këta tre Muaj dhe për Netët e Mëdha, mund të flitet e të shkruhet shumë por, megjithatë, janë muaj që duhet t’i bekojmë ditët e jetës sonë sa më shumë në ibadet, në përkushtim, punë të mira duke u kujdesur që t’i kryejmë me bindje të plotë e sinqeritet.

Lutja-duaja që Muhamedi a.s. e thoshte sa herë që afroheshte nata që shënonte hyrjen në këta tre Muaj:

”Allahu im! Na i bëj të bekuar Rexhebin dhe Shabanin dhe na bashko me Ramazanin!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, 1/259).

Qofshin me bereqet Tre Muajt!” – u shpreh mes tjerash Myftiu në fjalën e tij.

Krejt në fund, duanë e rastit e bëri Orhan ef. Saliu.

1.02.2022

PËR PASURIMIN E SHPIRIT TONË

Të dashur besimtarë, vëllezër e motra. Falënderimet i takojnë vetem Allahut Fuqplotë.

Shpëtimi dhe paqja qofshin mbi të dërguarin tonë të dashur, Muhamed Mustafanë (a. s.).

Me lejen e Allahut, ne po hyjmë në Tre Muajt e Dalluar, të cilët sipas kalendarit hënor janë Rexhebi, Shabani dhe Ramazani.

Këta tre muaj të begatë janë plot me net të dalluara, siç janë: Nata e Regaibit, Nata e Miraxhit, Nata e Beratit dhe Nata e Kadrit.

Të nderuar besimtarë. I lutem Allahut të Gjithdijshëm që këta tre muaj të jenë arsye e ripërtirjes sonë imanore dhe e pasurimit shpirtëror, t’i kalojmë me sa më shumë ibadete, me sa më shumë vepra të mira.

Muhamedi (a. s.), familja e tij e bekuar dhe sahabët, e shtonin më tepër adhurimin me namaze nafile, me kërkimfalje, me ndihmë të varfërve, me gëzimet që u bënin jetimëve, me ndihmat për nevojtarët dhe të moshuarit.

Pa mëdyshje, për këta tre muaj dhe për Netët e Mëdha mund të flitet e të shkruhet shumë. Ata janë muaj që duhet t’i bekojmë ditët e jetës sonë sa më shumë me ibadet, me përkushtim, me punë të mira, duke u kujdesur që t’i kryejmë me bindje të plotë e me sinqeritet.

Prandaj, le të përpiqemi që këtë kohë ta kalojmë duke u për-



pjekur me plot vullnet, me besim dhe me dëshirë për t’u pasuruar shpirtërisht dhe për ta arritur shkallën sa më të lartë të devotshmërisë.

Këtë mesazh po e përfundoj me lutjen që thoshte Muhamedi (a. s.) sa herë që afrohej nata që shënonte hyrjen në këta tre muaj: ”Allahu im! Na bëj të bekuar Rexhebin dhe Shabanin dhe na bashko me Ramazanin!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, 1/259)

Allahu (xh. sh.) qoftë me ju dhe Ai ju bekoftë!

QOFSHIN ME BEREQET TRE MUAJT!

Dr. Qenan ef. Ismaili, Myfti i Myftinisë së BFI-Shkup (1.02.2022)

SHËNOHET NATA E REGAIBIT NË STUDENIÇAN

Në Studeniçan, më 3 shkurt, 2022, pas faljes së namazit të jaciisë, në organizim të Myftinisë së Shkupit dhe në koordinim me Këshillin e xhamisë "Hafëz Xhavit ef. Ibrahim", u organizua një program i begatë fetar për të shënuar Natën e Regaibit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Në këtë program i pranishëm ishte Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, Kryetari i Komunës së Studeniçanit z. Azem Sadiku, Sekretari i Myftinisë së Shkupit mr. Nexhmi ef. Ferati, Referenti i xhematit të Karshiakës pranë Myftinisë së Shkupit hfz. Irfan ef. Sulejmani, hafëzllarë e xhematit të kësaj ane.

Në fillim, me fjalë përshëndetëse të panishmëve iu drejtua hatibi i xhamisë Muhamed ef. Sadiku, i cili uroi xhematin e pranishëm me rastin e hyrjes në Tre Muajt e Bekuar, si dhe në emër të Këshillit të xhamisë dhe të xhematit falënderoi Myftiun dr. Qenan ef. Ismaili, bashkë me operativën e Myftinisë, që përzgjedhën xhaminë "Hafëz Xhavit ef. Ibrahim" për ta shënuar Natën e Regaibit.

Fjala e rastit në këtë manifestim i takoi Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili:

Tre Muajt e Bekuar, janë muajt në të cilët shfaqet mëshira e Allahut të Madhërishtëm, muajt, ditë e net në të cilat bëjnë vend ndjenjat shpirtërore e në të cilët



hapen dyert e faljes.

Prandaj, vëllezër të dashur, puna parësore, më e madhe që duhet bërë, është që, gjatë kësaj kohe, gjithsesi është marrja e vetes në vetëllogari, të jemi vetëkritikë e t'i qërojmë hesapet me vetveten, para se të vijë çasti kur do të na marrë në llogari, në Ditën e Gjykimit, Allahu Fuqplotë.

Për hair Lejletul Regaib-i! Allahu Fuqplotë na e mundësoftë që ta mbërrijmë Ramazanin shëndoshë e mirë, ishalla!" - u shpreh Myftiu në fjalën e tij.

Më pas, besimtarë të shumtë të mbledhur në xhami, ndoqën programin, i cili përmbante leximin e pjesëve nga Kurani famëlartë, ilahi dhe pjesë nga Mevludi.

Në këtë program ishin të ftuar: hfz. Adnan ef. Elmazi; Sami ef. Nuhiju dhe Burhan ef. Ramani.

Ndryshe, Myftinia e Shkupit do të vazhdojë me shënimin e netëve të bekuara në kalendarin hënor, duke realizuar programe kushtuar besimtarëve të Shkupit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

TETOVA SHËNOI REGAIBIN NË PALLÇISHT

Myftinia e Tetovës, me rastin e Natës së Regaibit, më 3 shkurt, 2022, pas namazit të akshamit, organizoi manifestim fetar në Xhaminë Qendrore të fshatit Pallçisht, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Tetovës.

Në këtë manifestim, të cilin e moderoi mr. Xhemil ef. Sadiki, morën pjesë: Myftiu i Myftinisë së Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i mëparshëm Alifekri ef. Esati, Drejtori i Sektorit për Kulturë në BFI Musanif ef. Rufati, Imami i Xhamisë Sadri ef. Iljazi, hoxhallarë të tjerë nga vendi dhe rrethina, si dhe një numër i madh i xhematit.

Para xhematit u prezantua një program fetar-kulturor nga disa nxënës të Medresës Isa Beu dhe studentë të FSHI-së, të udhëhequr nga Referenti për Kulturë pranë Myftinisë së Tetovës, dr. Hysein ef. Rizai.

Programi filloi me lexim të Kuranit Famëlartë dhe vazhdoi me ilahi dhe kaside.

Myftiu i Tetovës për hir të kësaj nate mbajti fjalën e rastit, me ç'rast foli mbi



vlerën e Tre Muajve dhe të Natës së Regaibit, duke e lutur Allahun Fuqplotë që të na sjellë mirëqenie, begati dhe lumturi në familjet tona.

Në fund u lexuan disa ajete nga hoxha i nderuar, Imami i Xhamisë së fshatit Selarcë Xhelal ef. Xhemali. Duanë e këtij manifestimi e bëri Myftiu i mëparshëm

Alifekri ef. Esati. Në namazin e jaciisë priu Referenti për Arsim Fetar pranë Myftinisë së Tetovës, hfz. Abdurahim ef. Murati.

Ndërkaq, pas namazit të jaciisë Këshilli i Xhamisë për mysafirët kishte përgatitur një koktej, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

NË MBLEDHJEN E MYFTINISË SË TETOVËS



Më 16 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në mbledhjen e rregullt të Myftinisë së Tetovës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Mbledhja u mbajt nën udhëheqjen e Myftiut, prof. dr. Qani ef. Nesimi, dhe u raportua gjerësisht për aktivitetet e vitit 2021 të Myftinisë. Njëkohësisht, u bë edhe ndarja e vendimeve anëtarëve të rinj të Myftinisë.

Në këtë mbledhje në rend dite ishin: Raporti nga Sektori për çështje fetare; Ra-

porti për vakëfin dhe qiratë nga Sektori i vakëfit; Raporti për kulturë, si dhe u diskutuan shumë çështje më rëndësi në lidhje me aktivitetin dhe organizimin e Myftinisë së Tetovës për vitin 2022.

Në mbledhje Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, shprehu mirënjohje dhe urata për angazhimet dhe aktivitetet e Myftinisë gjatë vitit të kaluar dhe e cilësoi si një vit të mbarë dhe të suksesshëm për Myftininë e Tetovës. Ai gjithashtu falënderoi edhe anëtarët e mandatit të kaluar dhe uroi zgjedhjen e

anëtarëve të rinj, duke iu dëshiruar shëndet, përgjegjësi dhe suksese në mandatin e tyre. Në këtë mbledhje Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin h. Irsal ef. Jakupi, Sekretar i Përgjithshëm i BFI, dr. Selver ef. Xhemali, Drejtor i Diasporës dhe z. Musanif ef. Rufati, Drejtor i Sektorit për Kulturë pranë Rijasetit të BFI.

Në fund, Myftiu e falënderoi Reis'ul-Ulemanë për prezencën e tij, si dhe kolegët dhe anëtarët e Myftinisë, për angazhimin e tyre, thuhet në njoftimin e BFI-së.

MANIFESTIM PËR REGAIBIN NË OHËR

Për nder të fillimit të Tre Muajve të Shenjtë dhe të Natës së Bekuar të Regaibit, Myftinia e BFI-Ohër më 3 shkurt, 2022, pas namazit të akshamit, organizoi manifestim fetar në Xhaminë Kulogllu, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Ohrit.

Myftinia e Ohrit të gjithë besimtarëve muslimanë ua uron fillimin e Tre Muajve të Shenjtë dhe këtë Natë të Bekuar të Regaibit, me shpresë që të gjitha lutjet, ibadetet tona Allahu Fuqplotë të na i pranojë dhe të na japë të mirat e kësaj bote e të botës tjetër, të ahiretit, dhe të na mundësojë ta përjetojmë muajin e bekuar të Ramazanit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Ohrit.



ANËTARËT E RINJ TË MYFTINISË SË SHKUPIT MARRIN VENDIMET

Më 8 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga h. Irsal ef. Jakupi, Sekretar i Përgjithshëm i BFI dhe dr. Abdylqerim Iseni, Shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë, mori pjesë në seancën e parë të mbledhjes konstitutive me anëtarët e rinj të Myftinisë së Shkupit, të udhëhequr nga Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë mbledhje Reis'ul-Ulemaja dhe Myftiu i Shkupit ua dorëzuan vendimet anëtarëve të rinj: Muharem ef. Ismaili, Ibrahim ef. Ibrahim, Ali ef. Ziberi, Shefket ef. Baftjari, Orhan ef. Sali, Llokman ef. Kamberi, dr. Amel ef. Kurtishi, Jusuf Sinani, mr. Zahir Bekteshi dhe prof. dr. Taip Jakupi.

Gjatë kësaj mbledhje Reis'ul-Ulemaja iu drejtua të pranishmëve me një fjalim përshëndetës, ku në fillim përshëndeti organizatorin e kësaj mbledhje, Myftiun e Shkupit, e më pas të gjithë të pranishmit, me ç'rast anëtarëve të rinj të



Myftinisë së Shkupit, bashkë me të gjithë anëtarët tjerë, u dëshiroi shëndet të mirë dhe suksese në punë.

“Sot keni marrë përsipër që të çoni përpara një amanet nga paraardhësit tanë, që ta përconi Islamit te brezat e rinj”, tha Reis'ul-Ulemaja, duke shtuar: “E di se peshë që do të mbani mbi supet është e rëndë, por edhe kënaqësia e suksesit do të jetë edhe më e madhe. Bëni vepra të mira, sepse veprën tuaj do ta shohë Allahu Fuqplotë, i dërguari i Tij dhe besimtarët.”

Myftinia e Shkupit është njëra nga Myftinitë më të mëdha të Bashkësisë Fetare Islame në RMV, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Në mënyrë solemne, bashkë me Myftiun, u ndamë Vendimet anëtarëve të rinj të Myftinisë.

Uruam Myftiun dhe të gjithë të pranishmit, duke lutur Allahun Fuqplotë që t'u japë shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të reja”, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të njëjtën ditë në faqen e vet në Facebook.

MBLEDHJE VJETORE E MYFTINISË SË SHKUPIT

Më 4 shkurt, 2022, u realizua Mbledhja vlerësuese vjetore e operativës së Myftinisë së Shkupit për vitin 2021, me ç'rast u analizua edhe Plani aksional për vitin 2022, ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup dr. Qenan ef. Ismaili.

Në pikat e para të Mbledhjes u vlerësua puna e të gjithë sektorëve dhe veprimtaria e përgjithshme e Myftinisë së Shkupit, duke u bazuar në planin e aktiviteteve vjetore.

Referentët - përgjegjës raportuan të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të sektorëve që udhëheqin, si dhe paraqitën arritjet, sfidat, që i kanë shoqëruar gjatë realizimit të aktiviteteve.

Më pas, u krijua hapësirë për diskutim, për sugjerime dhe ide të reja nga ana e të gjithë stafit të pranishëm, për aktivitetet e vitit 2022.

Myftiu në fjalën e tij të fundit tha: “Myftinia e Shkupit është imazhi i besimtarëve të Shkupit, prandaj ne duhet që të angazhohemi drejt kryerjes së të gjitha obligimeve, me aq sa kemi dije dhe mun-



dësi, me të gjitha kapacitetet tona. Imazhi i dëshmuar ruhet me punë të vazhdueshme. Para së gjithash, kjo rrugë kërkon prej nesh sinqeritet në punë, durim e përkushtim gjatë aktiviteteve tona dhe transparencë gjatë veprimtarisë së gjerë të Myftinisë së Shkupit. Allahu (xh. sh.) na e mundësoftë që përjetë të

ecim e të punojmë vetëm asaj rruge që ndriçohet nga Rruga e Drejtë, gjithnjë vetëm punë të hairit!” – thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Detajet e Mbledhjes janë dhënë në platformat elektronike të Myftinisë së BFI-Shkup.

KRERËT FETARË, TAKIM NË QEVERI

Më 1 shkurt, 2022, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut përfaqësuesit e të gjitha Bashkësisë Fetare patën një takim me Kryetarin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut z. Dimitar Kovačevski, i shoqëruar nga Zv/Kryeministri i Parë z. Artan Grubi, Ministri i Punëve të Brendshme z. Oliver Spasovski dhe Drejtori i Komisionit për Bashkësitë Fetare z. Darjan Sotirovski. Nga BFI ishte Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, ndërsa në përbërje të delegacionit ishin edhe përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Maqedonase, të Kishës Katolike, të Bashkësisë Metodiste dhe të Bashkësisë Hebraike, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Kryeministri z. Kovačevski së pari e informoi delegacionin me krerët e Bashkësisë Fetare për rrjedhat politike-shoqërore në vend, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet Qeveria e re dhe njëherit premtoi se do ta vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me të gjitha Bashkësitë, me qëllim të zhvillimeve pozitive në sferën fetare dhe më gjerë.



Nga ana e tij, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në emër të BFI të RMV së pari shprehu urime me rastin e zgjedhjes së z. Kovačevski Kryetar i partisë së LSDM, si dhe Kryeministër i RMV, si dhe rizgjedhjen e z. Artan Grubi, z. Oliver Spasovski në postet e ushtruara në Qeverinë e kaluar.

Gjatë takimit u hapën edhe çështjet të cilat vazhdojnë të jenë aktuale dhe të pazgjidhura si: Xhamia e Prilepit, e Llazhecit, akreditimi i Medresesë dhe shumë çështje të tjera, për të cilat BFI ka kohë që ka parashtruar kërkesa. Gjithashtu, u bisedua edhe për një bashkëpunim më konstruktiv dhe të mirëfilltë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

THIRRJE PËR IMUNIZIM KOLEKTIV



Më 3 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në takimin e krerëve fetarë me Ministrin e Shëndetësisë në Qeverinë e RMV, z. Bekim Sali. Takimi u mbajt në Shtëpinë Përkujtimore të Nënës Terezë në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Pas këtij takimi, krerët fetarë së bashku me Ministrin e Shëndetësisë dolën me një mesazh të përbashkët në të cilin thuhet: “Të gjithë jemi dakord se imunizimi është mënyra më e sigurt për t'u mbrojtur nga përhapja e koronavirusit, andaj vetëm duke rritur vaksinimin mund

ta mbrojmë shëndetin tonë dhe shëndetin kolektiv; gjithë kjo, me të vetmin qëllim që të përballemi më mirë me pandeminë”.

Për këtë mesazh dhe për rëndësinë e imunizimit kundër Covid-19, Ministri i Shëndetësisë z. Bekim Sali tha: “E falënderoj për zemërsisht kreun e Kishës Ortodokse Maqedonase Imzot Stefanin, Reis'ul-Ulemanë e Bashkësisë Fetare Islame h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Ipeshkëvin e Kishës Katolike z. Kiro Stojanov, si dhe Kryetarin e Bashkësisë Hebraike z. Pepo Levi, për këtë iniciativë fisnike, me të cilët i bëjmë thirrje të përbashkët seci-

lit qytetar që ta kuptojë seriozisht nevojën e vaksinimit kundër Covid-19”.

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut disa herë ka dëshmuar se me të gjitha kapacitetet e veta është vënë në luftë kundër pandemisë covid-19, duke bërë thirrje për të satën herë që qytetarët e vendit, përkatësisht besimtarët, t'u përmbahen rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë të RMV, të japin kontributin e tyre dhe të kenë kujdes të madh në parandalimin e kësaj sëmundje, duke marrë pjesë në imunizimin e shoqërisë, me qëllim që të tejkalohet situata sa më shpejt.

Disa ditë më parë, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame publikisht mori edhe dozën e tretë të vaksinës Pfizer dhe u bëri thirrje publike të gjithë besimtarëve dhe qytetarëve të RMV që të vaksinohen dhe kështu të kontribuojnë në parandalimin e hovit të virusit covid-19 omikron, i cili në vendin tonë është përhapur në masë të madhe. Ngritja e vetëdijes për imunizim kolektiv do të kontribuojë që t'i jepet fund këtij virusi vdekjeprurës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

KRYETARI I MESHIHATIT TË KROACISË VIZITON BFI-në

Më 2 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në një takim zyrtar Kryetarin e Meshihatit të Kroacisë, Myftiun Aziz ef. Hasanoviç, i cili shoqërohej nga Kryetari i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kroacisë dr. Mirza Sabiq, Zv/Myftiu, njëherësh Drejtor i medresesë "Dr. Ahmed Smajloviç" Mevludin ef. Arslani dhe nga Sekretari i Meshihatit Nermin ef. Botonjiç. Delegacioni nga Kroacia u prit me nderime të larta nga anëtarët e Rijasetit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin: Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri, Myftiu i Gostivarit h. Sabedin ef. Zendeli, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, Myftiu i Ohrit h. Samet ef. Ajdari, Drejtori i Përgjithshëm i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Imami i nderuar nga Zvicra h. Bekim Alimi, Kryetari i Shoqatës së Ulemave Rexhep ef. Ziberi, Drejtori i Sektorit për Bashkëpunim me OSBE dhe Jashtë mr. Mustafa ef. Dauti, Drejtori i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe h. Ismet ef. Ademi, Udhëheqësi i Sektorit për Marrëdhënie me Di-janetin e Turqisë prof. Nizam Reshit, pastaj prof. Sadri Hasanoviç, prof. Jusuf Çolloviç e të tjerë.

Reis'ul-Ulemaja i dëshiroi mirëseardhje delegacionit nga Kroacia, të udhë-



hequr nga Myftiu Aziz ef. Hasanoviç dhe i falënderoi për vizitën vëllazërore që i bëjmë BFI të RMV. Më pas, në sallën e mbledhjeve të Rijasetit të BFI Reis'ul-Ulema i njoftoi mysafirët nga Kroacia me organizimin dhe funksionimin e BFI të RMV, duke veçuar vështirësitë e ndryshme dhe pengesat në rrugëtimin e këtij institucioni fetar islam, me qëllim që prej tyre të nxirren mësim gjatë këmbimit të përbashkët të eksperiencave, ku BFI në Maqedoninë e Veriut luan një rol të veçantë në kultivimin e paqes, bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfaqetare, ku me angazhim të sinqertë të të gjithë punonjësve fetarë, nga Kryesia deri tek imamët e myezinët e xhamive, ka arritur të ngushtojë ndikimin e influencave nga të cilat burojnë të gjitha llojet e ekstremizmit të dhunshëm, qofshin verbal ose fizik.

Gjatë bisedës, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu lavdëroi sistemin kroat dhe qasjen e Shtetit Kroat ndaj Bashkë-

sive Fetare atje, duke theksuar se modeli i tillë do të ishte një model ideal që të aplikohet edhe në vendin tonë.

Nga ana e tij, Myftiu Aziz ef. Hasanoviç falënderoi Reis'ul-Ulemanë për pritjen vëllazërore dhe foli rreth xhamateve nga vendi ynë që jetojnë dhe punojnë në Kroaci, duke i cilësuar si besimtarët më të përpiktë dhe më të respektueshëm, të cilët me plot kuptimin e fjalës janë ambasadorët më të mirë që përfaqësojnë Islamit burimor.

Në fund të takimit u ritheksua nevoja për një bashkëpunim të përbashkët në të ardhmen.

Delegacioni nga Kroacia do të qëndrojë dy ditë në Maqedoninë e Veriut.

Më pas, të dy krerët e Bashkësive Islame përkatëse dhanë deklaratë për mjetet për informim.

Deklaratat u transmetuan edhe në platformën elektronike të BFI-së, thuhet në njoftimin e BFI-së.

EF. HASANOVIÇ NË MEDRESE

Më 3 shkurt, 2022, Drejtori i SHMI "Medreseja Isa Beu", prof. Ibrahim Idrizi, priti për vizitë Kryetarin e Meshihatit të Kroacisë, Myftiun e nderuar Aziz ef. Hasanoviç, i shoqëruar nga Kryetari i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kroacisë dr. Mirza Sabiq, Zv/Myftiu Mevludin ef. Arslani dhe Sekretari i Meshihatit të Kroacisë, Nermin ef. Botonjiç, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, rishpërndarë nga BFI.

Drejtori i Medresesë i shprehu falënderim delegacionit për vizitën dhe, njëherësh, shkurtimisht e informoi për Medresenë, për veprimtarinë dhe aktivitetet e saj, si dhe rreth sfidave me të cilat ballafaqohet ky institucion, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.



NË XHAMINË SANXHAKU

Më 2 shkurt, 2022, në orët e pasdites, në organizim të Myftinisë së Shkupit dhe të myftiut të saj dr. Qenan ef. Ismaili, delegacioni i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Kroacisë vizitoi xhamatin e Xhamisë Sanxhaku në fshatin Lubosh/ Batincë të Karshiakës,

rrethina e Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Delegacioni nga Kroacia u prit shumë ngrohtë dhe në mënyrë vëllazërore nga xhamati boshnjak i kësaj ane, në organizim të Këshillit udhëheqës të Xhamisë dhe të hatibit të zellshëm e të

palodhur Kadrija ef. Muriç.

Pas faljes së namazit të jacisë, xhamati i pranishëm pati nderin që të dëgjojë një këshillë të shkurtër, të mbajtur nga Kryetari i Meshihatit të Kroacisë, Myftiu dr. Aziz ef. Hasanoviç, thuhet në njoftimin e BFI-së.

PRITJE NË INSTITUT



Më 3 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Kryetarin e Meshihatit të Bashkësisë Islame të Kroacisë, myftiun Aziz ef. Hasanoviç, të shoqëruar nga anëtarët tjerë të delegacionit kroat, vizituan Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni (ITSHKSHM), ku u pritën nga Drejtori Skender Asani, thu-

het në njoftimin e BFI-së.

Në një pritje të ngrohtë dhe miqësore, Drejtori Asani i njoftoi krerët e Bashkësive Islame me punën dhe angazhimin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, ngritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e tij, i cili është i vetmi për nga lloji dhe veprimi në vendin tonë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

VIZITË TE KRYETARI I KUVENDIT

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, dhe mysafirët e BFI-së nga Kroacia: Myftiu Aziz Hasanoviç, dr. Mirza Shabiq dhe Mevludin ef. Arslani, bashkë me Sekretarin e Përgjithshëm të BFI, h. Irsal ef. Jakupi, më 3 shkurt, 2022, u takuan me Kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi, i cili i priti mysafirët me nderime të larta shtetërore, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë takimit me Kryeparlamentarin, temë e bisedave ishte funksionimi dhe rëndësia e Bashkësive Fetare në drejtim të kultivimit të paqes, të bashkëjetesës dhe të tolerancës ndërfaqetare në shoqëri, sidomos në shoqëritë në të cilat bashkekzistojnë më shumë religjione, thuhet në njoftimin e BFI-së.



TAKIM NË AMBASADËN E KROACISË

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me homologun e tij nga Kroacia, Myfti Aziz ef. Hasanoviç, më 3 shkurt, 2022, vizituan Ambasadën e Republikës së Kroacisë në Shkup, ku u pritën nga Shkëlqesia e Saj, Ambasadorja Nives Tiganj, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë takimit, Kryetari i Meshihatit të Kroacisë e njoftoi Shkëlqsinë e Saj, znj. Nives Tiganj, me turneun e tyre në vendet e ish-Jugosllavisë dhe sidomos me mikpritjen e ngrohtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“U pritëm me kujdesin më të madh nga Ambasadorja Nives Tiganj. Falënderime të sinqerta nga Ambasadorja për vizitën. I shoqëruar nga mr. Mustafa Dauti, Përgjegjës për Marrëdhëniet me Faktorët



Ndërkombëtarë në Rijaset, biseduam për shumë çështje që kanë të bëjnë me rrjedhat demokratike, si dhe për rolin e religjionit në mirëkuptimin mes njerëzve

dhe popujve në përgjithësi”, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook të njëjtën ditë.



“Sot pata nderin që t'i kem në Kabinetin tim dy personalitete - Imamë të mirënjohur me mision të lartë në Kroaci: h. Ismet ef. Ibishin nga fshati Gllumovë i Shkupit, Imam në Poreç dhe h. Esat ef. Jukin, Imam në Pula. Tërë jetën, me profesionalizëm dhe strategji, veprojnë në zhvillimin e jetës fetare islame në mesin e besimtarëve islamë, me qëllim të ngritjes së tyre në sferën fetare islame. 'Do të bëjmë çmos që të jemi në krye të detyrës' - thonë dy Imamët e nderuar dhe shtojnë: 'Xhematlinjtë tanë e japin kontributin e tyre, kështu që e meritojnë shërbimin tonë të paluhatsëm.' Biseduam për aktivitetet e tyre me xhematin dhe më gjerë. Më lan përshtypje të veçantë. Në Pula tashmë kanë blerë 17 mijë metra katrorë tokë, ku planifikohet ndërtimi i Xhamisë (me qendër islame), ndërsa në Poreç vazhdojnë me mundin më të madh ta bëjnë të njëjtën gjë. Me ta ishte edhe h. Gazi Dehari, me punë në Rovinj, një aktivist i palodhshëm dhe Kryetar i Këshillit iniciativ për ndërtimin e Xhamisë në Pula. Uruam suksese në veprimtarinë e tyre në kuadër të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Kroacisë. Zoti i bekoftë”, thuhet në njoftimin e Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, publikuar më 4 shkurt, 2022, në Facebook.

TË DHËNA ME INTERES

- Derisa Pejgamberi (a. s.) qëndroi në Mekë, Islamit e pranuan rreth 200 mekas.
- Në Haxhin e Lamtumirës kishte gjithsej 140 mijë sahabë.
- Emrat e sahabëve, biografisë e të cilëve mund ta gjeni nëpër literatura të ndryshme islame, është 9 mijë burra dhe 500 femra.

- Transmetues të haditheve nga sahabët janë 1.470 sahabë.
- Në Sahihun e Buhariut përmenden 254 sahabë si transmetues të hadithit.
- Musnedi i Imam Ahmedit përmend 990 sahabij si transmetues.

Nga prof. dr. Alij Xhumua; përkthet nga gjuha arabe: Jusuf Zimeri (1.02.2022)

TAKIM ME AMBASADORIN E KUVAJTIT NË SOFJE

Më 26 janar, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati një takim zyrtar në Ambasadën e Kuvajtit në Sofje me Shkëlqesinë e Tij, Ambasadorin dr. Ja'kub el-Atiki, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me një pritje të ngrohtë dhe të sinqertë e vëllazërore, Ambasadori i Kuvajtit i dëshiroi mirëseardhje delegacionit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përbërje të të cilit, përveç Reis'ul-Ulemasë, ishin edhe dr. Qenan ef. Ismaili, Myfti i Myftinisë së Shkupit; h. Sabahudin ef. Zendeli, Myfti i Myftinisë së Gostivarit; h. Ismet ef. Ademi dhe shoqëruesit e Reis'ul-Ulemasë Emin dhe Bashkim Abazi.

Në këtë takim Kreu i BFI-së shfrytëzoi rastin që ta njoftojë Shkëlqesinë e Tij me Bashkësinë Fetare Islame, si dhe rreth rrjedhave fetare-islame në vend, për sfida me të cilat ballafaqohet BFI në RMV. Po ashtu, u bisedua për një bashkëpunim të mirëfilltë mes dy institucioneve në sfera të ndryshme. Me qëllim të zhvillimit të këtij bashkëpunimi, u bisedua edhe për procesin e akreditimit të BFI në shtetin e Kuvajtit, me çka do të hapeshin rrugët e forcimit të lidhjeve tona të



ndërsjella. Nga ana e tij, Ambasadori dr. Ja'kub el-Atiki e njoftoi delegacionin e BFI-së se ky proces është në përfundim e sipër dhe se së shpejti pritet të përfundojë.

Në shenjë respekti ndaj delegacionit të BFI-së, Ambasadori i Kuvajtit bëri edhe një pritje tjetër në rezidencën e tij, ku shtroi edhe drekë, për t'i nderuar mysafirët nga Maqedonia e Veriut, gjest që dëshmoi edhe për afërsinë e tij me BFI e RMV dhe me myslimanët në përgjithësi. Në fund të takimit, në shenjë mirën-

johjeje, në emër të Delegacionit të BFI-së dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i dhuroi Ambasadorit dr. Ja'kub el-Atiki emblemën e BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Unë dhe delegacioni i BFI-së mbetëm të kënaqur dhe të respektuar nga kjo vizitë; Zoti i bekoftë”, ka shkruar në faqen e vet në Facebook Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

PRITJE NGA BASHKËSIA ISLAME E BULLGARISË

Gjatë qëndrimit në Sofje, delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV shfrytëzoi rastin që të realizojë një takim edhe me Kreun e Bashkësisë Islame të Bullgarisë, Kryemyftiun dr. Mustafa Haxhi, me bashkëpunëtorë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me një pritje të nivelit të lartë, Kryemyftiu i Bullgarisë i dëshiroi mirëseardhje vëllazërore delegacionit të BFI-së. Më pas, gjatë bisedës, ai i njoftoi mysafirët nga Maqedonia e Veriut me shumë çështje që kanë të bëjnë me Islamit dhe me jetën fetare në Bullgari. Kryemyftiu Mustafa Haxhi shprehu kënaqësinë për këtë vizitë të delegacionit të BFI-së, të cilën e vlerësoi si një konsideratë dhe respekt të madh.

Nga ana e tij, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në emër të delegacionit të BFI-së e falënderoi Kryetarin e BI të Bullgarisë për pritjen dhe respektin, ndërsa më pas biseduan rreth temave të ndryshme dhe këmbyen mendime e njohuri për përvojat e ndërsjella.

Po ashtu, Reis'ul-Ulema i BFI të RMV i dëshiroi suksese nikoqirit të tij dhe biseda mori kahe drejt temave të bashkëpunimit të mirëfilltë në të ardhmen në mes dy Bashkësive, por edhe më gjerë në Ballkan dhe në Evropë. Një falënderim i veçantë dhe respekt i drejtpërdrejtë iu bë Kryemyftiut dhe Bashkësisë Islame të Bullgarisë për kujdesin dhe angazhimin që treguan ndaj viktimave të ngjarjes tragjike të aksidentit të au-



tobusit nga RMV në Bullgari, ku humbën jetën 45 njerëz, fëmijë, gra e burra, që ishte një tragjedi e përmasave të mëdha dhe një sakrificë e vërtetë për familjet e viktimave.

Në fund të takimit, Reis'ul-Ulema e ftoi homologun e tij që edhe ata të vizitojnë BFI e RMV, me qëllim të njoftimit për së afërmi me jetën fetare në Maqedoninë e Veriut, thuhet në njoftimin e BFI-së.

REISI RIFAT FEJZIÇ MERR MENSURËN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 6 shkurt, 2022, udhëhoqi delegacionin e BFI në Podgoricë të Malit të Zi, për të marrë pjesë në inaugurimin - ndarjen e Mensurës Kryetarit të rizgjedhur të Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Reisit Rifat Fejziç, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë manifestim morën pjesë delegacione të shumë vendeve, përfaqësues të Ballkanit: prof. dr. Ali Erbash, Kryetar i Dijanetit të Turqisë; Myfti Naim ef. Tërnavë, Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës; Myftiu i Bosnjës dhe Hercegovinës, Myftiu i Shkodrës, Myftiu i Sllovenisë dhe personalitete fetare islame të vendeve të tjera.

Në këtë manifestim fjalë përshëndetëse pati edhe Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili i shprehu urimet e përzemërta Reisit të rizgjedhur, duke i uruar shëndet dhe suksese të reja në mandatin e ri. Po ashtu, Reis'ul-Ulemaja shprehu vullnetin e mirë



për një bashkëpunim të mirëfilltë mes dy Bashkësive Islame.

Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV përbëhej nga prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myfti i Myftinisë së Tetovës; h. Sabahudin ef. Zendeli, Myfti i Myftinisë së Gostivarit; mr. Salim ef. Sulejmani, Myfti i Myftinisë së Strugës; mr. Qamil ef. Rushiti, Myfti i Myftinisë së Kërçovës; h. Ismet ef. Ademi, Udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me

Botën Arabe; h. Irsal ef. Jakupi, Sekretar i Përgjithshëm i BFI; dhe z. Emin Dauti, shoqëruar i delegacionit të BFI, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Nga kjo ngjarje, në platformat elektronike BFI e RMV kishte shpërndarë edhe një fotoreportazh, për të paraqitur ceremoninë e dekretimit të h. Rifat ef. Fejziç për Reis (i rizgjedhur) të Bashkësisë Islame të Malit të Zi me seli në Podgoricë.

PRITJE NË AMBASADËN E ARABISË SAUDITE NË TIRANË



GJATË KTHIMIT NGA Podgorica (Mali i Zi), më 7 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u takua me Ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, Shkëlqesinë e Tij z. Fejsal bin Gazi Hifdhi, i cili i bëri një pritje të nivelit të lartë dhe vëllazëror delegacionit të Bashkësisë Fetare Islame dhe i dëshiroi mirëseardhjen, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me këtë rast, u bisedua për shumë çështje me rëndësi për marrëdhëniet me Mbretërinë e Arabisë Saudite, si dhe për hapërimin e Bashkësisë Fetare Islame në përputhje me rrethanat dhe kohën.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fe-

tahu falënderoi Ambasadorin për mikpritjen e ngrohtë dhe vëllazërore, si dhe e uroi atë për emërimin e afërt në detyrë, duke qenë dhe përgjegjës edhe për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Po ashtu, Reis'ul-Ulemaja foli edhe për intensifikimin e marrëdhënieve me institucionet e Arabisë Saudite në sfera të ndryshme.

Gjatë takimit Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin: h. Ismet ef. Ademi, Udhëheqës i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe; prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myfti i Myftinisë së Tetovës; h. Sabahudin ef. Zendeli, Myfti i Myftinisë së Gostivarit; mr. Salim ef. Sulejmani, Myfti i Myftinisë së Strugës; mr. Qamil ef. Rushiti, Myfti i Myftinisë së Kërçovës; h. Irsal ef. Jakupi,

Sekretar i Përgjithshëm i BFI, thuhet në njoftimin e BFI-së.

LAJM EKSKLUZIV: Këtë titull mban lajmi që ka nxjerrë Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 8 shkurt, 2022, në faqen e vet në Facebook.

“U dha lajmi i vendimit të Kabinetit të Ministrave të Mbretërisë së Arabisë Saudite në lidhje me bashkëpunimin e ndërsjellë me BFI të RMV në sfera të ndryshme, edhe atë me sa vijon: të diskutohet me përgjegjësit e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut për draft-memorandumin e bashkëpunimit në fushën e çështjeve islame mes Ministrisë së Çështjeve Islame dhe Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut. Këtë lajm na e konfirmoi edhe Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë gjatë takimit që patëm në selinë e Ambasadës më 6 shkurt, 2022. Sot lajmi u dha nëpër të gjitha mediat e Arabisë Saudite. Në të ardhmen pritet takim me Ministrin e Vakëfit dhe të Çështjeve Fetare”, thuhet në fund të njoftimit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Lajmi është shoqëruar me një fotografi (faksimile) dhe me një video-inci- zim nga Arabia Saudite.

MEHAS EF. ALIJA MERR EDHE NJË MANDAT NË ZVICËR



Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ) më 23 janar, 2022, mbajti Kuvendin e rregullt zgjedhor në Xhaminë e Regensdorfit, në Kantonin Cyrih (Zürich). Kuvendi zgjodhi Kryetarin dhe Kryesinë e KMSHZ (DAIGS), Kryetarin dhe Nënkyetarin e Kuvendit dhe dy Revizorë, ka njoftuar hoxhë Bashkim Aliu nga Zvicra.

E një rëndësie të veçantë për këtë kuvend ishte miratimi i tre draft-dokumente të përgatitura nga Komisioni juridik i KMSHZ-së, edhe atë: a) Statuti standard për xhamitë; b) Rregullorja e punës së imamit; dhe c) Rregullorja për rendin shtëpiak në xhami.

Më pas u kalua në zgjedhjen e organeve drejtuese të KMSHZ, të cilën e udhëhoqi Komisioni zgjedhor i KMSHZ. Zgjedhja e organeve u bë në mënyrë transparente dhe në përputhje me Kodin zgjedhor të KMSHZ. Edhe për një mandat katërvjeçar Kryetar i KMSHZ u zgjodh imami i Xhamisë El-Hidaje në St. Gallen, Mehas ef. Alija. Po ashtu u zgjodh edhe Kryesia prej 11 anëtarësh. E rëndësishme për këtë formacion të Kryesisë është zgjedhja e dy femrave si anëtare të Kryesisë së KMSHZ. Po ashtu, u zgjodh edhe Kryetari dhe Nënkyetari i Kuvendit të KMSHZ-së.

Në këtë kuvend u miratuan edhe aplikacionet e tri xhamive për anëtarësim në KMSHZ, me çka numri i xhamive anëtare të KMSHZ shkon në afër 60.

Punimet e Kuvendit i shpalli të mbylura Kryetari i deritashëm i Kuvendit të KMSHZ, Abdullah Mustafa, i cili falën-

deroi kuvendarët për pjesëmarrje në një numër kaq të madh në këtë kuvend, si dhe nikoqirin, Imamin dhe Kryesinë e Xhamisë së Regensdorfit, për mikpritjen dhe organizimin e shkëlqyer të hapësirës së mbajtjes së Kuvendit, thuhet në njoftimin e hoxhë Bashkim Aliut nga Zvicra. Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i ka drejtuar një urim KMSHZ dhe Kryetarit të rizgjedhur Mehas ef. Alija, i cili është me origjinë nga Tetova.

“I nderuar dhe shumë i respektuar h. hfz. Mehas ef. Alija. Kam kënaqësi të posaçme që në emrin tim personal dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, me organet dhe institucionet edukativo-arsimore të saj, që me rastin e zgjedhjeve të Kryesisë së KMSHZ, respektivisht rizgjedhjes suaj për Kryetar të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, t'ju përcjell urimet tona të përzemërta vëllazërore, duke ju dëshiruar suksese të mëtutjeshme në punë dhe shëndet dhe mirëqenie në jetë.

Me këtë rast, edhe një herë shprehim gatishtëmërinë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV në përkrahjen permanente të KMSHZ në organizimin dhe zhvillimin e jetës fetare-islame në Zvicër. Andaj, duke u nisur nga ky parim, thellësisht jemi të bindur se bashkëpunimi institucional mes Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër në të ardhmen do të vazhdojë në mënyrë më intensive. Gjithnjë paçi ndihmën e Zotit të Madhërisëm”,

thuhet në urimin e Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, drejtuar Kryetarit të KMSHZ Mehas ef. Alija.

Kryetarin e ri/të vjetër të KMSHZ e ka uruar edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar ef. Spahiu: “Ne i bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që Kryetarit të nderuar, ef. Alija, t'i japë shëndet dhe suksese në synimet e tij në drejtimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër.”

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, po ashtu ka uruar zgjedhjen e Kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, z. Mehas ef. Alija. Ai i ka uruar punë të mbarë dhe të suksesshme në drejtimin e këtij institucioni, duke shprehur interesimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e në veçanti të Drejtorisë së Diasporës, për të bashkëpunuar me KMSHZ-në. Duke ju uruar edhe një herë, pranoni selamet dhe përshëndetjet tona”, thuhet në urimin e Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Bernë (Zvicër), z. Ilir Gjoni, po ashtu ka bërë një urim me rastin e zgjedhjes së Kryesisë së re të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër. Komunitetin Mysliman Shqiptar në Zvicër e ka uruar edhe Kryetari i Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë, Vahidin ef. Beluli. KMSH ka marrë edhe urime të tjera pas Kuvendit zgjedhor, në të cilin edhe për një mandat katërvjeçar Kryetar u rizgjodh Mehas ef. Alija, nga Xhamia El-Hidaje në St. Gallen.

KRIJOHET STRUKTURA UDHËHEQËSE



Më 6 shkurt, 2022, në Olten të Zvicrës u mbajt mbledhja e parë konstitutive e Kryesisë së re të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ, përkatësisht DAIGS), thuhet në njoftimin nga St. Gallen.

Në mbledhjen e udhëhequr nga Kryetari i KMSHZ-së morën pjesë anëtarët e Kryesisë dhe Kryetari i Kuvendit të KMSHZ-së, z. Azir Jusufi.

Në këtë mbledhje u bë konstituimi i

posteve si në vijim: h.fz. Mehas Alija, Kryetar; Fehim ef. Abazi, Nënkrjetar; dr. Besim Nuzi, Nënkrjetar; Ismail Ademi, Sekretar; Safije Odai, Ndhmëssekretare; Sami Avdyli, Arkëtar; Xheneta Ramadani, Zëdhënëse; dr. Bashkim Aliu, Këshilltar për Çështje Shkencore dhe Teologjike; Mustafë Veseli, Këshilltar për Çështje Politike dhe Sociale; Sherif Tupani, Këshilltar për Mediacion Shoqëror; Nimetulla ef. Veseli, Këshilltar për Çë-

shtje Edukative-Arsimore.

Me konstituimin e Kryesisë, KMSHZ tashmë ka një kryesi kompetente, me profile të ndryshme profesionale, për t'i udhëhequr punët dhe çështjet e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër.

Na priftë e mbara! – thuhet në njoftimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër dhe të Kryetarit të tij, Mehas ef. Alija, Imam në Xhaminë El-Hidaje në St. Gallen.

DY FEMRA NË KRYESI

Nga Nehat Ismaili

Nuk ka dyshim se 23 janari, 2022, shënon një ditë të rëndësishme në historinë e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, në rrafshin juridik, kombëtar dhe fetar, sepse inkuadrimi i grave në një institucion të tillë është shumë domethënëse dhe dobiprurës në përfaqësimin e grave në KMSHZ.

Është një hap më shumë se i shkëlqyer dhe është vlerësuar pozitivisht nga qarqet e ndryshme; përgjegjësia do të jetë edhe më e madhe, në mënyrë që të ndajnë pikëpamjet e tyre në zhvillimin dhe avancimin e KMSHZ-së përkrah burrave.

Femra shqiptare në KMSHZ do të ndërveprojnë me të gjitha çështjet e paraqitura në arenën zvicerane si një anëtare aktive, sepse aspiratat dhe interesi publik janë një.

Bazuar në Statutin e KMSHZ-së, statusi i gruas brenda korridoreve të KMSHZ-së nuk do të kufizohet vetëm në çështjet e grave, apo çështjet familjare,

por do të jetë më gjithëpërfshirës, ku secila prej tyre me përvojë në fusha të ndryshme do të kontribuojë në mirëqenien e përgjithshme.

Hapi i emërimit është një argument besimi për gratë për të kontribuar në marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe për të mbështetur këtë komunitet, dhe është një mundësi për ne që të dëshmojmë aftësinë e grave dhe në të ardhmen priten nga të gjitha xhamitë t'i bashkangjiten këtij akti sublim dhe madhështor.

Vizioni i KMSHZ-së për pjesëmarrje aktive të grave në të gjitha organet e KMSHZ-së u mbështet me aklamacion nga të gjithë kuvendarët në Kuvendin e rregullt të realizuar në Xhaminë e Regensdorfit.

KMSHZ beson se emërimi i grave në të gjitha organet e tij nuk është i karakterit formal, apo plotësim i KMSHZ-së, por është bazë e vizionit dhe e synimeve të tij dhe me inkuadrimin e tyre supozohet të jenë aktive në të, duke theksuar në

të njëjtën kohë se miratimin e teologëve shqiptarë të Zvicrës dhe të intelektualëve që janë pjesë e këtij komuniteti e shohin në frymën profetike në Islam, e si dëshmi më të madhe dhe referencë janë vetë gratë në epokën e pejgamberit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, të cilat ishtin aktive në rrafshin social me të gjitha të drejtat e tyre dhe e ushtronin rolin e tyre pozitivisht në shoqëri.

Xheneta Ramadanit nga Xhamia e Bardhë e Aarburgut (Kanton Aargau) dhe Safije Odait nga Xhamia Ebu Bekër es Sidik nga Biel/Bienne (Kanton Bernë), ju dëshirojmë fat dhe suksese në angazhimin e tyre, duke theksuar se janë dy vajzat e para që shënojnë me germa të arta nismën dhe rrugëtimin e tyre të shenjtë.

Shpresojmë që edhe shumë gra të tjera, aktiviste nga fusha të ndryshme, së bashku me burrat të marrin pjesë aktive në ndërtimin e këtij vendi, për të arritur zhvillimin kombëtar në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave tona sublime. (Aarburg, 25 janar 2022)

REISI: “DUANI KËTA FËMIJË, SEPSE KËSHTU JU DO ZOTI”



Siç raportohet, në shkollën fillore “Bashkimi” të Gostivarit ishte bojkotuar mësimi për shkak të vajzës Ëmbla Ademi (11 vjeç), me sindromën down. Siç i ka deklaruar Ilir Ademi, babai i Ëmblës, gazetës “Sllloboden Peçat” (Shkup), 11 nëna të fëmijëve kanë ngritur peticion të drejtorit, duke thënë se “fëmijët e tyre do të bojkotojnë mësimin nëse Ëmbla nuk hiqet dhe nuk mëson e izoluar, në një hapësirë të veçantë”. Ndërkohë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Jeton Shaqiri, në Facebook ka njoftuar më 3 shkurt, 2022, se “Ëmbla prej sot do të vazhdojë përsëri të mësojë në klasë dhe se nuk do të jetë

e izoluar”.

Një postim në faqen e vet në Facebook ka bërë (më 3 shkurt, 2022) edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, në të cilin thuhet: “Ëmbla e vogël është voglushja më e bukur që ka krijuar Zoti. Ajo është inspirim i së bukurës, i së mirës, i solidaritetit dhe moralit. Të gjithë duhet të jemi në shërbim të lumturisë së saj dhe çdo fëmije tjetër. Andaj, duani këta fëmijë, sepse kështu ju do Zoti.”

“Hëna e Re” në vazhdim ju sjell disa shkrime në lidhje me këtë temë.

ZGJIDHJA E VETME: SONDERPÄDAGOGIK

Për fëmijët me nevoja të veçanta (dhe me aftësi të veçanta) duhet të ketë shkolla të veçanta dhe mësues e mësues të arsimuar në mënyrë adekuate, enkas për këta fëmijë. (Kjo këtu, në Perëndim, është tanimë në binarët e duhur.)

Nuk i ndihmohet fëmijës vetëm duke e vajtuar gjendjen e tij dhe duke e luajtur rolin e viktimës, por duke i ofruar mundësinë e arsimimit dhe të edukimit adekuat, sipas nevojave që ka.

Në një klasë të përzier me fëmijë të tjerë dhe me ata që kanë nevoja të veçanta, nuk mund të zhvillohet mësim normal, ngase këta të dytët kanë nevojë për më shumë mbështetje në klasë. Kjo nënkupton se fëmijët e tjerë duhet të lihen pjesërisht pasdore.

Shto këtu edhe mungesën e përgatitjes profesionale e pedagogjike të një mësueseje

ose mësuesi të rëndomtë.

Nuk mund të besoj që ndonjë prind a institucion arsimor kërkon largimin e një fëmije me sindromën down vetëm pse është i tillë; kjo s’do të ishte aspak njerëzore, por besoj se me këtë ndarje u ndihmohet të gjithë fëmijëve në mënyrën më të përshtatshme.

Më mbetet vetëm të pyes se sa shkolla të këtitilla speciale ka në Maqedoninë e Veriut dhe sa mësues adekuat për këta fëmijë ka? Sa mësuese e mësues ka te ne që kanë kryer studimet, ose janë specializuar, në „pedagogjinë e veçantë“ (a speciale), ose siç quhet në gjuhën gjermane „Sonderpädagogik“?!

(Autori, Rejhan Neziri, është Imam në Kreuzlingen TG, Zvicër, ndërsa shkrimi këtu, që botohet me lejen e autorit, është koment në një status në Fcb)

DOWN NUK ËSHTË SËMUNDJE

Sindroma down - "dashuria që nuk numëron kromozome", thotë prof. dr. Musa Musai, psikolog. Ai angazhohet për atë që fëmijët me sindromën down të jenë më të akceptuar nga shoqëria në përgjithësi. Në këtë drejtim ai e tregon rastin e djalit Asher me sindromën down dhe të nënës së tij Nash. Nëna e tij, thotë psikologu, kishte filluar betejën për të bërë ndryshime në sektorin e reklamave, në vitin 2019, dhe ia kishte arritur. Fotografia e buzëqeshur e Asherit në Facebook, për një kohë të shkurtër kishte arritur në mbi 100 mijë klikime dhe shumë shpërndarje. Më pas kompania e veshjeve kishte rënë në kontakt me familjen e Asherit dhe kishte thënë: "Gjithnjë kemi nevojë për fëmijë me nevoja të veçanta."

Jad është një baba nga Siria me sindromën down, i cili kishte punuar në një fabrikë për 25 vjet dhe e kishte rritur djalin e tij, për t'u bërë mjek dhe një djalë krenar për babanë e tij. Sader Issa, i cili kishte studiuar stomatologjinë në Siri, kishte ndarë historinë se si ai u rrit nga babai i tij me sindromën down. Allahu është i madh. (Desk, shkurt, 2022)

21 Marsi është Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down. Miqtë e vërtetë nuk numërojnë kromozome! Dashuria e tyre i mjafton botës. Sindroma down nuk është sëmundje; është ndryshim gjenetik...Le të jemi më të vetëdijshëm për këtë – thotë psikologu prof. dr. Musa Musai (Gostivar).

HOXHË TAHIR TAHIRI: "IM BIR ENESI"

Rasti i Ëmblës na preku të gjithëve, sidomos neve që jemi prindër të fëmijëve me sindromën down. Unë djalin tim, Enesin, që në moshën katërvjeçare e kam regjistruar në çerdhen "Rinia" -Tetovë, në mënyrë që të ndërvejojme sa më herët, që ai të integrohet në shoqëri, shkruan hoxhë Tahir Tahiri nga Rakoveci, rrethina e Tetovës, mbi Pirok, që 10 vjet Imam në të njëjtin fshat.

E falënderojmë shumë drejtoreshën e asaj kohe, Arlinda Murtezani, e cila e ka pranuar pa hezituar fare dhe sidomos edukatoren kryesore të grupit Ramije Dauti (drejtoreshë aktuale), e cila na përkrahu shumë dhe ka punuar po ashtu me fëmijët e tjerë, që Enesin ta pranojnë ashtu siç është.

Mos të harrojmë se ishte një kohë kur në Tetovë mungonin kuadrot për edukim special dhe rehabilitim. E them këtë, se ai që e bën punën me nder, që ka ndërgjegje, që ka humanitet dhe solidaritet në shpirtin e tij, ai bën çmos që t'ia japë hakun punës dhe t'i dalë në ndihmë një fëmije me nevojë të veçanta, qoftë edhe duke mos e pasur obligim.

Po çka të themi tani, me rastin e Ëmblës, së cilës i mohohet e drejta për arsimim, në kohën kur RMV synon integrimin evropian dhe ka miratuar Ligjin për arsim inkluziv dhe nga viti i ardhshëm pritet që të mbyllet paralelet speciale!

Me këtë ligj është paraparë që fëmija të ketë një asistent dhe defektolog. Në rast krize ose shfaqje agresiviteti, do të merret defektologu (sipas nevojës, do ta largojë nga klasa).

Në këtë rast, nuk janë fajtorë vetëm prindërit dhe drejtori, por gjeneratori kryesor i problemeve është Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, e cila i ka lënë pasdore këta fëmijë me vite.

Në kohën kur kemi mjaft kuadro - pesë gjenerata të diplomuara në USHT që bredhin rrugëve për të gjetur punë. Nga ana tjetër, fëmijë me nevojë të veçanta, të neglizhuar tërësisht...Mjerim!!!


Kjo kategori është dyfish e diskriminuar (si komunitet me nevojë të veçanta dhe si shqiptarë). Ne kemi problem me të drejtën kryesore për arsimim, ndërsa në

"JANË SHUMË TË DASHUR!"

Fëmijët me sindromën down janë kryesisht të buzëqeshur dhe shumë të dashur. Ata të japin atë që ti u jep! Ata janë shumë bujarë; janë të parët që u japin njerëzve dashuri pa kushte; para se ata t'u japin atyre. Nuk bëhen agresivë vetëm nëse u ke ofruar diçka të tillë (-dashurinë), ose nuk i ke lënduar ose t'ua kesh prishur rutinën...

Shkup nxënësit maqedonas me nevojë të veçanta vijojnë edhe shkollimin e mesëm!

Ky është një shtet që ia shtyp ambiciet rinisë, që i shtyp të drejtat e qytetarëve e të mos flasim për kategorinë e njerëzve me nevojë të veçanta. Pastaj: na largohen mjekët, inxhinierët etj. Kështu do të na largohen edhe defektologët, edhe pse kanë mjaft hapësirë për të ushtruar profesionin në vendin e tyre.



Xhamia e Rakovecit, mbi Pirok, rrethina e Tetovës (fotoArkiv).

Mos të harroj, të falënderoj edhe Katedrën e Edukimit Special për Rehabilitim të UT-së, studentët që kanë dhënë një kontribut të madh për vetëdijesimin e njerëzve në lidhje me këtë kategori, si dhe të gjitha shoqatat dhe vullnetarët e ndryshëm, në kohën kur kompetentët janë të shurdhër!

Dhe, krejt për fund: Fëmijët me sindromën down janë kryesisht të buzëqeshur dhe shumë të dashur. Ata të japin atë që ti u jep! Ata janë shumë bujarë; janë të parët që u japin njerëzve dashuri pa kushte; para se ata t'u japin atyre. Nuk bëhen agresivë vetëm nëse u ke ofruar diçka të tillë (-dashurinë), ose nuk i ke lënduar ose t'ua kesh prishur rutinën.

Zoti të dhashtë mirësi pa fund, Ëmbla e vockël. Të duam pa fund! – është shprehur hoxhë Tahir Tahiri nga fshati Rakovec, rrethina e Tetovës. Ai po ashtu është pajtuar që ky shkrim të botohet edhe në revistën "Hëna e Re", Shkup.

ÇFARË ËSHTË SINDROMA DOWN?

Shkruan: Shpresa Rashiti (Defektologe)

Diversiteti është vlerë! Dielli ngroh njëlloj për të gjithë: Gjenet përbajnë kodet përgjegjëse për të gjitha tiparet tona të trashëguara dhe janë të grupuara në një strukturë në formë spiralje, të quajtura kromozome. Bërthama e secilës qelizë përmban 23 çifte të kromozomeve, gjysma e të cilave janë të trashëguara nga secili prind, duke bërë kështu që materiali gjenetik i çdo individi tipik të jetë i organizuar në 46 kromozome.

Veza dhe spermatozoidi kanë secila nga 23 kromozome. Në momentin e fekondimit, ato takohen për t'u bashkuar në një embrion me 46 kromozome. Një person me sindromën down ka një kromozom më shumë në çiftin e 21-të, duke bërë kështu që të ketë 47 kromozome gjithsej.

Sindroma down nuk është një sëmundje, por një çrregullim kromozomik. Kjo sindromë e shoqëron fetusin që në ngjizje të tij dhe përgjatë gjithë jetës. Nuk ka një shkaktar shkencërisht të vërtetuar të këtij ndryshimi të kromozomeve në numër.

Duke qenë se sindroma down nuk kategorizohet si sëmundje, nuk ka kuptim të themi që ka një kurë për të. Analiza plotësisht diagnostikuese për sindromën down është kariotipi, i cili bëhet me anë të një procedure që quhet amniocenteze (marrja dhe analizimi i lëngut amniotik),



e cila bëhet në një periudhë të caktuar gjatë shtatzënisë. Kariotipi është dhe analiza që i bëhet foshnjës kur mjekët dyshojnë për praninë e sindromës down direkt pas lindjes së tij.

Sot në botë statistikisht tregojnë që 1 në 691 lindje që jetojnë janë me sindromën down, duke e bërë kështu një nga çrregullimet kromozomike me të hasura në botë. Ai nuk lidhet me racën, me kombësinë, me fenë apo me statusin socioekonomik.

Prania e këtij kromozomi shtesë sjell vonesa në zhvillimin mendor dhe fizik të individit. Fakti më i rëndësishëm që duhet ditur rreth individëve me sindromën down është se me kujdesin dhe mbështetjen e duhur terapeutike që në fëmijërinë e hershme, këta individë mund të arrijnë të përmbushin potencialin e tyre, fakt ky që çon në mundësinë për të jetuar një jetë të gjatë, gjithëpërfshirëse dhe të pavarur, pra të jenë pjesë aktive e

komunitetit ku jetojnë.

Nga ana tjetër, duhet të jemi të vetëdijshëm që edhe individët me sindromën down kanë dhunti dhe talente në fusha të ndryshme, si ajo e artit apo e sportit, ndaj prindërve të tyre iu sugjerohet që t'i provojnë dhe t'u krijojnë atyre mundësi për t'i pikasur dhe zhvilluar këto talente.

Edhe pse thuhet se personat me sindromën down nuk mund të arrijnë qëllime normale në jetë, me mbështetjen e duhur, ata mund ta bëjnë këtë. Shumica e individëve me sindromën down mësojnë të ecin dhe të flasin, dhe shumë prej tyre tashmë janë duke vazhduar shkollën publike, kalojnë provimet dhe jetojnë një jetë si gjithë të tjerët, ose gjysmë-të pavarur si të rritur.

Edhe pse thuhet se personat me sindromën down kanë të njëjtën paraqitje, ata mund t'i kenë të gjitha ose asnjërën prej këtyre karakteristikave fizike. Një person me sindromën down mund të ngjajë më tepër me një të afërm të familjes së tij biologjike, se me dikë tjetër që e ka po këtë sindromë.

Edhe pse thuhet se personat me sindromën down janë gjithnjë të lumtur dhe shumë të dashur, ne të gjithë jemi unikë dhe njerëzit me sindromën down nuk janë më të ndryshëm nga çdokush tjetër në karakteristikat e tyre të personalitetit apo të gjendjeve të luhatshme të humorit.

(Autorja punon në shkollën fillore Qendra e Resurseve Idnina, Shkup; në të njëjtën kohë është dhe drejtoreshë në Qendrën Bota Ime, Çair. Është lejuar botimi i tekstit këtu.)

"ÇADRA"

Fëmijët me sindromën down kanë çrregullim kromozomik. Saktë të vërtetuar shkencërisht. Ende nuk dihet shkaktari. Shumë shpesh ndodh pas moshës dyvjeçare. Fëmija me down mund të ketë çrregullime shtesë: autizëm, paralizë, sëmundje kardiovaskulare, ose probleme të tjera. Autizmi është si çadër e madhe: tek ajo mund të futet sindroma down, paraliza, problemet ADHD dhe probleme të ndryshme. /ADHD, çrregullim i mungesës së vëmendjes dhe hiperaktivitetit, ose çrregullim i vëmendjes me hiperaktivitet - nga Red./

(SH. R.)

DUHEN METODA TË VEÇANTA MËSIMI

Shkruan: dr. Arben Agolli
(Enkas për HeR)

Sindroma down nuk është sëmundje, por çrregullim gjenetik, që prek një numër të caktuar personash. Incidenca e sindromës është 1 në 650 fëmijë të porsalindur.

Ky çrregullim pengon zhvillimin normal fizik dhe mendor. Problemet shëndetësore të këtyre fëmijëve janë të ndryshme: 30-60% kanë problem me zemrën, 20% kanë probleme endokrinologjike (me gjëndrën tiroide), probleme me aparatit lokomotor dhe atë nervor.

Por, pa marrë parasysh vështirësitë shëndetësore, këta fëmijë, apo të moshave të tjera, kanë nevojë për përkujdesje të veçantë gjatë rritjes, veprime të ndryshme terapeutike dhe rehabilitimi, si dhe metoda të veçanta mësimi.

Çrregullimi është shumë kompleks dhe kërkon një angazhim shumë të madh të familjes dhe të shoqërisë.

Edhe përkundër problemeve që kanë, ata janë të ngrohtë, shpirtmirë, të gëzuar, rrezatojnë dashuri dhe dhimbje njëkohë-



sisht. Komunikojnë me rrethinën e tyre, kopjojnë me shumë mjeshtri sjelljen e njerëzve rreth tyre, mund të jenë shumë kreativë.

Në fazën fëmijërore kanë nevojë për familjen, që më vonë të mund të pavarësohen për jetë të mëvetëshme.

Stimulimi përmes lojrave të bazuara në këshillat e mjekut dhe të terapeutit, i ndihmon prindërit të përqendrohen në një ardhmëri pozitive dhe nxit zhvillimin e hershëm të këtyre fëmijëve. Megjithëse niveli i aftësive ndryshon nga njëri fëmijë te tjetri, shumë prindër orientohen për aktivitetet e integruara në kuadër të komunitetit lokal.

Kur fëmijët i kalojnë vitet e para kritike, ata më tutje është e mundur të bëjnë hapa të mëdhenj në arsimim dhe punë.

Patjetër që shkolla është një segment

shumë i rëndësishëm për zhvillimin sa më normal të këtyre fëmijëve. Ata duhet të jenë në klasa me fëmijët e tjerë, por nën një përkujdesje të vazhdueshme të kujdestares së klasës, të pedagogut, të psikologut dhe të defektologut të shkollës. Vetëm bashkë me fëmijët e tjerë, ata nuk do të ndjehen "ndryshe", por do t'i gëzohen çdo aktiviteti apo pune në klasë.

Janë shumë të mirëseardhura edhe aktivitetet mbas orës së mësimi, kur bashkë me fëmijët tjerë dhe prindërit e tyre do të marrin pjesë në aktivitete të lira (sport, muzikë, vizatim), veprime të cilat tek ata krijojnë kënaqësi dhe vetëbesim.

Formimi i qendrave të këtilla nëpër komuna do ta përmirësonin shumë kualitetin e jetës së këtyre personave dhe ata nuk do të ndjeheshin të diskriminuar.

Mbështetja për ta demonstronhet me simbolin e sindromës down dhe ato janë çorapët ngjyra-ngjyra. Duke i mbathur ato, ne demonstronjmë gatishmërinë tonë për të folur dhe për të ndihmuar rreth problemeve të tyre.

(Autori është pediatër dhe njohës i mirë i sindromës down: është nga Dibra)

MINISTRI ÇUPI NË BFI

Në Selinë e Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti më 17 shkurt, 2022, Ministrin z. Xhemal Çupi, i angazhuar për diasporën në Qeverinë e tanishme të RMV, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë takim me Ministrin Çupi u bisedua për intensifikimin e bashkëpunimit në disa projekte, mes BFI-së dhe Qendrave islame në diasporë, si në Evropë dhe në SHBA, me këtë dikaster ministror, me ç'rast diasporës tonë do t'i ofrohen shërbime që janë të lidhura ngushtë me zgjidhjen e kërkesave dhe problemeve të tyre.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në emër të BFI shprehu gatishmëri dhe vullnet të mirë për të qenë pjesëmarrës në realizimin e projekteve të cilat



bëhen për të mirën e qytetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në vendet e Bashkimit Evropian dhe në SHBA. Siç dihet botërisht, Bashkësia Fetare Islame ka qindra

qendra fetare kulturore që veprojnë në Përrëndim dhe janë të lidhura ngushtë me institucionin amë - BFI, thuhet në njoftimin e BFI-së.

ATASHEU TURK NË BFI



Më 1 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në një takim miqësor urimi Këshilltarin për çështje fetare pranë Ambasadës së Turqisë, z. Mustafa Mesten, me bashkëpunëtorin e tij, njëherësh Imam në Xhaminë e Mustafa Pashës, hfz. Mustafa Goxha, me rastin e hyrjes së Tre Muajve të Shenjtë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Të dy palët uruan njëra-tjetrën dhe biseduan për aktivitetet që do t'i ndërmarren BFI në këta tre muaj: Rexheb, Shaban dhe Ramazan. Tre Muajt fillojnë me 2.02.2022, e mërkurë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

ËMBLA SHKOI NË SHKOLLË ME PRESIDENTIN

Siç kanë njoftuar më shumë media, më 7 shkurt, 2022, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Stevo Pendarovski, e ka vizituar familjen Ademi në Gostivar, përkatësisht Ëmblën 11-vjeçare me sindromën down, e cila pa dëshirën e saj ishte larguar nga shkolla dhe prapë ishte kthyer. Presidenti dhe Ëmbla kishin shkuar bashkë në shkollën "Bashkimi" të qytetit.

"Pendarovski i inkurajon dhe i mbështet prindërit në luftën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me zhvillim atipik dhe e përshëndet reagimin e shpejtë të Avokatit të Popullit dhe Vendimin e Komisionit për Parandalimin e Diskriminimit që të hapë procedurë për rastin me Ëmblën. Presidenti potencoi rëndësinë e zbatimit të dispozitave ligjore për gjithëpërfshirje në arsim, duke potencuar përgjegjësinë sociale veçanërisht edhe ndaj grupeve të prekura", thuhet në njoftimin e Zyrës së Presidentit, të transmetuar nga Portalb.mk.




PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT

Më 17 shkurt, 2022, Programi i Evropës Juglindore i Fondacionit Helen për Politikë Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP) organizoi takim online, për të diskutuar dhe konsultuar rreth gjetjeve nga puna në terren që ekipi hulumtues i ELIAMEP ka kryer në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në lidhje me cenueshmërinë e komunitetit dhe qëndrueshmërinë ndaj radikalizmit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ky takim organizohet në kuadër të Projektit PAVE – Parandalimi dhe Adresimi i Ekstremizmit të Dhunshëm përmes Qëndrueshmërisë së Komunitetit në Ballkan dhe Rajonin e MENA-s, financuar nga programi i kërkimit dhe inovacionit Horizon 2020 i Bashkimit Evropian.

Në këtë takim mori pjesë mr. Mustafa ef. Dauti, Drejtor i Punëve të Jashtme në BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI-së.



BFI URON PAVARËSINË E KOSOVËS

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka uruar 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

“Dita e Pavarësisë së Kosovës është ngjarje historike e Kombit. Ajo i jep kuptim jetës, dinjitetit, paqes, lirisë, ngritjes së krenarisë sonë dhe përkushtimit ndaj Vatanit. Urime dhe qoftë e bekuar kjo Ditë e Madhe të Krijuesi ynë”, ka shkruar në urim Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV më 17 shkurt, 2022, i dërgoi një telegram urimi Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut h. Naim ef. Tërnavë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në telegram thuhet: “I nderuar Myfti Naim ef. Tërnavë, të nderuar pjesëtarë të Bashkësisë Islame të Kosovës. Më lejoni që në emrin tim personal dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut t’ju uroj 17 Shkurtin - Ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Të përlulur para veprës së shenjtë dhe sakrificës sublime të martirëve tanë, ne sot po shënojmë me mburrje 14-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës si shtet i lirë dhe demokratik.”

Po ashtu, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i ka dërguar telegram urimi, me përmbajtje të ngjashme, edhe z. Pridon Sadriu, i Ngarkuar me Punë të Përkohshme në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup.



GOSTIVARI SHËNON PAVARËSINË E KOSOVËS

Më 17 shkurt, 2022, me ftesë të Qendrës për Kulturë në Gostivar dhe SHKA "Lulet e Malësisë", Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në programin kulturor me rastin e përkujtimit të Pavarësisë së Kosovës, program ky modest, por me përmbajtje të madhe, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë manifestin morën pjesë edhe Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, z. Ali Ahmeti, Zv/Ministri i Mbrojtjes z. Bashkim Hasani, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin Zendeli, Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së h. Irsal ef. Jakupi, Referenti i Myftinisë së Gostivarit z. Mallzim Zendeli dhe personalitete të shquara të jetës publike, kulturore e artistike.

Së pari të pranishmit në këtë manifestim i përshëndeti Drejtori i Qendrës për Kulturë, z. Hod Miftari, duke iu dëshiruar mirëseardhje. Programin e hapi artistja e mirënjohur Vjollca Zylbeari, e cila foli për rëndësinë e këtij manifestimi dhe më pas fjalë rasti mbajti znj. Nafije Zendeli-Ziberi, e cila në vitet e hershme në sistemin monist mori guximin dhe e para ngriti zërin kundër paraleleve të prani-



ziera, që ishte strategji e atëhershme e sistemit për të diskriminuar shqiptarët në të gjitha sferat, e në veçanti në sferën e arsimit shqip, e cila për këtë pësoi rëndë, duke u persekutuar nga sistemi i atëhershëm.

Programin e realizuan dy shoqëritë kulturore artistike: "Lulet e Malësisë" nga Gostivari dhe "Duflla" nga fshati Rashçe, Komuna e Sarajit (Shkup). Rapsohet e njohur me repertorin e tyre zgjuan një përkujtim të veçantë të kësaj date historike dhe inspiron lart ndjenjat patriotike dhe kombëtare.

Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i përshëndeti të prani-

shmit dhe ua uroi këtë Ditë të Madhe, me dëshira për një ardhmëri të shëndoshë të Kosovës së pavarur dhe për paqe në këtë nënqiell e më gjerë.

Në fjalën e rastit, z. Ali Ahmeti uroi këtë manifestim, duke shpjeguar gjerë e gjatë historikun e zhvillimeve kombëtare shqiptare në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe synimet e zhvillimeve të reja në të ardhmen.

Falënderime iu bënë edhe Drejtorit të Qendrës për Kulturë, z. Hod Miftari, dhe aktivistit të mirënjohur të çështjes kombëtare, z. Luan Veliu, për kontributin e madh në këtë organizim, thuhet në njoftimin e BFI-së.

27-VJETORI I LIGJËRATAVE TË PARA NË UT



Më 17 shkurt, 2022, Universiteti i Tetovës mbajti Akademi solemne me rastin e 27-vjetorit të ligjëratave të para. Në të morën pjesë Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, dhe Myftiu i Myftinisë së Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, bashkë me të gjitha figurat e jetës shoqërore e politike të vendit, thuhet në njoftimin e BFI-së.

17 Shkurti është një nga ditët më të rëndësishme të popullit shqiptar që jeton në Maqedoninë e Veriut, sepse shënon ditën më të ndritshme të arsimit sipëror në gjuhën shqipe – themelimin e Universitetit të Tetovës me mesim në gjuhën shqipe, i cili për kohën ishte një hap historik dhe vizionar në zgjidhjen një herë e përgjithmonë të çështjes së arsimit sipëror në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë Akademisë solemne Reis'ul-Ulemaja kishte mundësinë që të takohet me shumë figura të ndritura të vendit, me të cilët përkujtuan dhe diskutuan për rolin e madh që tregoi Bashkësia Fetare Islame në themelimin e këtij tempulli të dijes, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Disa orë më parë, në rrjetin social Facebook, në faqen zyrtare të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu kishte dalë me një Mesazh urimi për të gjithë udhëheqësit, profesorët e studentët, si dhe të gjithë ata që kontribuan në themelimin e Universitetit të Tetovës.

Në të thuhet: “Urime 17 Shkurtin, Ditën e themelimit të Universitetit të Tetovës (Universiteti Shtetëror i Tetovës), të gjithë drejtuesve, profesorëve, studentëve dhe atyre që kontribuan sadopak për ta kthyer atë ëndërr të kamotshme në realitet.

Të freskëta janë akoma kujtimet e asaj dite, kur si sot, 27 vite më parë, filluan ligjëratat e para shqip në Universitetin e parë shqiptar në Maqedoni. Që të gjithë, me vetëdije të lartë, i madh dhe i vogël, kontribuam në ngritjen e një tempulli të shenjtë të diturisë për një të ardhme më të ndritur të brezave të ardhshëm.

Arsimi është leva që e ngre njeriun në lartësinë e detyrës, të profesionit dhe të shkencës, duke e aftësuar atë që të jetë në gjendje t’u përgjigjet me sukses sfidave të kohës dhe, si të tillë, duhet ta ruajmë si dritën e syve.

Andaj, urime dhe qoftë e bekuar kjo ditë dhe të gjithë ata që kontribuojnë në edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj”, përfundon Mesazhi i urimit i Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, për Universitetin e Tetovës.

BOTOHET “BULETINI 2021”

Myftinia e Shkupit nxori nga shtypi përmbledhjen e aktiviteteve vjetore me titull “Buletini 2021”, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Botimi ka mbi 400 faqe dhe ruan dhe arkivon tërë punën e bërë të Myftinisë së BFI-Shkup gjatë vitit 2021.

Me një disenj modern, radhitur muaj për muaj, me datat brenda, janë me dhjetëra ngjarje - aktivitete të ilustruara me fotografi, që paraqesin punën dhe ‘arkivin vjetor’ të Myftinisë së Shkupit.

“Në emrin tim dhe të Myftinisë së Shkupit, i falënderoj nga zemra e shpirti të gjithë nëpunësit fetarë, hoxhallarët, imamët, këshillat e xhamive tona, si dhe donatorët, të cilët kanë qenë të përkushtuar me gjithë qenien e tyre në shërbim të xhamisë dhe të besimtarëve. Shpreh mirënjohje edhe për stafin e Myftinisë së Shkupit, që dha mundin e vet në aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021”, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

(9.02.2022)



JAKUP ASIPI, MODEL PËR TË GJITHË THIRRËSIT NË ISLAM

Pavarësisht se për ku i bënin ftesë, kur ishte në pyetje ndonjë aktivitet fetar apo kombëtar, ai ishte aty. Kishte interesim që njerëzve t'u tregojë se kush jemi e çka jemi. Ishte gjithmonë i gatshëm për t'u vënë në shërbim të të tjerëve për punë të mira.

**Nga Sead Ramadani
(Enkas për HeR)**

...Në këtë kohë, Republika e Maqedonisë së Veriut (atëherë RM) mori vendimin për pluralizëm politik, ku dhe filluan organizimet politike në parti të ndryshme. Shqiptarët u organizuan përmes Partisë për Prosperitet Demokratik – PPD.

I tërë angazhimi i PPD-së ishte ndarja e politikës shqiptare nga ajo maqedonase, sepse në zgjedhjet e para parlamentare kishte një numër bukur të madh të shqiptarëve që kandidoheshin nëpër listat e partive maqedonase, duke dashur ta vazhdojnë sikur në Partinë Komuniste të Jugosllavisë.

Në funksion të kësaj politike të PPD-së, në një tubim Jakup Asipi pati thënë: “Me rastin e këtij tubimi të kësaj fushate, do të shërbehem me fjalët e poetit të madh shqiptar Ali Asllani, i cili thotë:

*Qenka të mos na qenka një Adil bilmez
Vaji e lyp për nuse çupëzën time mbesë.
Fët e fët e mora një kongjill nga zjarri.
Dhe nga xhepi nxora një gjerdan prej ari.
I thashë bashkoi, e të dyja nuk bashkohen dot
Njëra prej floriri e tjetra për në kosh.*

Ai filloi të ndryshojë modelin e thirrjes islame, ku më vonë u bë model për të gjithë thirrësit në Islam. Në periudhën e pajtimit të gjaqeve dhe të ngatërresave Jakup Asipi ishte anëtar i Këshillit për Pajtim, ku roli i tij ishte shumë i rëndësishëm. Pas sukseseve në këtë aksion, Jakup Asipi edhe lumit që rrjedh nëpër Sllupçan i vuri emrin “Lumi i Pajtimit”.

Menjëherë pasi që Shqipëria i hapi kufijtë, në vitin 1992 ai vizitoi Shqipërinë së bashku me profesorin, drejtorin e Medresesë el-Furkan, Nurudinë Kurralli, ose, siç e quanin nxënësit e tij – Ebu Nur.

ME FJALËN E ALLAHUT NË ÇDO SKAJ TË SHQIPËRISË

Gjatë kësaj vizite shkuan nëpër shkolla fillore periferike për ta parë gjendjen e fë-

mijëve se në çfarë kushtesh mësonin. Në njërin nga këto shkolla organizuan një ekskursion falas për fëmijët nëpër Shqipëri. Në vitin 1993 u bë sebeb për ndërtimin e 3 xhamive, si dhe për të prezantuar fjalën e Allahut shëtit çdo skaj të Shqipërisë.

Deri në atë kohë s'ishte zakon të organizoheshin tribuna. Ai organizoi tribunën e parë, për të vazhduar më pas në të gjitha trojet shqiptare. Thotë Hoxhë Zekerija Bajrami: “Kjo solli një erë të re të njerëzimit dhe të rinia.”

Jakup Asipi mori pjesë bashkë me disa shokë të tij edhe në themelimin e SDA-së në Sarajevë të Alija Izetbegoviçit, thotë Kenan Mazllami nga Tetova. Gjatë viteve nëntëdhjetë (të shek. XX) ndihmoi rininë në çdo drejtim pozitiv. Ndhimoi në organizimin e Olimpiadës së Kurban-Bajramit, me lojëra të ndryshme sportive, si: vrapim në disiplinë të ndryshme, vrapim me kuaj, kërcim në një hap, tërheqja e litarit, demonstrim i karateistëve të klubit të karatesë “Besa”, lojëra akrobatike etj.

Ditën e premtë e prisnim me shumë kënaqësi jo vetëm për nivelin e ligjëratis që do ta dëgjonim, por edhe për prezencën e miqve që do të vinin. Në shtëpinë e Jakup Asipit për ditën e xhuma përgatitej bukë për miq rregullisht, sepse pas faljes së xhumasë miqtë nuk kishin mundësi të largoheshin pa shkuar te shtëpia e hoxhës e aty s'kalonte pa u shtruar bukë.

Jakup Asipi ishte aktiv direkt edhe në themelimin dhe organizimin e Lidhjes së Rinisë Islame në Maqedoni. Në xhaminë e fshatit përpos që kryente ritet dhe ligjëratat e xhumasë, ai edhe i mësonte fëmijët për mësimbesim, ku përveç tjerash nxori edhe rreth 20 hafëza të Kuranit. Në xhami përkrahu edhe kursin e rinisë për mësimin e gjuhës angleze. Ishte gjithmonë i gatshëm për t'u vënë në shërbim të të tjerëve për punë të mira.

Pavarësisht se për ku i bënin ftesë, kur ishte në pyetje ndonjë aktivitet fetar apo kombëtar, ai ishte aty. Kishte interesim që



njerëzve t'u tregojë se kush jemi e çka jemi.

Më kujtohet një nënë që kishte lindur fëmijën dhe po përgatiste një mindil (faculetë), si themi ne, për t'ia mbuluar sytë fëmijës. Jakup Asipi i pati thënë t'ia qëndisë në këtë mindil thënie: “*Nahnu min ehli sunne*” në gjuhën arabe; gjithmonë pa haruar se ne edhe shqiptarë jemi.

Këtë e dëshmoi kur e shkroi poezinë “*Ne jemi shqiptarë*”:

*Ne jemi shqiptarë dhe jemi me fe
Nuk ka popull n'botë më t'lumtur se ne
Ne jemi krenarë që jem' myslimanë
Kem'sunduar botën ne anembanë.*

*Zemerbardhë të gatshëm gjithë për durim
Jem' bujar dhe kemi dorë për pajtim
Ne Kuranin e kemi libër të shenjtë
Ai gjithnjë na mëson të jemi të njëjtë.*

*Pejgamberin tonë me zemër e dojm'
Dhe Kuranin natë e ditë e lexojm'
Ne gjith' shkencat n'botë do t'i mësojm'
Dhe armikut deri n'prag do t'i shkojm'.*

Gjatë kësaj periudhe gjendja gjithnjë e më e rëndë bëhej për shqiptarët në Kosovë, po edhe në këto anë. Jakup Asipi fokus të veçantë i dha ngritjes së vetëdijes te populli.

Në periudhën 1994-1998 ishte Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kumanovë.

Në vitin 1997 Kryetari i atëhershëm i shtetit dha një deklaratë për krizën eventuale në Kosovë, ku tha: “Nëse fillon lufta

në Kosovë, atëherë në Maqedoni duhet të hapet një korridor për ta deportuar popullin e Kosovës në Shqipëri.”

Jakup Asipi kësaj deklaratë iu përgjigj duke thënë: “Për shqiptarët e Kosovës nuk pyetet askush tjetër përveç neve.”

Në kontekst të kësaj, Jakup Asipi përpiloi edhe një poezi të shkurtër. Ai e përkroi popullin në 4 vargje:

*Ne jemi si uji
Që i qetë lundron,
Por atëherë kur nxehet
Djeg dhe përvlon.*

Kjo që tha Jakup Asipi u bë realitet. Të gjithë shqiptarët e Kosovës u vendosën brenda Republikës së Maqedonisë (sot: e Veriut).

Në një moment, në fshatin e Jakup Asipit kishte 4.000 refugjatë. Komandanti i Forcave të NATO-s, instaluar në Maqedoni në atë kohë, gjerman, e pati pyetur se sa refugjatë kishin pasur në fshat, kurse Jakup Asipi i pati thënë se ‘kemi më shumë se Gjermania’. Në pyetjen se ‘si po mund t'i mbani?’, ai i pati thënë: “Pejgamberi Muhamed (a. s.) ka thënë: ‘Buka e një njeriu është tamam për dy’. Jemi 4.000 banorë – kemi 4.000 miq.”

Për luftën e Kosovës ishte edhe bashkëpunëtor i shoqatave turke për mjekimin e të plagosurve dhe invalidëve të luftës në Turqi.

Në vitin 2000 në Sllupçan filloi aksioni për ndërtimin e xhamisë së dytë, ku Jakup Asipi u angazhua për mobilizimin e tërë njerëzve që të kontribuojnë në ndërtimin e xhamisë. Në këtë kohë ai e tha thënie famoze si model për ndërtimin e xhamive: “Rajoni i komunës sonë i ka 30.000 banorë. Po e dhamë nga 1 markë, për çdo vit nga një xhami apo shkollë do të ndërtonim dhe nuk do të ndienim lodhje.”

PËR STILIN OSMAN TË XHAMIVE

Në ndërtimin e xhamive dhe të minareve ishte gjithnjë i interesuar që ato të bëhen në stilin osman, për shkak të vijës së ecjes së Islamit deri te ne.

Pas mbarimit të luftës në Kosovë, filluan përgatitjet për një rezistencë mbrojtëse edhe në këto anë. Në fill të vitit 2001 filloi konflikti në Tanushë, duke u zgjeruar edhe në Malinë e Brezë. Në një moment u pyet se ‘çka mendon për UÇK-në?’. Ai pati thënë: “UÇK-në e shoh si një ushtri, e cila do të bjerë në rrafsh dhe do të fitojë në këtë luftë.”

Jakup Asipi nuk mundi të qëndronte duarkryq dhe filloi ngritjen e lidhjeve, me ç'rast më vonë do të bëhet mikpritësi i parë i njësitit të parë të UÇK-së me në krye Komandant Fadil Nimanin-Tigrin.

Ky njësi ishte i përbërë nga: Fadil Niman, Ismet Ilazi, Beadin Demiri, Mirsad Ndrecaj, Ejup Halimi së bashku me bashkëshorten e tij Jetmire Halimi dhe Beg Rizaj.



Që nga kjo ditë ishte pjesë përbërëse e ndërtimit të strategjisë për bërjen e një lufte sa më të organizuar dhe sa më të suksesshme.

Te shtëpia e familjes së Jakup Asipit ky njësi qëndroi vetëm një natë dhe shkoi në shtëpinë e Beadin Demirit (Badit), prej ku filloi rekrutimin dhe mobilizimin e të rinjve të fshatit e më gjerë.

Gjatë kësaj periudhe kohore Jakup Asipi nëpër takime me të rinjtë e fshatit thoshte se ‘duhet modifikuar poezia e Çajupit’:

*E dashura mëmëdhe
Të dua edhe kështu si je,
Por kur të të bëj të lirë
Do të të dua edhe më mirë.*

Gjatë kësaj periudhe Jakup Asipi arriti të sensibilizojë tërë rininë e fshatit dhe më gjerë për një rezistencë kundër forcave ushtarako-policore të asaj kohe.

Ia vlen të përmendet se Jakup Asipi në deklaratat në tv para se të fillojë lufta, pati thënë se në rajonin e Kumanovës janë 300 djem për t'i dalë zot atdheut për çdo rast. Kjo deklaratë për disa njerëz ishte shumë e papranueshme, por kur erdhi momenti, u dëshmuar se jo vetëm 300, por kishte

THËNIE TË MULLA JAKUPIT:

"Allahu ka thënë se ju nuk mund ta krijoni asnjë mizë! Leonardo da Vinçi një ditë e kishte vizatuar një mizë në fletoren e vet aq mirë, saqë profesori kur e pa, e trembi me dorë, se mendoi që ishte e vërtetë. Mirëpo, ajo miza është ende aty në fletore; ajo asnjëherë nuk ka fluturuar."

"Pa besim, mjeku bëhet kriminel. Kirurgu në vend se të pyet për gjendjen shëndetësore, ai të pyet se ku punoni! Po unë, o zotëri, kam ardhë me të tregu' se ku po më dhemb, e jo ku punoj."

"Nëse një popull dëshiron ta ndryshojë gjendjen e tij, duhet ta ketë shpjeguesin e mirë dhe zemrën e mirë; sepse, zemra është ajo që i kupton sendet, e jo veshi."

"Kur vendosni ta thoni të vërtetën, përgatituni për armiq!"

shumë më shumë djem që i dolën zot vendit të tyre.

Gjithashtu, përmes lidhjeve që kishte në Turqi, ai u ndihmoi të gjithë të plagosurve dhe invalidëve që të dërgoheshin atje për t'u shëruar.

Jakup Asipi ishte një prind shumë i mirë. Me pjesëtarët e familjes solidarizohesh në çdo drejtim. Jo vetëm që jepte kurajë, por edhe bëhej pjesë e punës apo gëzimit familjar.

Pas mbarimit të luftës, Jakup Asipi kontribut të madh dha për kthimin e stabilitetit dhe të sigurisë në rajonin e krizës. Në vitin 2003 u zgjodh Myfti i Myftinisë së Kumanovës, ku veproi deri më 7.01.2006.

Gjatë kësaj kohe mundësoi ndërtimin e dy minareve në qytetin e Kumanovës, te Xhamia e Re, të cilat e kanë ndryshuar pamjen e qytetit. Gjatë kësaj kohe bëri edhe hapjen e kësaj xhamie. Gjithashtu, bëri edhe hapjen e xhamisë në fshatin Allashec. E bëri edhe projektin e objektit të ri për Myftininë, projekt të cilin nuk arriti ta materializojë për shkak të aksidentit, që edhe i mori jetën.

Jakup Asipi ishte edhe bartës i iniciativës për forcimin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në xhumanë e fundit që ka falur, ishte myezin. Namazi i sabahut në xhaminë e fshatit Mateç, në ditën e shtunë (kur ka ndodhur aksidenti), ishte i fundit. Atë ditë ishte vënë në shërbim të fëmijëve të vet për nevoja martesore.

Bashkë me të bijën e tij, Rejhanen, kishin shkuar në Shkup dhe në të kthyer për në Kumanovë, papritmas ka filluar devijimi i veturës. Më pas ka filluar të rrokulliset dhe ka përfunduar jashtë rrugës, e pëmbysur.

Rejhani tregon: “Kur vetura pati filluar të devijojë, e kuptova se rreziku ishte shumë i madh, për shkak se baba-hoxhë filloi të bërtiste me zë të lartë *Allaah, Allaah.*”

Pasi që Rejhani del nga vetura, e gjen babain e saj në rrugë dhe ai bën me shenjë që të ndalë ndonjë veturë rasti për ndihmë. Rejhania lajmëron njerëzit e afërt.

E dërgojnë në spitalin e Kumanovës, e nga Kumanova e dërgojnë mjekët në Shkup dhe atje ndërron jetë, në spital.

Varroset në ditën e Arafatit, te Varrezat e Dëshmorëve në Sllupçan, më 8 janar 2006.

Pas vdekjes së Jakup Asipit, në kryeqytetin e Somalisë, Mogadishu, ndërtohet një xhami me emrin e tij, ku për inaugurimin e saj merr pjesë Zëvendëskryeministri i shtetit turk, Bekir Bozdar. Gjithashtu, edhe shoqata edukative “Vllaznia” hapi në Afrikë dy puse me emrin e tij, ku si donatorë ishin miqtë më të ngushtë të Jakup Asipit nga Shkupi, Tetova dhe Prishtina.

(Autori i këtij teksti është nip, djalë vëllai, i Mulla Jakup Asipit)

BOTA DHE KRIJIMI I SAJ

Marrë në përgjithësi, mu'tezilët konsiderojnë se kjo botë (kozmosi) është një sistem që i është nënshtruar parimit të mendjes (Madkuri 2003: 38). Madje, edhe bota vetë, nga ana tjetër, prezanton mendjen. Esenca e njeriut dhe e botës është mendja.

**Shkruan: Hasan Xhillo
(Enkas për Her)**

Teologët e të gjitha traditave religjioze që mbështeten në Shpallje mundohen të argumentojnë në mënyrë racionale krijimin e botës. Mësimi për krijimin e botës është një ide kryesore religjioze, e futur në mendim që nga Dhiata e Vjetër, me paraqitjen e vetëdijes semite. Kjo ide përmendet edhe në filozofinë greke, por nuk paraqet çështje të veçantë tematike, sepse asnjë traditë religjioze nuk mund të paramendohej pa konceptin e krijimit. Në qëndrimin e traditave teologjike thuhet: Zoti është krijues, kurse bota është krijesë. Konstatohen dy realitete, bota e përjetshme dhe bota e shfaqur.

Ekziston plasaritje midis këtyre dy realiteteve që tejkalohet me aktin e krijimit. Dallimi që përvijon tradita religjioze për krijimin e botës nga filozofia e lashtë greke është mohimi i absolutitetit dhe domosdoshmërisë së botës, që sipas filozofëve grekë nuk mund të mos ekzistojë, kurse sipas teologëve bota është e goditur nga kontingjenti dhe kjo plasaritje mes Zotit dhe botës duhet të argumentohet dhe ky është diskutimi kryesor i teologëve, filozofëve dhe sufistëve. Krahas argumentimit të njësisë së Zotit, si një koncept më i abstraktuar, ata gjerësisht flasin edhe për krijimin. Përmes konceptit të krijimit, ata argumentojnë transcencën e Zotit dhe jopërrjetësinë e botës dhe të gjërave në të. Kuptohet se të gjithë pajtohen se argumentet për qenësinë e Zotit janë të pamundshme pa abstraktuar konceptin e krijimit.

Ka një numër të madh të ajeteve kurranore që flasin për krijimin, e në këto ajete thirren edhe mu'tezilët. Argumenti i parë që ata paraqesin është përsiatja mbi substancën individuale (*xhevher al-vevel*). Ata konsiderojnë, njëjtë si edhe

Aristoteli, se kjo botë është përplot substanca individuale dhe se asnjëra prej këtyre substancave apo gjërave individuale nuk mund t'i mbajë "së bashku" të gjitha gjërat. Këtë nuk mund ta bëjë as substanca individuale, e cila në vete përmban një numër të pakufishëm mundësish për shfaqjen e gjërave brenda saj. Është e qartë se gjërat në botë nuk ekzistojnë vetvetiu, por sipas providencës së Zotit (*inajeh*). Kombinimi i pjesëve në një vend nuk është në fuqinë e tyre. Ngrohtë dhe ftohtë, për shembull, si dy gjëra kundërtë, nuk kanë fuqi në vete që t'i kombinonjë ose bashkojnë ato në një vend (Madkuri 2003: 38). Moduset ose gjendjet në gjësende varen nga Zoti, në fakt, nga relacioni ose komunikimi i gjësendeve me Zotin.

Teologët kanë më shumë formula. Më frekuentuese është kjo që vijon: bota është ndodhi dhe duhet të ekzistojë ai që e bën atë të jetë ndodhi (*hadith ve muhdith*).

PËR "PARIMIN E JASHTËM"

Kjo formulë tërheq me vete konsekuencat ose dilemat vijuese. Së pari, a janë gjërat para se të krijohehin përmbajtje të intelektit hyjnor? A janë gjërat para se të krijohehin diçka, apo asgjë? A varet kalimi i tyre nga e mundshmja në realitet prej tyre, apo nga ndonjë parim i jashtëm?

Për të zgjidhur këto dilema mu'tezilët iu referohen disa koncepteve dhe pikëpamjet e tyre dallojnë. Së pari, duke zbatuar procedurën ose metodën analoge, konceptin e trashëguar *ex nihilo* e vënë në lidhje me formulën *min qajri shejin*, se gjërat janë krijuar nga "hiçi" ose me ndërmytesimin e tij, se ato nuk kanë ekzistencë të përjetshme. Problemi kryesor është se si të vihet në relacion e përjetshmja dhe relativja, konstantja dhe e

ndryshueshmja. Ky problem nuk mund të zgjidhet me një interpretim të thjeshtë, sepse paraqet, vërtet, një problem të madh. Duhet kërkuar ndihmë nga argumentimi dhe terminologjia filozofike e filozofisë greke, për të sjellë argumente të qëndrueshme racionale që kërkon kureshtja e njeriut. Ajo që quhet "asgjë" (*ma'dum*) ndërmyteson mes Krijuesit dhe krijesës. Ajo "asgjë" nuk është asgjë në kuptimin tekstual të fjalës, por në raport me atë diçka, ajo e ka pozicionin primar ontologjik, prezanton një lloj esence, sepse thjesht flitet për të, ose vetëm ajo "asgjë" është në themelin e asaj "diçka" që e ndjek, dhe ajo diçka që e ndjek nuk është sinonim i qenësisë së vërtetë nëse merret parasysh fakti se ajo ka fillim dhe mbarim (*lehu bidajeh ve lehu nihajeh*), jo vetëm që e ka prejardhjen prej asaj "asgjë", por edhe mbaron në atë "asgjë" dhe si e tillë ekziston ashtu siç ka ekzistuar para se të ishte aktualizuar. Dhe, nëse supozohet se kjo "asgjë" është një lloj përmbajtje në intelektin e Zotit, atëherë supozohet se kjo është edhe esenca e vetë gjërave, sepse sikur të mos ishte ajo "asgjë", atëherë nuk do të ekzistonin as vetë gjërat. Prandaj, mu'tezilët sjellin formulimin në mendimin islam *madumat al-mumkina* (jo-ekzistuesit e mundshëm që janë në gjendje të jo-qenësisë para se të vihen në qenësi, ose në përkthimin më të lirë thuhet: esenca të paaktualizuara). Filozofët grekë nuk diskutojnë aspak për esencat ose qeniet e paaktualizuara, por flasin për qeniet e mundshme - për shembull, Aristoteli. Këto qenie ose esenca të paaktualizuara ose nihilizma paraqesin burimin e konceptimit të mundësisë së botës, të jetë dhe të mos jetë. Esencat e paaktualizuara, për të cilat më vonë kanë debatuar Ebu Nasir Farabiu, Ibn Sina dhe filozofë të tjerë, ndodhen mes Zotit dhe botës, Zotit dhe njeriut (Morewedge



1982: 294).

Ky koncept pati pasoja të fuqishme filozofike, e sidomos në mësimin mbi kontingentia, kontingjentin, për çka flasin edhe disa filozofë evropianë, siç janë: Thomas Aquinas, Kristian Volf, Imanuel Kant e të tjerë. Për kontingjentin që ndodhet në esencën e vetë gjërave.

Nuk ka dyshim se identifikimi *ma'dum* (jo-ekzistues, asgjë) me disa kategori në filozofinë e lashtë greke iu ndihmoi mu'tezilëve të sjellin disa argumente për krijimin e botës dhe dukurive në të. Këtu, kryesisht, ekziston materia para-ekzistuese te Platoni, e cila nuk ka kurrfarë forme dhe konceptime për të mundshmen dhe realen tek Aristoteli. Materia para-ekzistuese (protomateria), siç e mbështetin disa filozofë, është diçka abstrakte, jashtë së cilës shfaqen gjërat. Kjo materie nuk përmban formë, nuk është e formësuar, por është vetë abstraksion. Nëse vërtetohet se ajo ka formë, atëherë bie në regresion; materia do të ndahej në mate-

rie dhe formë, e kështu deri në pafundësi, thotë njëri nga platonistët e mëvonshëm - Ibn Baxhe. Mu'tezilët e pranojnë edhe qëndrimin e Aristotelit mbi të mundshmen dhe realen, por me ndryshime të caktuara, të cilat kanë të bëjnë me lëvizjen e gjërave. Dallimi është në atë se, sipas Aristotelit, parimi i kalimit të gjërave nga e mundshmja në realitet, varet nga vetë gjërat dhe ky parim nuk vjen nga jashtë. Tek Aristoteli është e paqartë edhe doktrina mbi materien dhe formën, ku nuk ka shpjegime se prej nga vijnë format në materie, kurse Zoti është forma përfundimtare ose më e lartë, e cila në mënyrë thelbësore është e lidhur me format e tjera, kështu që mes tyre nuk ka asnjë ndarje. Këtu mungon koncepti i të qenit problem qendror i diskutimit kur bëhet fjalë për Zotin dhe botën.

Mësimet e mu'tezilëve përmbajnë edhe momente të reja në aspektin e harmonizimit të terminologjisë islame dhe atomizimit të lashtë grek. Kur flasin për

krijimin, i referohen mësimin për atomet dhe atij konceptimi që konsideron se atomet janë të ndashme *ad infinitum/bi la nihajeh*. Megjithatë, koncepti i substancës individuale, për të cilën ata diskutojnë, është në kundërshtim me konceptin e materies së përjetshme. Në qarkullim janë disa nocione - sa i përket krijimit të botës. Së pari vënia e gjërave në ekzistencë (*takvin*). Ibn Huzejli përshkruan dallimin themelor midis aktit të krijimit dhe gjësendit të krijuar, kështu që akti i krijimit nuk është në vetë gjësendin vetvetiu, por ai vjen nga jashtë. Ibn Huzejli konsideron se ky është akti hyjnor "Bëhu!", i cili e vë gjësendin në sferën e të qenit (*takvin*).

Për ta shpjeguar pak më gjërësisht këtë problem, Jakub Shahani atë "asgjë", megjithatë, e karakterizon si "gjësend" ose si "diçka" dhe si e tillë paraqet objekt të diturisë së Zotit. Esenca e tij ka mundësi të jetë, të bëhet, esencë e aktualizuar. Shehrestani referon se, sipas disa mu'te-

zilëve, ne mund të japim dëshmi, në kundërshtim me dëshminë tjetër, siç janë, për shembull, qenësia dhe jo-qenësia, siç flasim për negacionin dhe afirmacionin, në mënyrë që të qenit dhe të konfirmuarit e diçkaje nuk e kanë të njëjtin kuptim, siç nuk kanë të njëjtin kuptim jo-ekzistuesi dhe i mohuari. Gjërat thelbësore, vazhdon Shehrestani, nuk i takojnë Bërësit (Zotit), por të qenit dhe realizimi është ajo që i takon Zotit (Shehrestani b.d.: 152).

Pas *takvin-it*, mu'tezilët flasin për lidhjen e brendshme në gjësende (*nexus*), për latentitetin e gjërave (*kenun*) dhe për shfaqjen e gjërave (*dhuhur*), pikërisht për lidhjen me konceptin e diçkaje (*shejija*) thelbësore, të kuptuar qoftë si modus ose si gjendje. Teoritë e mu'tezilëve dallojnë edhe në lidhje me këtë çështje. Aktualizimi i gjërave ose kalimi nga jo-ekzistenca në ekzistencë është vetëm ndryshim i gjërave. Këtu shfaqja e gjërave nga fshehtësia e tyre përfshin edhe ndryshimin e tyre. Ja, pra, po japim nga një shembull. Zoti e krijoi substancën, por jo edhe aksidencat që pasojnë, thotë Muameri, kështu që gjërat në natyrë paraqiten në mënyrë të natyrshme (ndezja e zjarrit nga dielli i nxehtë) (Shahrestani 1994: 49). Substanca, sipas Nazzamit, është latente. Minerale, bimë, kafshët dhe njerëzit, paraqiten nga një arketip (shembull) i tyre. Në kohën e Ademit janë krijuar të gjithë njerëzit, por ata janë të fshehur. Kur vjen koha e caktuar, njerëzit paraqiten si individë, si akte në atë arketip. Zjarri, për shembull, është i fshehur në gur dhe ai shfaqet në kohën e caktuar (*dhuhur*). Zoti e krijoi shkaku ose modusin për t'u paraqitur aksidencat, por nuk i krijoi edhe vetë aksidencat. Kur e hedhim një gur në lartësi, ai lëviz lart derisa ka fuqi në të dhe kur kjo fuqi ndalet, ai bie, në mënyrë të natyrshme, në vendin prej ku është hedhur - thuhet në njërin prej argumenteve të tyre (po aty: 43). Në gjësende ekziston *nexus*, pika ku bashkohen e mundshmjat dhe realja, dhe kështu ndodh kalimi nga jo-qenësia në qenësi. Ndarja pafundësisht e trupave ose substancave, sipas mu'tezilëve, është e pakufishme dhe iu përket mundësive; në fakt, gjërat në vete kanë një numër të pakufishëm mundësish, të cilat tregojnë krijimin ose rinovimin e vazhdueshëm të këtij krijimi (*tevellud, texhedud*). Prandaj, ndryshimet në botë, sipas mësimave të kësaj shkolle, nuk janë kreacione të reja, por aktualizim i mundësive (shih: Gardet & Anawati 1968: 170). Parimi i këtij aktualizimi, i cili ndodhet në vetë gjërat, nuk varet nga gjërat, por nga Zoti.

ESENCAT DHE E AKSIDENCAT

Mësimi i mu'tezilëve për krijimin e përjashton përjetësinë e botës. Ekzistojnë dy botë: ajo e esencave dhe ajo e aksidencave. Mu'tezilët sjellin konceptin për "jo-ekzistuesit e mundshëm", ose për atë që më vonë do të quhet "esencat e pandryshueshme" (*ajanu ath-thabita*). Shumica e mu'tezilëve, sipas Fahrudin Raziut, i cili edhe vetë ishte esencialist, konsiderojnë se janë "të mundshëm jo-ekzistuesit" para se të fitojnë ekzistencën e esencës dhe të vërtetës në cilat nuk vepron Bërësi (Zoti), por janë në sferën e mosqenies, sepse ato janë "asgjë" dhe i bën ato të jenë esenca ose entitete ekzistuese (*zavat al-mevxhude*). Dallimi mes tyre dhe Zotit ndodhet, siç kemi përmendur, në shkaku e qenësisë; për këtë arsye quhen *mumkine* (të mundshme). Mund të vërehet qartë se bëhet fjalë për përmbajtjet në intelektin hyjnor dhe se këto kanë, siç thotë Ibrahim Madkuri, ekzistencë mendore, sepse është e padrejtë nëse supozohet se ato kanë një status neutral midis qenësisë dhe jo-qenësisë ku nuk ka kalim nga njëra në tjetrën (Madkuri 2003: 43). Për t'u shmangur këtij problemi, Shehrestani, megjithatë, mësimin e tyre për statusin neutral të jo-ekzistentëve e vë në lidhje me arsyen, sepse është gabim të thuhet se ato nuk ekzistojnë në realitet dhe në arsye, se kanë njëfarë statusi të pavarur (Shehrestani 1994: 59). Në mënyrë të pashmangshme paraqitet problemi për të cilin flet edhe Gilsoni: nëse esencat nuk ekzistojnë në realitet dhe në mendje, atëherë ku mund të ekzistojnë ato, kështu që nuk ka një realitet të tretë përveç atyre në mendje dhe atyre jashtë mendjes, ose nëse ato nuk janë as substanca as aksidenca (Gilson 1952: 80-87). Këto jo-ekzistentë më vonë filozofët i quajnë esenca të cilat kanë një lloj gjysmë-ekzistence, së cilës duhet shtuar ekzistencën. Edhe Ibn Hazmi e thotë të njëjtën, se ato prezantojnë diçka në realitet dhe si mundësi, më saktë si "asgjë"; nuk kanë as fillim as mbarim (Ibën Hazmi 1975: 153). Me vetë faktin që do të themi errësirë, ose bardhësi, ne po flasim për diçka që nuk ekziston në realitetin e jashtëm. Logjikisht ky argument tregon këtë: nuk është e njëjtë, për shembull, të thuash "ngjyrë" dhe "është ngjyrë" (Raziu 1992: 18, 23). Ngjyra realizohet atëherë kur themi se ajo është, e këtë është e shtojmë më pas, kështu që vetë nocioni "ngjyrë" nuk tregon diçka ekzistuese ose jo-ekzistuese. Por, është e pamun-

dshme të mos vihet në relacion me mendimin. Pikëpamjet e mu'tezilëve në lidhje me këtë çështje janë të ndara. Shihami, për shembull, konsideron se "jo-ekzistenti" është diçka, entitet dhe esencë, dhe kjo posedon diçka, vazhdon Shehrestani, karakteristika subsistente për atë në sferën e qenësisë, siç është aksidenca e shoqëruar me substancën. Disa mu'tezilët nuk e pranojnë këtë qëndrim dhe jo-ekzistuesin nuk e quajnë diçka (*shejija*), duke e konsideruar këtë "diçka" të përjetshme, e ndodhia që emërtohet si diçka është vetëm në kuptimin figurativ dhe të zgjeruar, vjen në përfundim Shehrestani (Shehrestani 1994: 155).

Megjithatë, kur bëhet fjalë për jo-ekzistuesin, që ai paraqet "diçka", thotë Ebu Ala Afifi, do të thotë se bëhet fjalë për diçka të menduar (*ma'kul*), qenësia e të cilit ende nuk është realizuar në formën e diçkaje, kështu që ky jo-ekzistues ekziston në një botë ndryshe nga bota e jashtme (Afifi 1969: 213). Më tej, mendon Afifi, jo-ekzistuesi është esenca ose realiteti dhe Zoti nuk e krijon esencën e tij, por i mundëson të pranojë qenësinë. Jo-ekzistuesi nënkupton gjithashtu se është i përjetshëm dhe nuk karakterizohet si diçka kalimtare, është gjithmonë dhe përgjithmonë, megjithatë, karakteristika e tij esenciale, thotë Afifi, ekziston para ekzistencës së tij të jashtme, kurse cilësitë të cilat e pasojnë atë pranojnë aksidenca (po aty).

Akti i krijimit, sipas mu'tezilëve, është identik me dhënien e ekzistencës. Ose vetëm dhënia është krijim. Prandaj, rezultati përfundimtar i këtij argumenti të mu'tezilëve do të ishte se bota nuk posedon ekzistencë të përhershme; ajo është krijuar nga diçka, e jo nga asgjëja, dhe këto janë esenca të paaktualizuara dhe jo-ekzistentë me ndërmjetësimin e të cilëve mu'tezilët argumentojnë transcendencën e Zotit, e kjo është e pamundshme pa konceptin e krijimit që shfaqet ndërmjet Krijuesit dhe të krijuarës, sepse akti i krijimit dhe e krijuara nuk janë të njëjta. Këto jo-ekzistentë (*al-ma'dumat*) janë një lloj esence, sepse pa qenë ajo "asgjë", nuk do të ishte ajo "diçka".

Marrë në përgjithësi, mu'tezilët konsiderojnë se kjo botë (kozmosi) është një sistem që i është nënshtuar parimit të mendjes (Madkuri 2003: 38). Madje, edhe bota vetë, nga ana tjetër, prezanton mendjen. Esenca e njeriut dhe e botës është mendja.

(Autori është Profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)

NEVOJA PËR NJË STUDIM PROGRESIV

Libri ynë, Kurani, është grafullues dhe burim i shkencave; aty lind dielli dhe në të Zoti i Madhërishtëm i ka vënë njohuritë për çdo gjë; aty është çdo udhërrëfim e udhëzim...

Shkruan: prof. dr. Hajredin Hoxha

Nevoja është shumë e madhe për të bërë një lloj studimi progresiv të shkencave të Kuranit. Ata që merren me shkencat e Kuranit dhe që janë në shërbim të tij, duhet të mendojnë thellë rreth kësaj çështje dhe të hulumtojnë rreth mundësive të funksionalizimit pozitiv të disa shkencave të Kuranit. Habit fakti se, edhe pse ekzistojnë shumë studime të ndryshme kuranore, mungojnë studime shkencore metodologjike profesionale rreth funksionalizimit pozitiv të disa shkencave që kanë të bëjnë me Kurantin fisnik. Dobia shkencore e mrekullisë së Kuranit fisnik nuk përfitohet vetëm përmes hulumtimit rreth urtësisë së ligjeve të shpallura kuranore, por edhe përmes çdo shkence që është në shërbim të Kuranit fisnik. Të gjithë dijetarët janë unanimitë se Libri i Zotit të Madhërishtëm është absolutisht gjëja më e ndershme dhe më e shenjtë, si dhe gjëja më e vlefshme, për të cilën kanë shpenzuar kohën dhe jetën për ta studiuar.

Zoti e mëshiroftë Imamin Ebu Bekr Bakilani (402 hixhri), i cili për disa nocione thotë: "Gjëja më e çmueshme për ithtarët e fesë së Zotit që të zbulojnë, edhe atë në mënyrë prioritare, shtyllën e fesë së tyre, parimin e monoteizmit të tyre, që konsiderohet bazë dhe sistem, atë që është fakt për sinqeritetin e pejgamberit të tyre dhe fakt e argument për mrekullinë e tij, posaçërisht kur dihet se injoranca është e përhapur përplot me hipokrizi në mbarë horizontin. Dituria është shndërruar në leksione të kota e të thata, ndërsa ithtarët e saj janë në një kohë shtazarake dhe krahasohen me luanin e ashpër dhe se atë që e ofrojnë, është larg metodave dhe rrugës së saj.

Pra, njerëzit qëndrojnë para dy llojeve: njëri lloj është larg të vërtetës dhe rrugës së drejtë, ndërsa lloji tjetër është i pandihmë dhe i papërkrahje, dhe e gjithë



kjo ka ndikuar që ateistët të depërtojnë në bazat e fesë dhe t'i bëjnë të dyshojnë njerëzit e dobët në çdo të vërtetë. Ndhimësi e tyre janë të paktë, nuk kanë përkrahje, janë të braktisur nga familja dhe me ta luajnë të gjithë, saqë e tërë situata është rikthyer në atë që ka qenë më parë...ⁱ


Imam Bakilani (Zoti e mëshiroftë) në mënyrë decide e përshkruan pjesën dërrmuese të studimeve, për të cilat mendohet se janë në shërbim të Kuranit, por realisht janë shumë larg prej tij, sepse merren me çështje shkencore teorike sekondare e me bazat e fesë së Zotit, e as që konsideron shtyllë dhe themel të mendimit, nuk argumentojnë sinqeritetin e Pejgamberit (a. s.), e as që ofrojnë argument e postulat për mrekullinë e tij. Ne gjithashtu kuptojmë nga fjalët e Imam Bakilanit se çdo shkencë ka lidhje me shërbimin e Kuranit fisnik, qoftë nga aspekti faktik ose elokuent, madje edhe vetvetiu është mrekulli, sepse ka të bëjë me këtë Libër të shenjtë. Lidhja mes tyre është e pandashme. Nëse të gjitha shkencat grafullojnë nga Kurani fisnik, apo Kurani i sinjalizon shkencat primare, atëherë mund të them se çdo shkencë i shërben Kuranit, duke grafulluar edhe shkencat të tjera, dhe këtë gjë e kuptojnë

vetëm dijetarët e jo edhe injorantët. Mrekullitë, shkencat dhe artet e Kuranit nuk përfundojnë asnjëherë, sepse në mënyrë të vazhdueshme është aktual sikur të shpallej sot, si dhe i thotë njeriut urdhëro tek unë dhe gjeje jetën e mirë, lumturinë e vërtetë, diturinë dhe shkencën e re. Njëri që merrej me hulumtimin e shkencave të Kuranit, nxori disa shkenca të reja për të cilat nuk kanë folur të parët tanë. Shkenca e parë e re është "arti i zburimit në Kuran", shkenca e dytë: "Arti i qeshjes dhe i komedisë", pastaj shkencat e tjera: "shkenca e fshehtësive..."ⁱⁱ

"ME NDIKIM TË LARTË NË SHPIRT"

Imam Abdulkadir Xhurxhani (Zoti e mëshiroftë), i vdekur në vitin 471 hixhri, thekson funksionalizimin e një shkence tjetër nga shkencat e Kuranit e që është e dobishme njësoj si shkencat e tjera që kanë të bëjnë me Kurantin fisnik, përkatësisht shkenca e shembujve dhe ilustrimeve në Kurantin fisnik, dhe në këtë kontekst ai thotë:

"Dije se dijetarët janë unanimitë se nëse vjen ilustrimi, përdoret me koncepte të përpiktë, janë shumë të thuktë, e



ilustronjë formën origjinale në mënyrë të mrekullueshme dhe precize e me domethënie të rëndësishme, ndikuese tejmasë, nxitëse të shpirttrave, atraktive për zemrat, me kuptime të largëta, me natyrë të afërt e të dashur. Nëse lavdëron, është i qartë dhe i pasur, me ndikim të lartë në shpirt, i dridh ndjenjat, është praktik, ndez lumturinë dhe e mbron tërësisht të lavdëruarin, obligon ndërmjetësim për lavdëruesin, iu ofron çdo gjë tejmasë, me fjalë të lehta e që mbahen mend, menjëherë ngjitet për zemër. Nëse është qortim, ka ndikim të dhimbshëm, irritues, i mprehtë, i ashpër. Nëse është mbulesa, ka veprime të ndritshme, fuqi të madhe, fjalë të kthjellta. Nëse është krenari, ka shprehje të sakta, autoritare, me gjuhë të ëmbël. Nëse është kërkim faljeje pranimi, është më i afërt, më afër zemrës, më i hidhët për të këqijtë, për të hidhëruarit sulm dhe për ata që fryjnë për të keq sulm, për rikthim të mirë më i kapshëm; Nëse është kështu, është më i shërueshëm për zemrën, më përsiatës, më i qartë në kujdes, zbulues, tregon qëllimin, shëron të sëmurin. Pra, kështu ndodh nëse i lexon me vëmendje artet e fjalës dhe shprehjes me derë e pjesë të ndryshme...ⁱⁱⁱ

Pra, nëse këto shkenca që kanë të bëjnë me Kuranin fisnik i bëjnë funksionale në aspektet e da'ves, arsimit e kulturës, nuk ka dyshim se do të realizojnë obligimin tonë të madh ndaj mësimit tonë fetar, në da'vetin islam, në edukatën e gjeneratave me edukatë të shëndoshë në dritën e ajeteve kuranore dhe shkencore të ndërlidhura me të.

Imami dhe komentuesi Ebu Saud thekson rëndësinë e kësaj shkence në tefsirin e tij:

“Ilustrimi bëhet vetëm me fjalë të caktuara për çështje të njohura, e zbukuron racionalen me atë shqisore, i parashtron konceptet në formë të njohur, largon iluzionin nga kundërshtimi ndaj intelektit, i nxjerr të vërtetat e fshehta, i bën të kuptohen çështjet me përputhshmëri të plotë, për të vazhduar në atë që duhet, e mënjanon të panevojshmen, dhe për këtë shkak numri i shembujve në librat hyjnorë dhe në fjalët profetike është i madh. Këto ishin të njohura në shprehjet e elokuentëve dhe në thëniet e të mençurve. Ilustrimi është mënyra më e mirë për nënshtrimin e iluzionit para intelektit dhe për mbrojtjen e pozitës së duhur, forma më e mirë për ta bërë injorantin debil të kuptojë, i bën fjalët të nguliten. E si të mos jetë kështu, kur dihet se i zbulon gjërat e fshehta në botën e pastër e të prekshe, të panjohurin e bën të njohur dhe të huajin në formë të afërt...^{iv}

Imam Sujuti (911 hixhri - Zoti e mëshiroftë) është i njohur me thënien e tij në këtë çështje:

“Dhe pastaj dituria është deti i gjerë dhe i pafund, nuk mund të ecet mbi të e të zhytet, dhe kush dëshiron të bëjë një gjë të tillë, nuk do të ketë mundësi, madje as që do të mund t'i numërojë të gjitha. Si të bëhet një gjë e tillë kur Zoti i Madhërishtëm iu thotë krijesave të Tij: “Nuk ju kam dhënë dituri, përveç se pak” (Isra, 85). Libri ynë Kurani është grafullues dhe burim i shkencave, aty lind dielli dhe në të Zoti i Madhërishtëm i

ka vënë njohuritë për çdo gjë; aty është çdo udhërrëfim e udhëzim; secili artist nxjerr prej aty atë që e kërkon: juristi i nxjerr parimet e ligjet, ligjet për hallall dhe për haram; gramatikani i nxjerr rregullat gramatikore për të bërë dallimin në fjalë mes gabimit dhe të saktës; retoristi ndjek sistemin e bukur të tij, duke i aplikuar mënyrat e elokuencës në thurjen e fjalës; aty ka rrëfime dhe lajmërimi që i kuptojnë të mençurit, ashtu siç ka këshilla dhe shembuj me të cilët i mahnit mendimtarët dhe përsiatësit. Aty ka edhe shkenca të tjera, të cilat nuk mund të rrumbullakohen, përpos Atij që i di të gjitha.”^v

Njeriu që mendon thellë rreth fjalëve të Sujutiut (Zoti e mëshiroftë), do të kuptojë qartësinë e mesazhit dhe konceptin e kërkuar dhe për këtë shkak mendoj se nuk duhet sqaruar mendimin e tij që të mos e teproj me komente e fjalë të panevojshme. Rrëfimi i tërë tekstit të tij mbështetet në fjalët: “Vërtet libri ynë Kurani është grafullues i shkencave dhe burim i tyre”, dhe “e sheh se çdo artist prej tij nxjerr dhe aty mbështetet”. Edhe pse fjalët e tij të bëjnë të mendosh për diçka që është ndryshe nga të parët gjatë studimit dhe zbrërthimit të fjalëve të dijetarëve të mëparshëm rreth Kuranit si përmbledhës i shkencave të të parëve dhe të mëvonshmeve, dhe kjo nuk është pjesë e hulumtimit,^{vi} përsëri unë i jap liri vetes dhe them se fjalët e Sujutiut duhet të jenë cytëse dhe nxitëse të fuqishme për ne që merremi me këto lloje studimesh të përparuar, që të shohim begatitë e përgjithshme të mrekullisë kuranore në sferën e da'vetit, arsimit, bihaviorizimit

dhe intelektit. Pse të mos e zhvillojmë e të mbështetemi në shkencat e tilla që kanë të bëjnë me Kuranin fisnik!? Nuk ka nevojë të zhvillojmë shkencat e formuara, por do t'i përdorim për të përfutur dobi prej tyre deri në Ditën e Gjykimit, si p. sh. gramatika, stilistika, retorika dhe do t'i ruajmë nga duart e debilëve, ndërsa shkencat që nuk janë zhvilluar, do t'i ndihmojmë që të zhvillohen duke i rishqyrtuar disa lloje të tyre (sa shumë janë llojet e tilla!), që të kemi dobi prej tyre në kohën tonë.

Pastaj, gjatë leximit të literaturës që ka të bëjë me këtë çështje, edhe pse vlerësoj studimin e të parëve unë gjeta edhe një çështje të re që është shumë e rëndësishme në zbulimin e shkencave të reja në Kuranin fisnik, dhe titulli i këtij studimi është: “Stilistika - vizion në formimin kuranor,^{vii} dhe njësoj ashtu siç theksonin dijetarët dobinë e shkencës së shembujve që ka të bëjë me shkenca e Kuranit, mendoj se kjo çështje gjendet në katër gjëra që nuk mund të gjenden ndokund tjetër: shprehjet e thukëta, preciziteti në kuptim, ngjashmëria e bukur dhe metonimia e saktë; dhe e gjithë kjo paraqet formën më të lartë të retorikës.

Për të arritur në një koncept të plotë të kësaj ideje, duhet sqaruar mënyrën e funksionalizimit pozitiv të disa shkencave që kanë të bëjnë me Kuranin fisnik, ashtu siç duhet sqaruar edhe funksionalizimin e keq dhe negativ të disa shkencave që kanë të bëjnë me Kuranin fisnik nga ana e një numri të madh djajsh e falsifikatorësh (orientalistë), si dhe të atyre që vazhdojnë rrugës së tyre, që ta kuptojnë më së miri këtë çështje.

Siç duket, përgjigjja fshihet në qëndrimin tonë ndaj metodës së armiqve të Islamit dhe në zbrërthimin e metodave të tyre në raport me Kuranin fisnik gjatë aplikimit të funksionalizimit të keq e të urryer në shumë shkenca e çështje kuranore për ta thumbuar Librin, të cilin nuk mund ta dëmtojë askush e as që ka ndonjë shpallje tjetër pos tij nga i Urti e Gjithëfalënderuesi.

ORIENTALISTËT DHE FUNKSIONALIZIMI NEGATIV

Si përgjigje nda pyetjes paraprake rreth funksionalizimit negativ të një pjese dërrmuese të shkencave të Kuranit nga shërbëtorët e sinqertë të djallit dhe ushtarëve të tij, nga njerëzit, mund të themi se, për fat të keq, të tillët na kanë

paraprirë me orvatjet e tyre individuale dhe institucionale në funksionalizimin e shkencës së ajeteve mekase dhe medinase për qëllime fetare, për të thumbuar dhe për të formuar dyshim në vërtetësinë e Kuranit mekas dhe medinas - qoftë në mënyrën e formulimit të ajeteve, ose në karakteristikat e da'vetit dhe të stilistikës.

Disa dijetarë theksojnë se mënyrat^{viii} e orientalistëve për të thumbuar dhe për të formuar dyshim në Librin e Zotit të Madhërishtëm janë të llojllojshme e të ndryshme, si dhe pjesa dërrmuese e tyre e ka aplikuar metodën individuale,^{ix} e që ka të bëjë me përkatësinë fetare, shkencore apo historike të orientalistit dhe ndikimin e këtij aspekti në studimet dhe hulumtimet e shkencave islame, duke arritur shkallë të ndryshme varësisht nga kultura e tyre e jo nga domosdoshmëria të cilën e kërkon studimi shkencor i burimeve islame nga teoritë dhe vizionet...^x

Për sa i përket metodës së orientalistëve në thumbimin e ajeteve mekase dhe medinase, ata kanë ndjekur rrugën e stërgjyshërve dhe mësuesve të tyre që ishin si djaj e mashtues, si p.sh., Blasheri, Noldeke, Ignaz Goldziher, Shaht, Muir, Bell, Rodinson etj. Orientalistët janë të shumtë me ndarjet në mes ajeteve mekase dhe medinase, saqë filluan të thonë se ekziston Kuran mekas dhe Kuran medinas me metoda të ndara,^{xi} nga aspekti i stilit dhe përmbajtjes. Këtë ide e planifikoi Blasheri në librin e tij: “El-Med’hal ilet-Kur’an”, dhe sipas tij Kurani fisnik ka qenë nën ndikimin e dy ambienteve mekase dhe medinase, si dhe mes tyre ka dallime të dukshme.

Orientalistët në përgjithësi janë mbështetur në shumë çështje të ndryshme për të formuar dyshime, si p.sh. origjina njerëzore e Kuranit fisnik, pastaj dhuna, ashpërsia dhe vrazhdësia në suret mekase,^{xii} dhe e gjithë kjo tregon për ndikimin e ambientit mekas te Pejgamberi (a. s.) për shkak të përdorimit të mënyrës së të folurit që ishte karakteristikë e banorëve të Mekës, si p.sh., ashpërsia, injoranca e inati.

Orientalistët janë orvatur që t'i zmadhojnë karakteristikat e tilla dhe t'i funksionalizojnë me një metodë negative.^{xiii}

Në këtë drejtim dëshiroam që të japim një pasqyrë e jo t'i shqyrtojmë dyshimet e tyre rreth ajeteve mekase dhe medinase, sepse hulumtimi ynë nuk ka të bëjë me këtë çështje, por thjesht vetëm kisha dëshirë që të potencoj kujdesin që duhet pasur nga rreziku i këtij

funksionalizimi negativ nga ana e “intelektualëve”.

(Autori aktualisht ligjërën në disa universitete në Katar në gjuhën arabe dhe angleze. Tekstin për “Hënën e Re” e sjell prof. dr. Muhamed Mustafa, ligjërues i Gjuhës Arabe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)

ⁱ Bakilani, I’xhazul-Kur’an, Darul-me’arif, Kajro, fq. 4.

ⁱⁱ Dr. Abdulkadir Mensur, imam dhe ligjërues në Xhaminë Sejfid-deuleti në Halep, “Meusuatu ulumul-Kur’an, Darul-Kalem, bot. I, 2002, fq. 7.

ⁱⁱⁱ El-Xhuxhaxhi, Esrarul-belaga, Mektebetul-mishkat el-islamijeti, në internet: www.almishkat.net/books/php?book=1458.cat=16

^{iv} El-Amadi, Irashadul-aklis-selim ila mezajal-kitabil-kerim, (982 hixhri), bot. II, Daru Ihjait-turathil-arabij, Bejrut, 2006, vëll. I, fq. 50.

^v El-Itkan fi ulumil-Kur’an, vëll. I, fq. 18-19.

^{vi} Këtë çështje e kam shqyrtuar në doktoratën time në gjuhën arabe, që titullohet: “El-Itixhahat el-fikrije ved-diniye fid-derasatil-kur’anijeti leda ulemail-fil-karnit-tasi’asher vel-ishrin”, në kapitullin e komentimit shkencor. Libri në fjalë është botuar në gjuhën arabe në përkthim të dr. Muhamed Mustafa, bot. I, 2009, Çabej, Tetovë, Maqedoni.

^{vii} Dr. Abduladhim Sugajri, Kitabul-ummeti - revistë mujore që botohet në Drejtorinë e Hulumtimeve dhe Studimeve Islame në Katar, nr. 151, Ramazan 1433.

^{viii} Berstraser, Gutelhof, Usulu naksin-nusus ve neshrul-kutub, ligjëratë e orientalistit gjerman, e mbajtur në Fakultetin e Filologjisë në vitin 1932, përgatiti Muhamed Hamdi Bekri, vëll. 2, 1995, Mektebetu daril-kutubil-misrijeti, Kajro, fq. 10-35.

^{ix} Shih po ashtu librin e Ebu Lejlës: “El-Kur’an minel-mendhuil-istishrakij, vëll. 1, 2002, Darun-neshri lil-xhami’at, Egjipt, fq. 191-231, 237-254.

^x El-Ajd, Zejd ibën Umer, El-Mekkij vel Medenij fi ujunil-musteshrikine, fq. 8-9.

^{xi} Për sa u përket dyshimeve që ndjellin orientalistët dhe misionarët arabë rreth çështjes së ajeteve mekase dhe medinase, si p.sh. prifti El-Haddad, shih librin e prof. Muhamed Izzet Deruzi: “El-Kur’an vel-mubash-shirun, vëll. 3, El-Mekteb el-islamij, 1978, Damask, fq. 94-115.

^{xii} El-Ajd, Zejd ibën Umer, El-Mekkij vel Medenij fi ujunil-musteshrikine, fq. 8-9; El-Buti, Kubral-jekiniyat el-keunijje, bot. 9, 1997, Damask, fq. 31-74.

^{xiii} Kam hasur replika shkencore, të fuqishme e bindëse rreth këtyre dyshimeve që i ndjellin rreth ajeteve mekase dhe medinase në veprën e shejhit dr. Muhamed Abduladhim Zerkani: “Menahilul-urfan fi ulumil-Kur’an”; dr. Ahmed Muhamed El-Fadil: “El-Itixhahul-ilmanij el-measir fi ulumil-Kur’an”; dr. Ahmed Idris Ta’an, “El-Ilmanijune vel-Kur’anul-Kerim”; prof. dr. Muna Muhamed Bedihij: “Et-Tejjarul-ilmanij el-hadith ve meukifuhu fi tefsiril-Kur’anil-Kerimi” (Zoti e mëshiroftë).

MREKULLIA E ISRASË DHE E MIRAXHIT NGA PRIZMI SHKENCOR

Ngjarje të këtilla kanë ndodhur edhe para se të ngrihet i dërguari i Allahut (s.a.v.s.), Muhamedi, i biri i Allahut, në qiejt më të lartë, porse ai u kthye pas ngritjes dhe nuk qëndroi atje si ndodhi me pejgamberët dhe të dërguarit tjerë para tij. Ky u kthye për të përfunduar dhe kompletuar mesazhin hyjnor, për të përhapur udhëzimin, të vërtetën dhe drejtësinë në tërë globin.

Nga Dr. Karim Sejid Gunejmi

Ajnshtajni në teorinë e relativitetit vitin 1905 inkorporoi hapësirën dhe kohën, duke thënë: “Nuk duhet të flasim për kohën pa hapësirën, e as për hapësirën pa kohën dhe për sa kohë që çdo gjë lëviz, ajo duhet patjetër të ketë edhe kohën e saj me vete dhe sa më shpejt të lëvizë koha e saj, tkurret më shumë në raport me lëvizjet tjera që janë më të ngadalta se ajo.”

Fenomeni i tkurrjes së kohës është vërtetuar shkencërisht në laboratorët e fizikës, ku u vu re se grimcat atomike kanë jetë të gjatë në sytë e vëzhguesit të saj nëse lëvizin me një shpejtësi afër shpejtësisë së dritës. Si shembull, shtohet gjysma e jetës së një pioni (*gjysma e jetës është koha e nevojshme që kjo grimcë të kalbet në mënyrë radioaktive derisa të arrijë gjysmën sasisë së saj*) në orën laboratorike të tokës rritet deri në shtatë herë vlera e saj e njohur, nëse lëviz me shpejtësinë prej 99% të shpejtësisë së dritës.

Sipas teorisë së Ajnshtajnit, nëse imagjinojmë se një raketë, shpejtësia e së cilës është shumë afër shpejtësisë së dritës, do të bëjë një udhëtim të gjatë pesëdhjetë mijë vjet (sipas orës së tokës) vetëm për një ditë. Nëse mendoni të vizitoni periferinë e universit, atëherë do të ktheheni në glob dhe do të gjeni gjenerata të reja të tjera dhe ndryshime të mëdha që kanë ndodhur në këtë planet, të cilat do të kenë kaluar deri atëherë mijëra, miliona apo miliarda vite sipas llogaritjes së njerëzve në tokë, të cilët nuk e kanë kaluar me ju këtë udhëtim të mahnitshëm. Tërë kjo ndodh sikur në udhëtimin

tuaj të kishit lëvizur me një shpejtësi afër shpejtësisë së dritës!! Si përfundim, koha tkurret me rritjen e shpejtësisë dhe shpejtësia rritet me rritjen e fuqisë për ta bërë atë.

Ky është një fakt bindës për materialistët se shpejtësia, koha dhe fuqia janë gjëra të ndërlidhura mes vete. Por, nëse ekziston një krijesë më e fortë se njeriu, që i përket një bote dhe race tjetër siç janë xhindet ose melaqet, atëherë ajo krijesë lëviz me ligje të tjera jashtë ligjeve të njeriut. Ato kalojnë distanca dhe barrierat dhe pengesa tjera që nuk mund t'i imagjinojë njeriu, i cili jeton në planetin tokë. Sipas teorisë së relativitetit, nëse ka një

objekt që udhëton me një shpejtësi më të madhe se shpejtësia e dritës, distancat shemben para tij dhe koha kalon me shpejtësi të madhe në përshkrimin e këtyre distancave.

Megjithëse shpejtësia e dritës në ajër është shpejtësia më e lartë e njohur deri më tani, shkenca moderne bashkëkohore nuk mohon ekzistencën e një shpejtësie më të madhe se shpejtësia e dritës në ajër (vakum), edhe pse ajo nuk është arritur të vërtetohet ende. Rrjedha e grimcave Beta (B-particles) në ujë është më e madhe se shpejtësia e dritës në të, sepse këto precipitete depërtuan në barrierën e dritës në ujë dhe jo në ajër, duke shkaktuar emeti-

min e rrezatimit të quajtur rrezatim Cherenkov (ang. **Cherenkov radiation**)!!

PSE PO E STUDIOJMË MREKULLINË E ISRASË DHE TË MIRAXHIT?

Me këtë prezantim shkencor kemi për qëllim që t'u afrojmë njerëzve një nga mrekullitë shqisore që i ka ndodhur të dërguarit të Allahut, Muhamedit (s.a.v.s.) e ajo është mrekullia e Israsë dhe Miraxhit. Ne me këtë prezantim nuk synojmë e as nuk kërkojmë që përmes këtij shpjegimi të vërtetojmë vërtetësinë e mrekullisë së Israsë dhe Miraxhit, porse po synojmë të afrojmë kuptimin e saj sa më lehtë për ata që e kontestojnë ekzistimin e kësaj mrekullie nga radhët e jomyslimanëve. Kjo mrekulli është nga lloji i mrekullive që Allahu (xh. sh.) nuk synoi sfidimin e njerëzve dhe gjëra më e mahnitshme në lidhje me këtë mrekulli është (me dy pjesët e saj) se ajo është e padukshme dhe u takon çështjeve të metafizike që njeriu duhet të besojë dhe të bindet në të.

Këtë mrekulli nëse e diskutojmë, atëherë diskutojmë për të vërtetuar pamundësinë e shfaqjes dhe të ngjarjes së saj për njerëzit e rëndomtë e të zakonshëm me të gjitha standardet shkencore apo edhe duke aplikuar edhe hipoteza e teori. Përndryshe, do të humbiste karakterin e saj si mrekulli dhe njeriu i rëndomtë do të kishte mundësi ta rriste atë, duke përdorur ndonjë energji apo mjet të shpikur nga shkenca me kalimin e kohës.

Duke folur për mrekullitë shqisore (his-sije) të të dërguarit të Allahut

(sa.v.s.), nuk duhet ta teprojmë me të, nuk duhet të mbështetemi shumë në këto mrekulli për të bindur njerëzit për mesazhin e të dërguarit të Allahut (s.a.v.s.), sepse këto janë mrekulli që ndodhën dhe përfunduan. Edhe vetë Pejgamberi (a. s.) ka ndaluar që të kapemi shumë pas këtyre mrekullive materiale, por na ka urdhëruar që t'i kushtojmë vëmendje një mrekullie e cila mbetet me kalimin e kohës deri në Kiamet, e ajo është Kurani fisnik. Në të zbulohet e vërteta e mrekullive me kalimin e kohës dhe të gjeneratave. Çdo gjeneratë zbulon një aspekt ose aspekte që nuk u zbuluan nga gjeneratat e mëparshme. Në kohën e të dërguarit të Allahut (s.a.v.s.) ka ndodhur eklipsi i diellit kur vdiq Ibrahim, djali i Pejgamberit (a. s.), e njerëzit thanë: Dielli u errësua për shkak të vdekjes së Ibrahimit, e Pejgamberi (a. s.) tha: **“Vërtet dielli dhe hëna janë dy shenja (argumente) prej shenjave të Allahut; nuk errësohen për vdekjen e askujt e as për jetën e askujt.”**

Mrekullia e Israsë dhe Miraxhit ndër të tjera përfshin edhe shpejtësinë e jashtëzakonshme dhe fuqinë mahnitëse me të cilën u bart i dërguari i Allahut (s.a.v.s.). Në pjesën e parë të mrekullisë përfshihet “udhëtimi tokësor” nga Qabeja (Mekë- Gadishulli Arabik) deri në xhaminë e Aksasë (Jerusalem).

Pastaj në pjesën e dytë demonstron edhe shpejtësia dhe fuqia që njeriu nuk ka mundësi pavarësisht nga përparimi shkencor dhe teknologjik që ta realizojë, e kjo është “udhëtimi përpjetë – Miraxhi”. Miraxhi nënkupton ngritjen nga aty

ku përfundon udhëtimi tokësor dhe përfundoi në majën e një udhëtimi qiellor, në të cilin i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) depërtoi në të gjitha shtresat e atmosferës deri në qiell. Njeriu nuk ka mundur e as nuk do të mund të arrijë dhe të përcaktojë asgjë në te, dhe nuk do të dijë asgjë për të, përveç asaj që na ka informuar Kurani famëlartë.

UDHËTIMI I ISRASË, UDHËTIMI TOKËSOR NË BOTËN E MELAQEVE

Allahu (xh. sh.) në Kurani famëlartë thotë: **“Pa të meta është Lartmadhëria e Tij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamësi (i punëve të Muhamedit). (El Isra: 1) Nocioni “subhane” nënkupton pastërtinë dhe përsosurinë e Allahut (xh. sh.) në fjalët e tij, pastërtinë dhe përsosurinë e Tij në veprime, pastërtinë dhe përsosurinë e Tij në cilësime, pra absolutizmin e Tij në çdo gjë. Nocioni “ar. esra – e barti” nënkupton se Pejgamberi (a. s.) u nderua duke u bartur në një udhëtim nate nga një fuqi tjetër, nga një vend në një vend tjetër. Nocioni “ar. abdihi- me robin e Tij”, do të thotë robin e Tij, njeriu të cilin e zgjodhi për të kryer këtë mision dhe detyrë madhështore, që është detyra e udhëzimit të mbarë njerëzimit. Allahu (xh.sh.) nuk**



tha: “*bi halilihi- me mikun e Tij*” ose “*bi habibihi- me të dashurin e Tij*”, e as “*bi nebijihi – me peygamberin e Tij*”, porse tha “*bi abdihi- me robin e Tij*”. Kjo na e tërheq vëmendjen në një fakt shumë të rëndësishëm, që është se i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) përmbushi pozitën e të qenit rob i pastër ndaj Zotit të Plotfuqishëm, ishte rob i kompletuar dhe njeri i kompletuar. Kërkesa e parë që e kërkon Islami nga ne është realizimi i robërisë së pastër ndaj Zotit të Madhërishtëm.

Nocioni “lejlen-natën” na argumenton se udhëtimi ishte në një pjesë të natës dhe nuk zgjati tërë natën. Nata ishte koha e dy udhëtimeve, sepse kjo është koha më e dashur e vetmisë, ishte koha më e preferuar e Pejgamberit (a. s.) për namazin e tij, besa kjo ishte koha e namazit para se të obligoheshin pesë kohët e namazit të njohura për ne. Ngjarja e Israsë u realizua natën, në mënyrë që besimtari të jetë më i përforcuar në besimin e tij në gjërat e fshehta.

Sa i përket pjesës së ajetit ku thotë: “*minel mesxhidil harami ila el mesxhidil aksa - prej Mesxhidi Haramit gjer në Mesxhidi Aksa*”, shpjegohet se udhëtimi i të dërguarit të Allahut (s.a.v.s.) në udhëtimin tokësor ishte mes dy xhamive. E para është Qabeja në Mekë, e cila është shtëpia më e dashur e Allahut (xh. sh.) në rruzullin tokësor, ku një namaz në këtë xhami kap vlerën e njëqind mijë namazeve jashtë saj, dhe e dyta është Xhamia e Aksasë në Jerusalem, djepi i pejgamberëve dhe të dërguarve, xhamia e cila ishte kibleja e parë e myslimanëve para se të vinte urdhri për ndërrimin e kibles drejt Qabesë. Xhamia El Aksa është një nga xhamitë më me vlerë në tokë, ku namazi në te kap vlerën e pesëqind namazeve jashtë saj në xhamitë tjera.

Pjesa e ajetit “*el-ledhi barekna havlehu - rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar*”, bekime që i kemi dhënë asaj dhe rrethinës së saj, bekime të kësaj bote dhe bekime kuptimore. Kurse pjesa e ajetit “*linurijehu ki ajatina - për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona*”, nënkupton disa nga argumentet që dëshmojnë për fuqinë dhe madhërinë e Allahut (xh. sh.) e jo të gjitha argumentet.

Mrekullia e Israsë dhe e Miraxhit ishte shpirtërisht, fizikisht, apo me të dyjat bashkë?

Dikush mund të thotë se Udhëtimi i Israsë, me më prioritet do të ishte Miraxhi t’i ketë ndodhur Pejgamberit (a. s.) natën, në ëndërr, duke qenë në gjumë, pra pamje ëndërrorë, që nënkupton se ishte vetëm udhëtim shpirtëror, por jo edhe fizik. Kësaj thënie ne i përgjigjemi duke

thënë: Udhëtimi tokësor po ashtu edhe udhëtimi qiellor (Israja dhe Miraxhi) kanë ndodhur me shpirt dhe me trup bashkërisht. Këtë e vërtetojnë argumente të shumta të pakundërshtueshme. Argumentet më të fuqishme vijnë nga vetë Kurani Qerim, që i përmendëm pak më parë. Allahu (xh. sh.) nuk tha: **Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që shpirtin e robit të Vet e kaloi në një pjesë të natës**”, porse tha: **“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet”**. Nocioni “robin e vet” nënkupton njeriun që është me trup dhe me shpirt. Argument tjetër i pakontestuar është edhe vetë fjala “Subhane”, me të cilën fillon ajeti dhe vetë surja e Israsë. Kjo fjalë vjen për gjëra të mëdha, kur vjen në fillim të një ajeti apo të një sureje i bënë vërejtje lexuesit apo dëgjuesit se në vazhdim do të lexojë ose dëgjojë diçka të çuditshme dhe të madhe në të njëjtën kohë nëse ai e mat me standardet njerëzore, por është e lehtë dhe normale për Allahun e Gjithësisë, Krijuesin dhe Sistemuesin e Gjithësisë, Krijuesin e ligjeve të saj. Ai është i Plotfuqishëm dhe mund të thyejë çdo ligj në çdo kohë dhe të mbajë atë që do Madhëria e Tij.

Duke studiuar atmosferën e përgjithshme të situatës së myslimanëve dhe thirrjes islame në përgjithësi në atë kohë, ne e dimë se kjo mrekulli ka ndodhur për një qëllim të rëndësishëm përveç qëllimeve tjera, e që është shqyrtimi i zemrave dhe bindjeve të myslimanëve ndaj Pejgamberit (a. s.), për të vërtetuar fuqinë e besimit (imani) dhe për të dalë në shesh të dobëtit e besimit, të zbulohet çështja e tyre, veçanërisht kur Allahu (xh. sh.) po përgatiste myslimanët për një ngjarje të madhe, që është emigrimi prej Mekës për në Medinë, për të formuar dhe themeluar shoqërinë më të madhe islame që e ka njohur njerëzimi në botë.

Materialistët si në të kaluarën ashtu edhe sot në botën moderne, çdo gjë matin me gjatësi, me gjerësi dhe thellësi me atë që kanë para duarve të tyre nga masat dhe peshoret e njohura, dhe kontestojnë e mohojnë çdo gjë tjetër që nuk pajtohet me peshoret e tyre. Kështu, si rezultat i kësaj materialistët kontestuan krejtësisht mrekullinë e Israsë dhe Miraxhit, në tërësi dhe në detaje, sepse kjo ngjarje nuk u nënshtrohet ligjeve dhe ekuilibrave të tyre.

Kjo është njëra anë, kurse ana tjetër, ata të cilët e ekzagjeruan aspektin shpirtëror dhe u bënë monastik. Ata ranë në kundërshtime mes vete, se mrekullia e Israsë dhe Miraxhit a ndodhi vetëm me shpirt, apo vetëm me trup, apo me të dyja

bashkë?! Kemi përsëritur shumë herë duke u thënë atyre dhe të tjerëve dhe kemi vërtetuar me argumente se mrekullia e Israsë dhe Miraxhit të Pejgamberit (a. s.) ka ndodhur me shpirt e me trup. Vlerësojmë kështu ngase sikur Israja dhe Miraxhi të kishin ndodhur vetëm me shpirt, nuk e meritonte të ishte mrekulli. Ëndrrat e mira u ndodhin edhe njerëzve të mirë që nuk janë as pejgamberë e as të dërguar. Edhe njeriu i rëndomtë sheh ëndërr gjithçka që nuk mund t’i realizojë kur të jetë zgjuar. Ai në ëndërr mund të fluturojë dhe të shëtitet në zona të gjera e largëta, dhe këto i ngelin vetëm shpresa që mund t’i realizojë vetëm në ëndërr.

MIRAXHI, UDHËTIM QIELLOR NË BOTËN E MBRETËRISË

Universi të cilin njeriu mund të shohë, disa nga skajet e tij, është univers i gjerë dhe i madh. Megjithatë, me tërë atë që përmban ky univers, përfaqëson vetëm qiellin e parë, e ne nuk dimë asgjë dhe askush nuk di asgjë për qiellin e dytë, të tretë, të katërt e kështu me radhë, përveç asaj që Pejgamberi (a. s.) ka mësuar nga Shpallja.

Kjo është njëra anë, kurse ana tjetër është se ideja se Zoti që zë vend të caktuar në univers, është ide e cila nuk përputhet as me arsyen e as me logjikën e shëndoshë. Përkundrazi, ndoshta ne banorët e tokës, konsiderojmë se ka njerëz dhe krijesa të tjera në planetët tjerë përveç nesh që ne nuk i dimë. Në galaktikën tonë apo galaktikën tjera ka një univers të gjerë... Atëherë Krijuesi Absolut, që është Një, Pronar dhe Sistemues i çdo gjëje, Ai ka fuqi absolute dhe askush nuk mund t’i përcaktojë Atij elementin vend dhe kohë. Ai është i pastër nga të metat, Ai ka ekzistuar para se të ekzistojë koha dhe vendi.

Në të kaluarën, njerëzit mendonin se atë që e shohin mbi kokat e tyre janë qiejt ku banojnë engjëjt, mirëpo shkenca bashkëkohore ka arritur në përfundim se kjo që e shohim nuk është gjë tjetër, veçse një fenomen ndriçues që ndodh në atmosferën e tokës si rezultat i shpërndarjes së dritës blu të diellit. Shkenca bashkëkohore ka arritur deri në përfundim se Toka është vetëm një planet i vendosur në një grup që i përkasin Diellit, kurse trashësia e mbulesës gravitacionit të saj nuk kalon sipërfaqen e një mijë kilometrave, përfshi në ne edhe “kuben blu” ku njerëzit në të kaluarën mendonin se ishte vendbanimi i engjëjve, por ajo në realitet është një element fotolumishence që ndodh në shtresën e atmosferës së tokës e që nuk është më larg se dyqind



(200) kilometra.

Çështja e tretë është se, materia shndërrohet në energji, pastaj energjia rikthehet në materie. Kjo është një çështje tanimë e ditur me zbulimet e reja shkencore, megjithatë nëse kjo çështje është teorike, praktikisht është e pamundur të zbatohet. Pra, nëse themi se trupi i të dërguarit të Allahut (s.a.v.s.), që është substancë (trup) është shndërruar në energji, apo në diçka më të lartë se energjia-drita, në mënyrë që të depërtojë në horizontet e gjithësisë dhe më tej për pak orë sipas llogarisë tonë njerëzore, atëherë ne me këtë kemi bërë një sugjerim për të përfaruar konceptin e ngjarjes, megjithatë ne nuk jemi të prerë në atë që sugjerojmë. Ajo që tregon kohëzgjatjen e shkurtër të udhëtimit në të dy udhëtimet, Isra dhe Miraxhi, është ajo që ka transmetuar i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) pas kthimit të tij tek Umi Hani, kushërira e tij. Pastaj ajo që ka transmetuar Pejgamberi (a. s.) për tërë njerëzit pas saj. Nga ky transmetim kuptohet se Pejgamberi (a. s.) e kishte falur namazin e mbrëmjes me shokët e tij, pastaj është kthyer nga udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit dhe e ka falur namazin e mëngjesit bashkë me ta!!

Kjo është një hyrje për të hyrë në

temën e Miraxhit, ngjitjes në qiell, nga sipërfaqja e tokës në shtresat e larta të atmosferës, deri në pikën e depërtimit në një vend që njeriu nuk e njeh ende. Për këtë çështje mendoj se është më mirë të lexojmë ajetet e Miraxhit që janë të regjistruara në Kuranin fisnik, në suren en-Nexhm, te të cilat jo në mënyrë eksplicite, por indirekte, kuptohet nga to çështja e Miraxhit.

“Pasha yllin kur bie! Shoku juaj nuk ka humbur, e as që ka devijuar. Dhe ai nuk flet nga dëshira. Ajo nuk është tjetër pos shpalljes që i shpallet. Atë ia mësoi fuqiforti (Xhibrili). Që ka mendje precize dhe që u përqendrua në formën e vet. Dhe ai (Xhibrili) ishte në horizontin e lartë. Pastaj u lëshua dhe iu afrua. E ishte afër sa dy harqe, apo edhe më afër. Dhe i shpalli robit të Tij (Allahut) atë që ia shpalli. Zemra nuk mohoi atë që pa. A po i bëni polemikë atij për atë që ka parë? Ai e ka parë (Xhibrilin) edhe herën tjetër. Te Sidretul Munteha. Pranë së cilës është xhennetull Me’va. Atëherë kur Sidrën e mbuloi ajo që e mbuloi. Shikimi i tij nuk lakoi e as nuk tejkaloi. Ai vërtet pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet”. (Surja En-Nxhm: 1-18)

BETIMI NË NJË TRUP QIELLOR

Kështu ka filluar surja “en-Nexhm” duke folur për Miraxhin e Pejgamberit (a. s.), për mrekullinë e madhe që i ndodhi Pejgamberit (a. s.) për nderin e tij. Gjatë kësaj mrekullie Pejgamberi (a. s.) kishte parë çudira të mëdha të krijesave të Allahut (xh. sh.) që janë në mbretërinë e Tij, dhe që nuk mund t’i përkufizojë askush. Urtësia e Allahut (xh. sh.) ka gjykuar që fjalët e para të kësaj surje të fillojnë me betimin në një trup qiellor, në yllin, që është një nga argumentet kozmike për ekzistimin e Tij e që e ka krijuar Allahu (xh. sh.). Allahu i Madhërishtëm është betuar në yllin që bie, që shpërthen ose që digjet. Ky është betim në diçka të madhe nëse njerëzit mendojnë. Pastaj vjen ajeti tjetër për të vërtetuar dhe për banorët e Mekës në kohën kur atyre u shpallej Kurani se i dërguari i Tij, që është në mesin tuaj, nuk është i lajthitur e as nuk e ka humbur rrugën, sepse ai është i zgjedhuri nga Allahu (xh. sh.). Ai patjetër duhet ta flasë dhe ta thotë të vërtetën dhe të informojë se çka ka parë dhe çka ka dëgjuar dhe të përcjellë atë që e ka urdhëruar Allahu (xh. sh.) që ta përcjellë te të tjerët.

Si mund të jetë i lajthitur, i humbur dhe të rrëshqet, kur ai është besniku dhe kujdestari i Kuranit, librit të Allahut për gjithë njerëzinë. Kurani është shpallje që Allahu (xh. sh.) ia shpalosi të Dërguarit të Tij përmes Xhibrilit, i cili i vinte dhe ia lexonte Muhamedit (a. s.). Xhibrili i është shfaqur Muhamedit (a. s.) në imazhin e tij të vërtetë.

Pra, në këto ajete betohet Allahu (xh. sh.) se ajo që i ka ndodhur të Dërguarit të Tij, kur ai të rrëfejë për të pasi të kthehet nga ky udhëtim, është e vërtetë e nuk është gënjeshtër, sepse kurrë nuk ka gënjeshtër gjatë jetës së tij. Pejgamberi (a. s.) gjatë këtij udhëtimi kishte parë shenja të mëdha që dëshmojnë për fuqinë dhe madhërinë e Allahut (xh. sh.).

Megjithëse ngjarja e Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur në të njëjtën natë (*natën njëzet e shtatë të muajit Rexheb, një vit para emigrimit*), tregimi i tyre në Kuran nuk paraqet sinonime, por shfaqet në vende të ndryshme. Israja përshkruhet në suren el-Isra, kurse ngjarja e Miraxhit përshkruhet në suren en-Nexhm. Ndoshta urtësia e kësaj është se Israja është udhëtim tokësor që i ka paraprirë udhëtimin qiellor, që është Miraxhi, prandaj edhe radhitja në Kuran ka ardhur sipas këtij kriteri. Atëbotë u larguan nga Islami ata

që kishin besim të dobët, dhe qëndruan në Islam ata që kishin iman stabil dhe të fortë. Ata që e mohojnë ngjarjen e Israsë dhe të Miraxhit në të kaluarën dhe në të tanishmen, ata nuk janë të kthjellët në mendjet e tyre, sepse po të kishin lexuar nga historia, ata do të kishin qenë të informuar se ngjarje të tilla madhore kanë ndodhur edhe në të kaluarën para Israsë dhe Miraxhit. Para saj kishte ndodhur ngjarja e transferimit të fronit të Belkisit nga Jemeni në Sham në një periudhë kohore sa mbyll e hap syrin. Si mund ta mohojnë ngjarjen e Israsë dhe të Miraxhit ata që kanë lexuar historinë dhe kanë lexuar ngritjen e Idrisit (a. s.) në qiell, ngritjen e Iljasit (a. s.) në qiell, ngritjen e Isës (a. s.) në qiell. Të gjitha këto ngjarje kanë ndodhur para se të ngrihet i dërguari i Allahut (s.a.v.s.), Muhamedi, i biri i Abdullahut, në qiejt më të lartë, porse ai u kthye pas ngritjes dhe nuk qëndroi atje si ndodhi me pejgamberët dhe të dërguarit tjerë para tij. Ky u kthye për të përfunduar dhe kompletuar mesazhin hyjnor, për të përhapur udhëzimin, të vërtetën dhe drejtësinë në tërë globin.

Kjo është, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, ata që e mohojnë Isranë dhe Miraxhin, sikur ta lexojnë historinë, do ta dinin se pejgamberët dhe të dërguarit e

Allahut (xh. sh.) janë pajisur me mrekulli mbinatyrore, përmes të cilave janë thyer normat kozmike dhe ligjet e fizikës për të qenë dëshmi e së vërtetës së thirrjes së tyre që u bënë njerëzve. Shembujt në këtë drejtim janë të shumtë, e në mesin e tyre hedhja e Ibrahimit (a. s.) në zjarr, me ç'rast Allahu (xh. sh.) e ndaloj funksionin e tij të djegies dhe e bëri të ftohtë dhe shpëtimtar për të. Hapja e detit për Musanë (a. s.) derisa u shfaq toka dhe kaloi Musa (a. s.) dhe populli i tij, për të ikur dhe për të shpëtuar nga tirania e Faraonit të Egjiptit, pastaj shndërrimi i shkoptit të Musait (a. s.) në gjarpër të madh, i cili i gëlltiti litarët e magjistarëve dhe kështu i mposhti ata dhe ata u kthyen në vete, pranuan besimin dhe ndoqën Musanë (a. s.). Po ashtu edhe shfrytëzimi i dukurive natyrore të Sulejmanit (a. s.), duke i komanduar xhindet, kafshët dhe shpendët, ringjallja e të vdekurve nga Isa (a. s.), si dhe formimi i zogjve nga balta. Të gjitha këto mrekulli janë të jashtëzakonshme, me të cilat Allahu (xh. sh.) i mobilizoi të dërguarit e Tij, që njerëzit t'u besojnë atyre dhe të ndjekin udhëzimet me të cilat erdhën.

(Përktheu nga arabishtja: Jusuf Zimeri, Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor të Rijasetit të BFI-së, Shkup)

BEJTULLAH ISMAIL GASHI DOKTORON NË AMAN

Më 25 janar, 2022, ka doktoruar në Aman (Jordani) Bejtullah Ismail Gashi (1972) nga Prishtina, Republika e Kosovës.

Komisioni ka qenë në përbërje: prof. dr. Muhamed Halef Muhamed beni Selame (kryetar), prof. dr. Musa Mustafa Musa Elkudah (mentor), dr. Enes Abdulvahid Salih Elxhahir (anëtar), prof. dr. Ahmed Shahde Ali Ebu Serhanë (anëtar i jashtëm).

Studimet e doktoratës (PhD) i ka finalizuar në Universitetin Botëror të Shkencave Islame (The World Islamic Sciences & Education University), Fakulteti i Jurisprudencës Islame, drejtimi Fikh dhe Usulë. Ka mbrojtur disertacionin me titull: "Ligji i familjes dhe zakonet që lidhen me të në shtetin e Kosovës në balancin e jurisprudencës islame; studim analitik praktik" (Family Law and customs related to it in the State of Kosovo



in the balance of islamic jurisprudence an Empirical study). Me këtë, ka fituar titullin Doktor i shkencave islame.

Bejtullah Ismail Gashi ka shërbyer si Imam në Prishtinë, në Shkodër, në disa

qytete të Gjermanisë etj. – ka njoftuar prof. Nexhati Spahiu. Një njoftim për "Hënën e Re" ka bërë më 1 shkurt, 2022, edhe vetë Bejtullah Ismail Gashi nga Amani.

E VËRTETA MBI DITËN E KIAMETIT

Meqenëse Zoti i Madhërishtëm do të vendos se kur do të ndodhë Kiameti, nuk është e mundur në asnjë mënyrë që ne njerëzit, veçanërisht ne myslimanët, të caktojmë një kohë dhe një shenjë për ndodhjen e tij. Këtë temë "Hëna e Re" e sjell në disa vazhdimë.

Nga Prof. dr. Bajraktar Bajrakli

Në krye të besëtytnive dhe mendimeve të gabuara që hasen në librat dhe videokasetat që qarkullojnë në mesin e myslimanëve janë: kur do të ndodhë Kiameti dhe (cilat janë) paralajmërimet apo shenjat e tij që do të shfaqen më parë. Ne do të hulumtojmë se nga erdhi kjo çështje në mesin e myslimanëve, cila është e vërteta e saj dhe do të ndjekim rrugën e dhënies së njohurive të sakta për besimtarët myslimanë.

Meqenëse Zoti i Madhërishtëm do të vendos se kur do të ndodhë Kiameti, nuk është e mundur në asnjë mënyrë që ne njerëzit, veçanërisht ne myslimanët, të caktojmë një kohë dhe një shenjë për ndodhjen e tij. Në veçanti, zakoni i shprehjes së mendimeve të gabuara për Kiametin dhe besëtytnitë e tij ka ardhur që nga shoqëritë paraislame dhe si kërpuha ka hyrë në kulturën tonë islame. Çështjen e shenjave të Kiametit në kapitullin e 24 në Ungjillin e Mateut e gjejmë si më poshtë.

"Ndërsa Jezusi ishte ulur në ullishte, erdhën edhe dishepujt e tij dhe i thanë: 'Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra dhe cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të botës?' Jezusi u përgjigj dhe u tha atyre: 'Askush të mos ju mashtrtojë. Sepse, shumë njerëz do të paraqiten duke thënë: Unë jam Mesia; do të vijin dhe në emrin tim do të befasojnë shumë njerëz.'

Do të dëgjoni beteja dhe fjalë beteje. Mos u merrni; sepse ato duhet të ndodhin, por akoma nuk është fundi. Sepse, do të ngrihet një komb kundër një kombi, një vend (shtet) kundër një vendi, vende-vende do të ketë zi buke dhe tërmete. Dhe, të gjitha këto janë fillimi i dhimbjeve. Atëherë do t'ju shqetësojnë dhe do t'ju vrasin, dhe për shkak të emrit tim, të gjithë popujt do t'ju urrejnë. Dhe, atëherë shumë njerëz do të mashtrohen dhe do të tradhetojnë e do ta urrejnë njëri-tjetrin. Dhe, do të dalin shumë profetë të rremë dhe do të ma-



shtrojnë shumë; dhe do të ftohet dashuria e shumë njerëzve, sepse paudhësia do të rritet. Por, ai që do të durojë deri në fund, ai do të shpëtojë. Dhe, ky Ungjill i botës shpirtërore do të predikohet në mbarë botën si dëshmi për të gjithë popujt; dhe pikërisht fundi atëherë do të vijë."

Nëse e shikojmë këtë tekst të Ungjillit të Mateut, shenjat e Kiametit mund të rradhitet si më poshtë: Do të ketë nga ata që pretendojnë se janë Mesia. Do të dalin pejgamberë të rremë. Do të shpërthejnë luftëra të mëdha. Do të ketë krizë buke (uri) dhe tërmete. Të krishterët do të urrehen për shkak të emrit të Isait (a. s.). Dashuria do të ftohet dhe urrejtja do të rritet. Bibla do të përhapet në mbarë botën. Fitneja dhe fesadi (intrigat e çrregullimet) do të shtohen.

Tani, të ngjashme me këto shenja të përmendura në Bibël, me një ndryshim të vogël, gjenden në shprehjen e mëposhtme, e cila njihet si hadith. Sipas transmetimit të Ebu Hurejres, Pejgamberi (a. s.) kështu ka thënë: "Kiameti nuk do të vijë derisa dy komunitete/shoqëri të mëdha, kauzat e të cilave janë të njëjta, të mos luftojnë njëra-tjetrën. Kiameti nuk do të vijë derisa të shfaqen rreth tridhjetë dexhallë/antikrisht të rremë. Të gjithë ata do të pretendojnë se janë të dërguar të Allahut. Përsëri, Kiameti

nuk do të vijë derisa të zhduket dituria, të mos shtohen tërmetet, të afrohet koha, të mos ndodhin fitne/rebelime dhe të shtohen rastet e vrasjeve (herxh). Gjithashtu, Kiameti nuk do të vijë derisa pasuria të rritet dhe të rrjedhë si një vërshim mes jush. Në fakt, pasuria do të rritet deri në atë masë, sa pronari do të brengoset se kush do ta pranojë zeqatin e pasurisë së tij. Madje, disa pronarë do të duan të japin zeqatin, por personi të cilit i jepet zeqati do të thotë: "Unë nuk kam nevojë për zeqat." Kiameti nuk do të vijë nëse këto gjëra nuk ndodhin. Kiameti nuk do të vijë derisa njerëzit të hyjnë në një garë për të ndërtaur ndërtesa të larta dhe një person të kalojë pranë varrit të një personi të vdekur dhe të dëshirojë të vdesë, duke thënë: "Do të doja të isha unë në vend të tij." Kur të lindë dielli nga perëndimi dhe njerëzit ta shohin këtë ngjarje, ata do të besojnë të gjithë, por është një kohë kur besimi i atyre që nuk kanë besuar më parë ose nuk kanë fituar mirësi dhe virtyte në besimin e tyre, nuk do t'u bëjë dobi. Kiameti pa dyshim që do të ndodhë..." (Buhari Muhtasar, Fitneler, 2083)

(Marrë nga libri "Kuransız Müslimanlık", shtëpia botuese "Düşün Yayıncılık", Stamboll, 2019, botimi i 6-të. Përktheu nga turqishtja: dr. Selver Xhemaili)

IMAMI DHE ROLI I TIJ NË SHOQËRINË OSMANE

Imamllëku në periudhën osmane ishte një nga funksionet që kërkonte përgjegjësi të madhe; ai nuk ishte i kufizuar mes mihrabit dhe minberit, siç vërehet kjo sot në ditët tona. Prandaj, nga ata që ngjiteshin në këtë post kërkohet që të kishin një nivel më të lartë të dijeve dhe të kulturës, ngase ata emëroheshin si Imamë me berat sulltanor.

Shkruan: Dr. Mevlud Aliu

Islami i ka kushtuar kujdes të veçantë funksionimit të Imamit dhe atë e ka vënë në pozitën e përgjegjësive të mëdha, duke ia lënë amanet dhe duke e obliguar me këtë mision mjaft të rëndësishëm shoqëror çdonjërin që vihet në shërbim të tij. Kryerja e kësaj detyre madhështore është rruga e trashëguar e pejgamberëve dhe e atyre që e pasuan rrugën e tyre të drejtë: “Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek Allahu; unë dhe ai që vjen pas meje.”ⁱ

Pra, të qenët Imam (prijës në namaz) është një nga funksionet e para fetare që ka njohur Shteti Islam. Më i çmueshmi dhe më i dobishmi për shoqërinë islame, Pejgamberi - pagja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të - e praktikoi vetë dhe për këtë detyrë zgjodhi pas tij shokët më të mirë Ebu Bekrin dhe Omerin, duke thënë: “Faluni (lidhuni) pas atyre që do të më pasojnë mua, pas Ebu Bekrit dhe Omerit.”ⁱⁱ

Nuk ka dyshim se kjo përgjegjësi bie mbi supet e çdonjërit që del Imam në xhami për t’u prirë besimtarëve në namaz, andaj ai duhet ta kryejë këtë detyrë në mënyrën më të përsosur, ashtu siç kërkon Islami, sepse atij i është besuar ky amanet i madh dhe për këtë punë madhështore ai duhet të ketë parasysh obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga kjo detyrë.

DEFINICIONI I IMAMIT

Në aspektin gjuhësor *Imam* është njeriu që përcillet, që ndiqet (të cilit i shkohet pas),ⁱⁱⁱ ose ai që ndiqet prej njerëzve - goftë President apo ndonjë tjetër; në këtë kuptim është edhe Imam i qm iu prin



njerëzve në namaz.^{iv} Kjo fjalë përmendet në Kuran, ku Allahu (xh. sh.) thotë: “Përkujto (o i dërguar) kur Zoti i vet Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai i tha: “Unë po të bëj ty prijës (Imam) të njerëzimit!” Ai tha: “(bën, o Zot) Edhe nga pasardhësit e mi!” (Zoti) Tha: “Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët.”^v

Në kuptimin terminologjik **imamllëk** është: “Lidhshmëria e namazit të xhematliut me namazin e Imamit, sipas kushteve të sqaruara nga sheriati, andaj Imam mund të bëhet Imam vetëm nëse ndjekësi e ka lidhur namazin e vet me namazin e Imamit; kjo lidhje është edhe esenca e imamallëkut, si dhe qëllimi i ndjekjes së tij nga ana e namazlinjve.”^{vi}

RËNDËSIA E IMAMIT NË ISLAM

Sa i përket rolit të Imamit në shoqëri, nuk ka dyshim se ai është një rol i rëndësishëm,

pasi që ai udhëheq me besimtarët në namaz, obligim ky që është shtylla themelore e Islamit pas shehadetit. Imam, pra, është prijës dhe xhematlinjtë janë pasuesit e tij.

Imami e drejton dhe e këshillon xhematin e tij me mësimet dhe këshillat që jep i dërguari i Zotit (a. s.) dhe *hulefai rashidinët*. Xhamia shërbente dhe vazhdon të shërbejë si vendtubim, kongres, ku mblihdhen myslimanët për t’u konsultuar për çështjet e fesë së tyre dhe për jetën e kësaj bote, dhe kështu ua mësonin njerëzve besimin (monoteizmin), fikhun dhe virtytet morale, si dhe urdhëronin për të mirë dhe ndalonin nga e keqja.

Imamllëku është njëri nga funksionet e Davetit (thirrjes) në rrugë të Zotit. Libri i parë i thirrjes islame është Kurani, kështu që Imam është ai i cili e bën xhematin që ta dëgjojnë atë gjatë leximit të tij namaz.

Imami i xhamisë është thirrës në rrugë të Zotit me dijen e tij, ai është shëmbëlltë për xhematin, me urtësinë dhe dijen e tij. Xhemati udhëhiqet dhe udhëzohet me dijen e tij, sepse ai është më i thirrur dhe më mirë se ata lexon Kuranin dhe më mirë se ata e kupton sunnetin e Pejgamberit (a. s.).

ROLI DHE INGJERENCAT E IMAMIT NË PERIUdhËN OSMANE

Imamllëku në periudhën osmane ishte një nga funksionet që kërkonte përgjegjësi të madhe; ai nuk ishte i kufizuar mes mihrabit dhe minberit, siç vërehet kjo sot në ditët tona. Prandaj, nga ata që ngjiteshin në këtë post kërkohet që të kishin një nivel më të lartë të dijeve dhe të kulturës, ngase ata emëroheshin si Imamë me “berat”^{vii} sulltanor (berat: dokument apo autorizim sulltanor për emërimin e zyrtarëve në poste të rëndësishme që jepet me firmën e vetë Sulltanit).

Madje, vetë Sulltani kishte dy Imamë, të cilët e falnin namazin me ndërrime - goftë brenda pallatit apo në xhamitë sulltanore, ku sulltani e zgjidhte Imamit për të falë namazin e xhumasë.^{viii}

Imamët ishin përgjegjës për të gjitha çështjet fetare dhe shoqërore në lagjen e tyre deri në vitin 1245, kur u krijua sistemi i parë i muhtarit. Ata organizonin punët e lagjes dhe siguronin bashkëpunimin dhe koordinimin mes njerëzve të lagjes, duke qenë se Imamët gëzonin cilësinë e përfaqësuesit të Kadiut (gjykatësit) në lagjet e tyre.^{ix}

Një nga detyrat më të mëdha fetare që kryente Imamit ishte mësimi dhe predikimi, punë kjo me të cilën i ngarkoi Islami njerëzit e dijeve. Ata duhet t’u mësojnë njerëzve atë që u nevojitet atyre nga çështjet e fesë së tyre, në atë masë në të cilën i urdhëron Islami dhe për të cilën kanë nevojë njerëzit.

Në periudhën osmane Imamit e kryente mirë këtë detyrë, goftë brenda apo jashtë xhamisë, sepse Imamit njoheshin shumicën e banorëve të lagjes që faleshin pas tij. Ai pas përfundimit të namazit ulej në xhaminë e tij, për t’i pritur të interesuarit që të pyesin për çështjet fetare. Përveç kësaj, Imamit shkonte në kafene, në parqe dhe bujtina të qytetit për të kontrolluar gjendjen e njerëzve, dhe zhvillonte ligjëratat fetare dhe u jepte atyre udhëzime.^x

Një nga detyrat më të mëdha të Imamit gjatë periudhës osmane ishte luftimi i dukurive negative, si: inspektimi i atyre që nuk falin namaz, duke i këshilluar, dhe duke ua tërhequr vërejtjen në mënyrën më të mirë të mundshme; e nëse ata nuk

udhëzoheshin, atëherë Imamit lëshonte urdhër për t’i larguar nga lagja e tyre.^{xi}

Imami, pra, ishte përgjegjës në lagjen e tij dhe monitoronte çdo incident në cilësinë e gjykatësit në lagjen e tij, siç theksuam më parë, dhe askush nuk ia kontestonte kompetencat.

Në periudhën osmane çdo lagje kishte një organ sigurie për të luftuar dukuritë negative si: prostitucionin dhe pirjen e alkoolit. Ky organ ishte në kompetencat e Imamit të lagjes; vetë ai kujdesej për sigurimin e të gjitha provave të nevojshme; e nëse vërtetohej se ka vende ku mblihdhen njerëzit për të pirë alkool dhe për prostitucion, atëherë ai lëshonte urdhër për mbylljen e tyre, si dhe burgosjen e grave që merreshin me këtë punë të ligë.^{xii}

Ndër detyrat e Imamit gjatë periudhës osmane ishte edhe ruajtja e sigurisë në lagjen e tij dhe monitorimi i saj.

Për arrijtjen e këtij qëllimi fisnik, të huajt që vinin në lagje detyroheshin të kërkoheshin leje për hyrje në të. Një i huaj nuk mund të hynte në lagje derisa të merete leje qëndrimi nga Imamit të lagjes.

Për të qenë siguria e të panjohurit më e madhe, i huaji nuk kishte të drejtë të kërkonte strehim në lagje, vetëm pasi të kishte siguruar një garantues vendas gjatë qëndrimit të tij në atë lagje, dhe nëse ndodhte që një i huaj të hynte fshehurazi në atë lagje, Imamit menjëherë lëshonte urdhër për gjetjen e tij.^{xiii}

Ndër kompetencat e Imamit në periudhën osmane ishte edhe e drejta e tij për të dhënë certifikata transferimi për pa-tundshmëritë dhe pronat e tjera.

Imami po ashtu e kishte për detyrë që “të bënte regjistrimin e pasurive të pa-tundshme në përputhje me ligjin në regjistrin përkatës, duke shënuar të dhënat dhe të drejtat pronësore të palëve”.^{xiv}

KOMPETENCA TË GJERA PËR IMAMIN

Nëse paraqitet nevoja për të mbledhur donacione nga xhemati për ndihma humanitare, ose punë të tjera bamirësie, si: restaurimi i xhamisë ose restaurimi i pjesës së xhamisë, Imamit në këtë rast ligjëronte në lidhje me temën apo projektin; e nëse këto donacione ishin për qëllime ushtarake, atëherë Imamit e nxiste xhematin që ata të bëjnë xhihad me pasurinë e tyre.^{xv}

Vlen të theksohet me këtë rast se Imamit e lagjeve dhe fshatrave ishin të liruar nga shërbimi ushtarak,^{xvi} për shkak të kryerjes së detyrës së tyre të Imamit. Ata ishin të përkushtuar në këtë detyrë me tërë qenien e tyre, kështu që Imamit në

paqe ishte predikues, mirëpo në kohë vështirësish dhe lufte, roli i Imamit zgjerohet përmes ligjëratave të tij duke inkurajuar njerëzit për luftë dhe xhihad me para (pasuri) dhe jetë.

Dhe, jo vetëm kaq. Kompetencat e Imamit, madje, shtriheshin edhe në të gjitha aspektet sociale dhe ekonomike: Imamët ishin ndër nënshkruesit dhe mbajtësit e vulave të hetimeve dhe dokumenteve të përgatitura zyrtare po ashtu.

Procedurat e vdekjes dhe të varrimit, regjistrimi i lindjes, kontrata e martesës dhe divorci, kryheshin nga Imamët; disa nga detyrat e bashkisë, kujdesi për pastërtinë e lagjes dhe sigurimi i ambientit të pastër ishin ndër detyrat e tij.

Bashkë me kryeplakun dhe fisnikët e lagjes iu kaluan edhe punët si: kontrolli i bukës në furra buke, parandalimi i aktiviteteve përfituese e mashtruese, si dhe grumbullimi i dhurimeve dhe lëkurëve të kurbanit” etj.^{xvii}

Ky ishte roli i Imamit derisa u aplikua sistemi i Zyrrave të vendit, i njohur si sistemi i Muhtarit (kryeplakut) në Devletin Osman në vitin (1245 hixhri / 1829), kur filloi ndikimi i Imamit të zvogëlohej, pasi Imamit iu hoq roli i mëparshëm dhe roli i tij mbeti vetëm në jetën fetare, për t’i prijë xhematit në faljen e namazit në xhami, në ligjëratat dhe edukim fetar, derisa në periudhën pas shpalljes së Turqisë republikë më 1923, Imamit u kufizua brenda mureve të xhamisë, vetëm për faljen e namazit, pa pasur fare kompetenca.^{xviii}

(Autori është Profesor në Medresenë Isa Beu në Shkup)

ⁱ Jusuf, 108.

ⁱⁱ Tirmidhiu, 5/427.

ⁱⁱⁱ El Razi, Muhamed Bin Ebi Bekr Bin Abdel Kadir, Muhtar Essihah, Mektebetu Lunan, Bejrut, 1989, fq. 22.

^{iv} El Mu, xhemul Vesit, Mektebetush, shuruk Eddevlije, Kajro, 2004, bot. IV, fq. 28.

^v El Bekare, 124.

^{vi} Ibni Abidin, Muhamed Emin Bin Omer Bin Abdel Aziz, Hashijetu Ibni Abidin, Daru Ihjautturath El Arabi, Bejrut, bot. II, 1987, vëll I, fq. 370.

^{vii} Berat: dokument apo autorizim sulltanor për emërimin e zyrtarëve në poste të rëndësishme, që jepet me firmën e vetë Sulltanit.

^{viii} Esh,shennavi, vëll. I, fq. 435.

^{ix} Po aty.

^x Kazici, p. 273.

^{xi} Ibid, 274.

^{xii} Ibid, 273-274.

^{xiii} Islam Ansiklopedisi, cilt.22. p 181.

^{xiv} Ibid.

^{xv} Kazici, p. 275.

^{xvi} Islam ansiklopedisi, vëll. 22, fq. 183.

^{xvii} Po aty, fq. 181.

^{xviii} Kazici, p. 276.

TRASHËGIMIA E FEMRËS

Shkruan: Zenetije Mustafa

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit: Falënderimi ynë çdoherë goftë për Allahun e Madhërishtëm, i Cili thotë: "Vërtet, ti je në shkallën më të lartë të moralit", kurse lutjet tona qofshin për të Dërguarin e Tij, Muhamedin (a. s.), mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij të ndershëm dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij, duke kontribuar që feja islame të interpretohet drejt, në pajtim të plotë me parimet e Kuranit dhe të Sunnetit.

Ajo që më inspiroi të bëj këtë hulumtim empirik ishte çështja e trashëgimisë së femrës te ne shqiptarët - sa i jepet e drejta asaj dhe sa i mohet kjo e drejtë asaj dhe cilat janë arsyet apo justifikimet që përdor popullata jonë për ta përjashtuar femrën nga trashëgimia.

Fillimisht duhet të dimë se Islami asnjëherë nuk i bëri padrejtësi femrës, edhe pse njëra ndër akuzat më të mëdha që iu atribuan fesë islame është pikërisht çështja e pabarazisë së femrës me mashkullin në çështjen e trashëgimisë, duke thënë se femrës iu bë padrejtësi duke i dhënë mashkullit hise sa për dy femra.

Por, e vërteta qëndron se feja islame i ka dhënë të drejta secilit, si mashkullit ashtu edhe femrës e sidomos në çështjen e pasurisë dhe të trashëgimisë.

Këtë hulumtim empirik e kreu me ndihmën e disa anketave të cilat u bënë në qytetin e Kumanovës dhe rrethinën e tij, me qëllim që të dihet opinioni i popullatës sonë për trashëgiminë e vajzës. Për ta realizuar këtë hulumtim u përdor metoda empirike, nëpërmjet procesit të anketimit, ku u anketuan 29 gra nga qyteti i Kumanovës, duke përfshirë edhe rrethinën dhe kjo anketë u realizua online.

ÇFARË TRASHËGON FEMRA

Vajza në fenë islame trashëgon duke u mbështetur në argumentin kuranor: "Allahu ju urdhëron kështu në lidhje me trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa



pjesa e dy femrave; nëse trashëgimtarët janë dy e më tepër femra, atyre ju takojnë dy të tretat e pasurisë së trashëguar; nëse (trashëgimtarë) është (vetëm) një femër, asaj i takon gjysma e pasurisë"

Femrat për të cilat është rënë dakord se trashëgojnë janë shtatë: vajza; vajza e djalit; nëna; gjyshja; motra; bashkëshortja; dhuruesja e lirisë.

Rezultatet nga anketimi:

Kur bëhet fjalë për moshën e të anketuarve, rezultatet tregojnë se 69.0% e të anketuarve janë të moshës 18/25-vjeçare, 6.9% të moshës 26/35-vjeçare, 10.3% të moshës 36/45-vjeçare dhe 13.8% mbi moshën 46-vjeçare.

Sa i përket asaj se në çfarë vendi jetojnë të anketuarit, në vende urbane apo rurale, rezultatet tregojnë se 79.3% jetojnë në fshat, ndërsa 20.7% jetojnë në qytet.

Kur bëhet fjalë për arsimin e të anketuarve, 27.6% janë me arsim fillor, 31.0% janë me arsim të mesëm dhe 41.4% me arsim të lartë.

Sa i përket statusit martesor të të anketuarve, rezultatet tregojnë se 51.7% nga të anketuarit janë beqare, ndërsa

48.3% janë të martuara.

Kur bëhet fjalë për gjendjen ekonomike të të anketuarve, rezultoni se 96.6% kanë gjendje ekonomike mesatare dhe 3.4% kanë gjendje ekonomike të lartë.

Sa i përket asaj se sa nga të anketuarit kanë pronë trashëgimore, rezultatet tregojnë se 86.2% nuk kanë pronë në emrin e tyre, ndërsa 13.8% kanë pronë në emrin e tyre.

Kur bëhet fjalë se çfarë konsiderojnë si pronë të tyre të anketuarit, rezultatet tregojnë se 48.3% konsiderojnë si pronë të tyre shtëpinë, 10.3% tokën, 3.4% automjetet dhe 37.9% gjëra të tjera.

Sa i përket mënyrës se si e kanë fituar pronën të anketuarit, rezultoni se 8.3% e kanë blerë vetë, 45.8% si pronë të përbashkët martesore dhe 45.8% si pronë të trashëguar.

Kur bëhet fjalë se çfarë synojnë të anketuarit të posedojnë në të ardhmen, rezultatet tregojnë se 65.5% synojnë të kenë shtëpi, 13.8% automjete dhe 20.7% gjëra të tjera.

Sa i përket mënyrës se si synojnë ta përfitojnë të anketuarit pronën në të ardhmen, rezultoni se 58.6% duke e blerë vetë, 17.2% si pronë të përbashkët,

20.7% duke e trashëguar dhe 3.4% e ndonjë mënyrë tjetër.

Kur bëhet fjalë se a ka kaluar familja e lindjes së të anketuarve në proces të trashëgimisë, rezultatet tregojnë se 34.5% kanë kaluar në proces të trashëgimisë, 41.4% jo dhe 24.1% nuk e dinë.

Sa i përket se cila është arsyeja se nuk kanë marrë pjesë në ndarjen e trashëgimisë, rezultoni se 34.8% kanë hequr dorë duke e nënshkruar dokumentin në favor të vëllezërve, 34.8% nuk i kanë paraqitur si trashëgimtare dhe te 30.4% pasuria është ndarë me testament te djemtë e familjes.

Kur bëhet fjalë se a e kanë të anketuarat mbështetjen e bashkëshortit për ta kërkuar të drejtën e tyre në trashëgimi, rezultatet tregojnë se 17.2% e kanë mbështetjen, 24.1% nuk kanë mbështetje dhe 58.6% nuk e dinë.

Sa i përket asaj se a kanë njohuri të anketuarat rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi, rezultoni se 75.9% kanë njohuri, 17.2% nuk kanë njohuri dhe 6.9% nuk e dinë.

Kur bëhet fjalë për atë se a i bën feja islame padrejtësi femrës në trashëgimi, 20.7% nga të anketuarit mendojnë se PO, 75.9% JO dhe 3.4% nuk e dinë.

Sa i përket asaj se si e parasheh ligji shariatik të drejtën në trashëgimi mes djemve dhe vajzave, 65.5% thonë se për djemtë dy hise, ndërsa për vajzat një hise; 17.2% barabartë, si djemtë dhe vajzat; 10.3% vajzave, nuk ju takon asgjë dhe 6.9% nuk e dinë.

Kur bëhet fjalë se a është e drejta e grave në pronë e drejtë themelore, 69.0% mendojnë se PO, 13.8% JO, dhe 17.2% nuk e dinë.

Sa i përket asaj se çka është pronë e përbashkët martesore, 24.1% mendojnë se është pronë e trashëguar nga bashkëshorti, 62.1% pronë e blerë gjatë martesës së zyrtarizuar, 6.9% pronë e trashëguar nga familja e lindjes gjatë martesës dhe 6.9% nuk e dinë.

Kur bëhet fjalë se pse gratë heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi, rezultatet tregojnë se 34.5% nuk dëshirojnë t'i prishin marrëdhëniet me vëllezërit e tyre, 24.1% vëllezërit jetojnë me prindërit dhe kujdesen për ta, 3.4% është e pamundur të ndahet shtëpia ku jetojnë vëllezërit, 10.3% frikësohen se mund të jenë të gjykuara nga rrethi dhe 27.6% nuk e dinë se iu takon edhe atyre hise.

Sa i përket asaj se nga kanë dëgjuar të anketuarit për trashëgiminë e femrës, 41.4% thonë se nga mediat sociale dhe 58.6% nga institucionet fetare.

Sa i përket asaj se a ndikojnë institu-

cionet fetare (hoxhallarët) në ndarjen e trashëgimisë, rezultoni se sipas 10.3% të anketuarve PO, 13.8% JO, 27.6% nuk merret mendimi i tyre dhe sipas 48.3% thonë se nuk flasin aq sa duhet për trashëgiminë e femrës, por vetëm për obligimet e tyre.

DISKUTIMI

Kjo pjesë paqyron mendimet e 29 grave të anketuara në lidhje me të drejtën e trashëgimisë së femrës.

Nga hulumtimi u bë me dije se 69.0% nga të anketuarit janë në moshën 18/25-vjeçare.

Shumica prej tyre jetojnë në fshat 79.3% dhe shumica e të anketuarave janë me arsim të lartë, me 41.4% dhe te shumica gjendja ekonomike është e mesme, me 96.55%.

E gjetur tjetër nëpërmjet anketimit është se 86.2% nuk kanë pronë që posedojnë.

Nga ky hulumtim mund të konkludojmë se 34.8% femrave të anketuara kanë hequr dorë nga trashëgimia, duke nënshkruar dokumentin në favor të vëllezërve dhe 34.8% nuk i kanë paraqitur si trashëgimtare.

Hulumtimi zbulon se 75.9% të femrave kanë njohuri rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi.

Ajo që është me rëndësi të theksohet, është fakti se shumica e të anketuarave, me 75.9%, e kanë të qartë se feja islame nuk i bën padrejtësi femrës në ndarjen e trashëgimisë dhe se shumica prej tyre me 65.5% e dinë se si ndahet trashëgimia në Islam, pra për djemtë dy hise dhe për vajzat një hise.

Rezultatet tregojnë se 34.5% e femrave heqin dorë nga trashëgimia pasi nuk duan t'i prishin marrëdhëniet me vëllezërit e tyre, 24.1% mendojnë që ajo pasuri u takon vëllezërve pasi ata jetojnë me prindërit dhe kujdesen për ta, 10.3% frikësohen se mund të jenë të gjykuara nga rrethi dhe fatkeqësisht 27.6% nuk dinë se iu takon edhe atyre hise.

Po ashtu, është me interes të theksohet se 58.6% nga të anketuarit për trashëgiminë kanë dëgjuar nga institucionet fetare (hoxhallarët), por sa i përket ndikimit të tyre në ndarjen e trashëgimisë, shumica prej tyre me 48.3% thonë se nuk flasin aq sa duhet për të drejtat e femrave, por vetëm për obligimet e tyre dhe sipas 27/6% nuk merret mendimi i tyre.

PËRFUNDIMI

Falënderimi i takon Allahut të Plotfuqishëm, i Cili për çdo fillim krijoi edhe fundin.

Nga e gjithë kjo, erdha në përfundim që ne si studentë që kemi marrë rrugën e dijes, duhet t'u qasemi me seriozitet çështjeve të tilla, që në të ardhmen të largohen këto dyshime apo keqkuptime për tema të caktuara nga populli ynë.

Nga e gjithë kjo që kam cekur dhe hulumtimeve që kam bërë, vij në përfundim se shumica e femrave kanë hequr dorë nga ajo që i ka lejuar Allahu (xh. sh.) që të marrë pjesë në pasurinë e saj, pasi nuk duan të gjykojnë nga të tjerët, prandaj mjaft pamë se çfarë thonë të tjerët apo çfarë mendojnë të tjerët, por kërkonin të drejtat tuaja, pasi atë që ta ka caktuar apo lejuar Allahu, nuk del kush që ta mohojë.

Dhe, ne që jemi shpresa e vendit tonë, duhet të japim maksimumin për ta kthyer kuptimin dhe vlerën e të drejtave të femrës dhe të bëjmë të qartë se femra ka një vlerë të madhe në fenë islame, saqë derisa ajo është vajzë (e pamartuar) edhe nëse ajo posedon pasuri, e obligoi familjen e saj të kujdeset për të; ndërsa kur ajo është grua, e obligoi bashkëshortin e saj të kujdeset për të, ndërsa ajo sado që pasuri të ketë, është e lirë që ta shfrytëzojë atë siç dëshiron dhe askush nuk mund të harxhojë nga pasuria e saj pa lejen e saj.

Prandaj, ne me krenari mund të themi se femra është krijesa më e ngritur tek Allahu.

Pyetësori i shfrytëzuar: 1. Cila është mosha tuaj? 2. Vendi ku jetoni? 3. Niveli i arsimimit? 4. Gjendja martesore? 5. Gjendja ekonomike? 6. A keni pronë trashëgimore në emrin tuaj? 7. Çka konsideroni si pronë tuajën? 8. Si e keni fituar pronën? 9. Çfarë synoni të posedoni në të ardhmen? 10. Si synoni ta fitoni pronën në të ardhmen? 11. A ka kaluar familja e lindjes në proces të trashëgimisë? 12. Cila ka qenë arsyeja që nuk keni marrë pjesë në ndarjen e trashëgimisë? 13. A e keni mbështetjen e bashkëshortit për ta kërkuar të drejtën në trashëgimi? 14. A keni njohuri rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi? 15. A i bën feja islame padrejtësi femrës në ndarjen e trashëgimisë? 16. Si e parasheh ligji shariatik të drejtën në trashëgimi mes djemve dhe vajzave të familjes? 17. A është e drejta e grave në pronë e drejtë themelore? 18. Çka është prona e përbashkët martesore? 19. Pse gratë heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi? 20. Nga ku keni dëgjuar për trashëgiminë e femrës? 21. A ndikojnë institucionet fetare (hoxhallarët) në ndarjen e trashëgimisë? (Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup)

DUA-HATME NË STRIMNICË TË TETOVËS

Më 22 janar, 2022, në Xhaminë Qendrore të fshatit Strimnicë (Myftinia e Tetovës), është shënuar përfundimi i mësimbesimit nga më shumë nxënës e nxënës, njoftojnë nga BFI.

Me ftesë të Myftiut të Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, në manifestim mori pjesë edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, Myftiu i Shtipit mr. Nasir ef. Rexhepi, Drejtori i Sektorit të Kulturës në Rijaset z. Musanif ef. Rufati etj. Të pranishëm po ashtu kanë qenë edhe më shumë imamë dhe xhematlinj të fshatit e të rrethinave.

Programi është koordinuar nga h. Imer ef. Kamberi dhe Mualimi h. Zeke-rija ef. Kadriu. U përcoll një program i organizuar bukur si për nga forma, ashtu dhe për nga përmbajtja. Nxënësit treguan një nivel të shkëlqyer të realizimit të mësimbesimit në mejtepe (mektebe), me dije nga bazat elementare të Islamit, ilahije, kaside, poezi fetare dhe shumë përmbajtje të tjera.

Tubimin e përshëndeti nikoqiri i këtij



manifestimi, prof. dr. Qani ef. Nesimi, i cili para të pranishmëve tha se tubimet e këtilla janë bazë e një ardhmërie të shëndoshë islame.

Po ashtu, fjalën kryesore e mbajti Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili në paraqitjen e tij dha këshilla mbi rolin e edukimit të fëmijëve dhe gjeneratave të reja, për të trasuar rrugën e Islamit drejt ardhmërisë, për ta çuar amanetin e gjyshërve tanë në vend dhe për të krijuar kushte më të volitshme për edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj, të cilët duhet të ecin me kohën.

Duanë e bëri Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, ndërsa namazit të drekës i priu Myftiu i Shtipit, mr. Nasir ef. Rexhepi, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Një falënderim i veçantë për Imer ef. Kamberin, h. Zeke-rija ef. Kadriu, si dhe Muteveliu, Haxhi Seferin, me bashkëpunëtorë. Zoti i bekoftë – ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Duhet theksuar se fjala e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, gjatë ditës ishte transmetuar drejtpërdrejt në platformën elektronike të BFI të RMV.

SOLEMNITET FETAR NË XHAMINË TURI SINA



Më 23 janar, 2022, në Xhaminë Turi Sina të qytetit të Gostivarit u realizua një solemnitet fetar me rastin e përfundimit të hatmeve të Kuranit famëlartë nga nxënësset/nxënësit e mektebit (mejtepit) të Xhamisë. Mësimbesimi fetar është mbajtur nga Mualimi Nurkan ef. Aruç, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Në këtë manifestim përpos xhematit, familjarëve dhe mysafirëve të shumtë, pjesëmarrës ishte edhe Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i BFI të RMV, në shoqëri të Myftiut të Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, së bashku me Referentët e Myftinisë, si dhe përfaqësuesit nga Myftinia e Tetovës: mr. Xhemil ef. Sadiki dhe Imam Bajram ef. Ferati, hoxhallarë të Gostivarit etj.

Në fjalën e tij hyrëse, Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli potencoi faktin se mësimbesimi islam nëpër mektebet e

xhamisë është forma ku mësohen të drejtat dhe bazat e Islamit dhe të Kuranit famëlartë. Njëherësh, ai e çmoi lart punën e palodhshme dhe kualitative të Nurkan ef. Aruçit, që u pa edhe nga vetë nxënësset dhe nxënësit e mësimbesimit.

Më tej, fjalë rasti pati Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili theksoi se mektebet e xhamisë janë rruga më e mirë për zhvillimin dhe prezantimin e Islamit nga fëmijët, ku ata me mësimet e tyre paraqesin kulturën, dijen dhe njohuritë në familje, në shoqëri e më gjerë. Islami në kohën në të cilën jetojmë ka nevojë për aktualitetin e kohës, i mbron njerëzit nga veset negative, e këtë më së miri e demonstroi mualimi në xhami me nxënësit e vet, potencoi Reis'ul-Ulemaja.

Duanë e hatmeve e bëri prof. Sherif ef. Dehari, kurse programin e solemnitetit e udhëhoqi hfz. Jusuf ef. Xheladini. Ndër-

kaq, në namazin e drekës priu mr. Xhemil ef. Sadiki, Shef Kabineti i Myftiut të Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi. Në fund të programit u bë shpërndarja e diplomave dhe e mirënjohjeve nga ana e Myftiut dhe e Referentëve, me të cilat u dekoruan nxënësit, mualimi/imami i kësaj xhamie dhe Këshilli i Xhamisë. Po ashtu, mirënjohje iu ndanë edhe Këshillit paraprak të Xhamisë, atyre që në koordinim me Myftininë i vunë themelet e kësaj xhamie. Vlen të theksojmë se numri i nxënësve që bënë hatme në këtë solemnitet ishte 15, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Në deklarin publik në Facebook, të njëjtën ditë, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, e kishte vlerësuar lart punën e të gjitha strukturave të Xhamisë Turi Sina në Gostivar, të nxënësve të kësaj gjenerate dhe të nxënësve të tjerë.

HATME NË XHAMINË E FSHATIT MORANË

Në xhaminë e fshatit Moranë mësimbesimin islam, te mualimi Adnan Kadriu, e kanë kryer 11 nxënës. Ceremonia e dytë së hatmes u realizua më 28 janar, 2022, para namazit të xhymasë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Këtë solemnitet e nderuan: Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili, Referenti i xhematit të rajonit të Karshiakës hfz. Irfan ef. Sulejmani; Referenti i vakëfit h. Fejsall ef. Kadriu; hoxhallarë, hafëzllarë të kësaj ane, familjarë të nxënësve dhe xhematlinj të Xhamisë.

Adnan efendi, në emër të Këshillit dhe të xhematit, falënderoi Myftiun dhe stafin e Myftinisë që e nderuan këtë manifestim dhe më pas udhëhoqi nxënësit në shpalesjen e njohurive nga mësimbesimi dhe pjesë nga Kurani famëlartë. Duanë e rastit e bëri h. Fejsall ef. Kadriu.

Të gjithë nxënësit Myftiu i pajisi me diploma për kryerjen me sukses të mësimbesimit islam, ndërsa Adnan efendiut i ndau mirënjohje në shenjë falënderimi për kontributin e tij.

“Përgëzoj mualimin, Adnan efendiun, bashkë me nxënësit, për gjithë këtë punë dhe ju them se Myftinia e Shkupit, me gjithë kapacitetin e saj, do të jetë gjithmonë në përkrahjen e gjithë mualimëve tanë që kryejnë këtë detyrë të shenjtë”, ka shkruar të njëjtën ditë Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në faqen e vet në Facebook.

Në xhuanë që u fal pastaj, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit, mesazhin e Ditës e përcolli Myftiu dr. Qenan ef.



Ismaili. Në hytben e tij ai mes tjerash tha: "Sot, në këtë ditë të bekuar, nga kjo xhami, nga kjo shtëpi e Allahut, më duhet ta përcjell një mesazh të rëndësishëm:

besimtarët e fshatit Moranë po e dëshmojnë me vepër dashurinë dhe respektin që kanë ndaj mësimin të Fjalës së Allahut, duke i udhëzuar fëmijët në mësimin e Kuranit dhe të vlerave universale të Islamit. Ju, me këtë sakrificë, po investoni në mbrojtjen e Fjalës së Vërtetë, gjeneratë pas gjenerate dhe ky fakt duhet të ju bëjë krenarë.”

Myftiu po ashtu i priu xhematit në faljen e namazit të xhymasë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shkup.



JUSRA, HAFËZJA E PARË NË NORVEGJI

Është kënaqësi e veçantë të ndajmë këtë lajm të mrekullueshëm: qendrës sonë i është shtuar hafëzja e parë e Kuranit famëlartë – ka njoftuar më 23 janar, 2022, Qendra Islame Kulturore Shqiptare në Norvegji (QIKSHN).

Jusra Shabani, njëmbëdhjetëvjeçare, vajza e Kryetarit të Qendrës, zotëri Fatmir Shabani, dhe e mësueses së nderuar, zonjës Ermize Shabani, e kurorëzoi një punë të veçantë, duke nxënë të tërë Kurantin përmendsh, gjatë së cilës vazhdi-

misht pati kujdesin, përkushtimin dhe përkrahjen e plotë të prindërve.

Jusra është një nxënëse e dalluar, si me sjelljen e saj, gjithashtu edhe me sukseset e larta të arritura në shkollën e mësimbesimit këtu në Qendër, por edhe në mësimet e saj në shkollën norvegjeze.

I bëjmë lutje Allahut Fuqiptotë që Jusrës t'i japë suksese të vazhdueshme dhe të bëhet inspirim edhe për fëmijët tjerë. Allahume Amin – thuhet në njoftimin e QIKSHN.

HATME NË ZHITOSHË

Më 29 janar, 2022, në Xhaminë e Mesme të fshatit Zhitoshë u realizua një solemnitete fetar me rastin e përfundimit të hatmes së Kuranit famëlartë nga nxënëset/nxënësit e mektebit (mejtëpit) që e ndjekin mësimbesimin fetar tek Imam Musa ef. Shaqiri, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Prilepit Shefket ef. Imeri.

Krahas Myftiut të Myftinisë së Prilepit, Shefket ef. Imeri, në këtë manifestim, përpos xhematit, familjarëve dhe mysafirëve të shumtë, hoxhallarë të rrethit të Prilepit, pjesëmarrës ishin edhe Përfaqësuesi i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Myftiu i Myftinisë së Manastirit, h. Amit ef. Rasimi, Kryetari i Komunitetit të Dol-



Ineni z. Urim Ibeski, Sekretari i Myftinisë së Manastirit Orhan ef. Demiri, Referenti Ilmi ef. Osmani dhe Sekretari i Myftinisë së Prilepit, Muhamed ef. Gaziu, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Prilepit Shefket ef. Imeri.

ABC POETIKE NË MYFTININË E SHKUPIT

Më 10 shkurt, 2022, disa prej anëtarëve të Klubit Letrar ABC Poetike kanë qëndruar në Myftininë e Shkupit, ka njoftuar Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili.

Pata nderin dhe kënaqësinë e veçantë, ka thënë ai më tej, që të jem nikoqir i z. Vullnet Sadiku, Kryetar i ABC Poetike; z. Sadri Jakupi, anëtar; z. Tahir Seferi, anëtar; dhe z. Rexhep Memeti, anëtar.

Në këtë takim u njoftova për së afërmi me aktivitetet që zhvillon ABC Poetike nga Shkupi, për manifestimet letrare, ngjarjet mbi promovimin e librave të ndryshëm, si dhe për aktivitete që kanë për qëllim promovimin e vlerave letrare dhe artistike. Gjatë këtij takimi pata rastin

që t'i njoftoj mysafirët mbi veprimtarinë e gjerë të Myftinisë së Shkupit, si përfaqësues i jetës fetare islame në Shkup; mbi veprimtarinë tonë botuese, sfidat dhe arrijtet tona gjatë kësaj periudhe.

Shpreha gatishmërinë time për bashkëpunim institucional në sferat tona të përbashkëta. Në fund të takimit, mysafirëve u dhurova nga një ekzemplar nga libri im me titull "Xhamia, simbol i Shkupit", por dhe botime të tjera, tashmë të nxjerra nga shtypi: "Elifbaja" dhe "Ilmihal", botime zyrtare të Myftinisë së Shkupit, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili.



"Sot morëm pjesë në ceremoninë e varrimit të familja e h. Erqan Selimovski - Referent në Myftininë e Kërçovës, me rastin e ndërrimit jetë të nënës së tij. Ishte një përkrahje morale në këto momente të rënda familjare. Pritjen e organizoi Myftiu i Kërçovës, mr. Qamil ef. Rushiti, me bashkëpunorët e tij. Në fjalën time i shprehëm ngushëllimet tona të thella z. Erqan ef. Selimovski dhe familjes së tij, duke lutur Allahun Fuqipotë që rahmetliven ta gradojë me Xhenetin e amshueshëm, ndërsa familjes t'i japë sabrin e paluhatshëm", ka shkruar Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook më 18 shkurt, 2022. Një njoftim publik, shqip e maqedonisht, ka bërë edhe Myftinia e Kërçovës.

KONFERENCË NDËRFETARE NË TIRANË

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSH), në bashkëpunim me "Religions for Peace, Europe", zhvilluan më 10 shkurt, 2022, në ambientet e "Tirana International Hotel", konferencën ndërfetare me temë: "Vëllazëria në Humanizëm", thuhet në njoftimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Fokus i kësaj konference ishte dokumenti mbi "Vëllazërinë Njerëzore", nënshkruar nga Imami i Madh i Al-Az'har-it, Ahmad Al-Tayyeb, dhe Papa Françesku në vitin 2019.

Konferenca mbledhi së bashku krerët e 5 komuniteteve fetare zyrtare të vendit, si: H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; Mons. Angelo Massarfa, President i Konferencës Ipe-shkvnore të Shqipërisë; H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane; Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë; z. Anastas Janullatos, kreu i Kishës Ortodokse; z. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH dhe njëkohësisht zv/president i RfP, Europe, si dhe drejtues institucionesh, klerikë, akademikë, studiues dhe personalitete të fushave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Po ashtu, kjo konferencë mbledhi së bashku edhe emra të spikatur në fushën e



diplomacisë dhe të dialogut ndërfetar, siç ishin Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Yuri Kim dhe i ftuari i nderit, Presidenti i "Religions for Peace, Europe", dr. Luigi de Silva.

Në fjalën e tij të rastit në seancën hapëse të kësaj konference, kryetari Spahiu, pasi falënderoi organizatorët dhe pjesëmarrësit për këtë tubim mjaft domethënës në aspektin e bashkëjetesës ndërfetare, u ndal në domethënien e nënshkrimit të dokumentit mbi "Vëllazërinë Njerëzore", të lartpërmendur.

"Akte të tilla si ai që ndërmori Imami i Madh i Al-Az'har-it, Ahmad Al-Tayyeb,

dhe Papa Françesku në vitin 2019, janë akte kurajoze dhe vendosmërie të lartë. Ndërmarrja e nismave të tilla nuk është kurrë e lehtë për prijësit fetarë. Por në distancë kohore, me gjakftohtësi dhe me urtësi, këto janë nga ato ngjarje për të cilat historia i vlerëson si të drejta në të shumtën e rasteve për nga ndikimi në aspektin social. Ne shqiptarët, fatmirësisht, jemi një shembull i shkëlqyer sa i përket respektit të ndërsjellë ndaj besimit të njëritjetrit. Na mbetet vetëm të japim shembullin dhe kontributin tonë në këtë aspekt"- u shpreh z. Spahiu gjatë referimit të tij, thuhet në njoftimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

GENTI KRUA ZGJIDHET NËNKRYETAR I RPE

Siç njoftohet, më 25 janar, 2022, është mbajtur mbledhja e Bordit të Këshillave Ndërfetare të Evropës në Oslo, Norvegji (European Council of Religious Leaders-Religions for Peace Europe).

Në këtë mbledhje janë miratuar Rregullat e Përhershme të ENIB (Organet Ndërfetare Kombëtare Evropiane) dhe u zgjodhën Kryetari, Nënkrjetarët, Sekretari dhe Thesari i ENIB, i Feve për Paqen në Evropë.

Në këto zgjedhje Kryetar është zgjedhur dr. Luigi de Salvia, Nënkrjetarë: prof. dr. Elisabeth Naurath, dr. Genti Kruja dhe dr. Marsel Izraeli, Sekretar prof. dr. Joan Hernández-Serret dhe Thesari, Rya Tiar.

Përfaqësuesit e zgjedhur përfaqësojnë gjithashtu vende dhe fe të ndryshme në Evropë. ENIB përbëhet nga 11 këshilla ndërfetare të Evropës dhe janë pjesë e strukturës së Feve për Paqe,



Evropë, përfundon njoftimi.

Një përgjegjësi, por njëkohësisht dhe një nderim që të zgjidhem Nënkrjetar i Këshillave Ndërfetare të Evropës, ka shkruar dr. Genti Kruja më 27 janar, 2022, në faqen e vet në Facebook. Falënderojmë Zotin dhe gjithashtu jam krenar si shqiptar për harmoninë dhe bashkëpunimin e shkëlqyer ndërfetar të komuniteteve tona, ka thënë ai.

Siç ka njoftuar Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, 4 Shkurti është Dita Ndërkombëtare e Vëllazërisë Njerëzore, themeluar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së për të përkujtuar nënshkrimin e Dokumentit mbi Vëllazërinë Njerëzore për Paqen Botërore, firmosur nga Papa Françesku dhe Imami i Madh i Ez'herit, Shejh Ahmed al-Tajjib, në Abu Dhabi më 4 shkurt 2019.

HISTORIA E MUSAIT (A. S.) DHE PJESA ME HIDRIN

Nga Irfan Agushi

Historia Musait (alejhis-selam) është nga historitë e para islama që kam dëgjuar në odat e burrave, nga pleqtë e familjes. Më ka pëlqyer shumë pjesa me Hidrin (alejhis-selam) dhe tri tregimet që ndërlihen me të.

Më vonë, pas shumë vitesh, kur historia e pejgamberit Musa (alejhis-selam) u bë një ndodhi që duhej ta mësoja patjetër, nëse do të doja të shpëtoja nga qortimi i profesor Nuredin Ahmedit (Allahu e mëshiroftë), mësova edhe detaje të tjera.

Do t'i bie shkurt: Në momentet e fundit, teksa Musai (alejhis-selam) po kalonte me vështirësi Detin e Kuq, së bashku me popullin e tij, edhe Faraoni i etur për vrasje u fut në ngushticën për të kaluar në anën tjetër. Por, këtë mundësi shpëtimi Allahu e kishte porositur vetëm për besimtarët. Siç dihet, Musai (alejhis-selam) me popullin e tij kalon në anën tjetër, ndërsa Faraoni bashkë me ushtrinë e vet mbytet në det.

Këtu kam veçuar dy gjëra. E para ka të bëjë me dy ajete kuranore, ku Allahu (xh. sh.) thotë: "...kur po mbytej, (Faraoni) tha: 'Besoj se s'ka zot tjetër, përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit; edhe unë jam ndër myslimanët.'"

Por, Faraonit nuk iu pranua pendimi, pasi ishte në çastet kur po vdiste. Zoti i lartësuar iu përgjigj: "Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?! Sot do të shpëtoj më vetëm trupin tënd, që të bëhesh



mësim për ata që vijnë pas teje. Por, në të vërtetë, shumica e njerëzve nuk ua vënë veshin shenjave Tona." (Junus, 90-92)

Trupi i Faraonit, i cili u mbyt në det, edhe sot e kësaj dite gjendet në Muzeun e Kajros në Egjipt. Në vitin 1976 u dërgua në Francë për një ekzaminim dhe më pas, në vitin 1981, u rikthye në Egjipt.

Sipas egjiptologëve dhe historianëve të fesë, mundësitë janë shumë të mëdha që trupi i Faraonit Ramzes të jetë ai për të cilin Zoti flet në ndodhinë me Musain (alejhis-selam).

Kjo ndodhi vazhdon të mbetet një mrekulli në vete për ata që logjikojnë, e cila e vërteton fjalën e Allahut të shpallur në Kuran që para më shumë se 1400 vitesh.

E dyta, e cila ka domethënie po ashtu të rëndësishme, është dhe rrëfimi i melaqes Xhibril (alejhis-selam) mbi momentet e fundit në detin e hapur. Transmeton ibn Abasi (radiallahu anhu) se Xhibrili (alejhis-selam), pos tjerash, në këtë rast

ka thënë: "Kisha frikë se mos ia pranon lutjen Allahut!"

Edhe përkundër mosbesimit, shpalljes së vetes së tij për zot, vrasjes së njerëzve të pafajshëm, vrasjes së fëmijëve dhe zulumeve të tjera të bëra mbi popullin e Izraelit, në momentin kur Faraoni tha „besoj se s'ka zot tjetër, përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit...”, Xhibrili (alejhis-selam) ka shpejtuar ta mbyt në ujë, pasi i është dhënë urdhri, nga frika se mos Allahu e mëshironte dhe e falte.

Çfarë na thotë kjo ndodhi? Frika e Xhibrilit (alejhis-selam) se mos, vallë, Allahu do ta pranonte faljen e Faraonit mizor, tregon që Allahu është shumë i mëshirshëm, Ai fal dhe mëshiron shumë.

Dhe, kur jemi këtu - kush tjetër, pos Xhibrilit (alejhis-selam) e njuh Krijuesin tonë më mirë?!

Prandaj, duhet të ndalojmë të bëjmë gjykatësin suprem! Ne nuk jemi askush që t'i mbyllim derën e pendimit dikujt që është i zhytur në mëkate. Nëse ti fal namaz dhe shoku yt jo, mos nxito të mendosh se ai ka përfunduar dhe se mëshira e Allahut nuk e përfshin atë. Nëse dikush pi alkool, duke e ditur se është haram, mos e klasifikoj për në zjarr, sepse Allahu fal shumë dhe nuk është në dorën tënde gjykimi i njerëzve.

Kur jemi këtu, duhet ditur që është obligim të këshillohemi mes vete, por nuk na takon të gjykojmë njerëzit, pasi mëshira e Allahut (xh. sh.) përfshin gjithçka, madje edhe atë që neve mund të na duket e pamundur.

PROFESORË NGA PRISHTINA NË BFI

Më 15 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në një vizitë miqësore e vëllazërore, në Selinë e Rijasetit, dy personalitete të mirënjohura në sferën e zhvillimeve shkencore dhe kulturore: prof. dr. Fahrush Rexhepin, Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë dhe prof. dr. Jusuf Osmanin, nga Prishtina, studiues i njohur i arkivistikës dhe hulumtues i dokumenteve historike shqiptare dhe i kulturës osmane, por dhe kontribues i madh i nxjerrjes në pah të rolit të Islamit në ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarët, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë takim Reis'ul-Ulemaja dhe mysafirët biseduan mbi zhvillimet shkencore në trojet shqiptare dhe më gjerë, mbi nevojën e ngritjes së vetëdijes për hulumtime në sfera të ndryshme kulturore, në veçanti mbi rolin e institucioneve islama në



kohën tonë, siç janë medresetë, fakultetet dhe institucionet tjera.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja gjatë bisedës me Dekanin përkujtuan 5 vitet e shkollimit të tyre të përbashkët, si një gjeneratë në Medresenë e Alaiddinit në Prishtinë, vatrë e famshme e kuadrore fetare-islame në trojet shqiptare dhe ballkanike, thuhet në njoftimin e BFI-së.

RAFI HALILI, INSPIRUES PËR TË VËRTETËN

Më 29 janar, 2022, në varrezat e qytetit të Tetovës është bërë varrimi i Rafi Halilit, i përndjekur dhe i burgosur politik nga fshati Gajre i Tetovës. Rafi Halili është lindur më 11 tetor 1950, ndërsa ka ndërruar jetë më 28 janar 2022.

U bë varrimi i patriotit dhe atdhetarit nga Tetova jonë-Lalës Rafi (Rafi Halili). Allahu Fuqiplotë për sakrificën që Lala Rafi ka bërë për popullin shqiptar, varrin ia bëftë bahçe xheneti dhe ta shpërblejë me xhenet! – ka njoftuar Myftinia e BFI-Tetovë.

Pas lajmit të shpallur, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, në profilin e vet në Facebook ka shkruar: "Rafi Halili kaloi në botën tjetër. Tërë jetën ia kushtoi dinjitetit dhe ngritjes së kombit të tij, plot sakrificë shpirtërore dhe fizike.

Vuajtjet e tij u dhanë shtytje vlerave humane, njerëzore dhe kombëtare. Ashtu siç ishte inspirues për të vërtetën, kur ishte i gjallë, mbetet i njëjtë edhe pas vdekjes. Ngushëllime familjes, popullit dhe i bëjmë lutje Allahut Fuqiplotë që t'u japë durimin e pashoq, ndërsa të ndjerit xhenetin e amshueshëm." Ky mesazh ngushëllimi është shpërndarë edhe nga BFI.

Ra edhe një listë – ka shkruar Shpëtim Pollozhani, Kryetar i Shoqatës së të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë Shqiptarë, pas ndërrimit jetë të Rafi Halilit. Në njoftim më tej thuhet:

"Sot në Tetovë ndërroi jetë Rafi Halili, i lindur në vitin 1950. Na shkoi syhapur edhe një bashkëveprimtar, duke rezistuar deri në ditën e fundit të jetës kundër padrejtësive që u bëhen shqiptarëve!

Konfrontimi i tij me pushtuesit, si e quante ai pushtetin, filloi që në moshën e tij si i mitur, në vitin e largët 1967. Ai nuk iu nënshtrua kërcënimeve asnjëherë, duke qenë në krye të Demonstratave të vitit 1968. Pas revoltës së shqiptarëve, atë e shohim si udhëheqës të Organizatës Illegale Kushtrimi i Lirisë. Edhe pse kërkohet nga të gjitha shërbimet sekrete të Jugosllavisë, ai një periudhë të gjatë veprimi në ilegalitet, duke u strehuar dhe bashkëveprimtar që nga Struga deri në Kosovë.

Në 6 qershor të vitit 1982 ai ra në kurth, me ç'rast na e burgosën dhe na e dënuan nga 13 dhe 15 vjet burg! Rafiu e filloi burgun e tretë me tri plagë të marra gjatë arrestimit dhe shkëmbimit të zjarrit me Njësitë speciale të UDB-së.

Gjatë gjithë burgosjeve dhe vuajtjeve të dënimit, ai kishte qëndrim stoik dhe

dinjitoz. Lavdi jetës dhe veprës së Rafi Halilit! Ngushëllime familjes dhe shoqërisë!

Sipas vullnetit të familjarëve, Shoqata do të merret me organizimin dhe protokolllin e procedurës mortore, përfundon njoftimi i Shoqatës së të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë Shqiptarë, nënshkruar nga Kryetari Shpëtim Pollozhani.

Para se të bëhet varrimi, në Komunën e Tetovës është mbajtur një mbledhje komemorativë në kujtim të patriotit Rafi Halili. Në të ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Tetovës, z. Bilal Kasami. Kasami e ka quajtur atë si njeri të vlerave të mëdha kombëtare, i cili jetën ia kushtoi çështjes shqiptare. Siç është raportuar, në mbledhjen komemorativë kanë marrë pjesë personalitete të shumta të jetës publike dhe jo vetëm.

Kryetari i Komunës, Bilal Kasami, më parë kishte dalë me një telegram ngushëllimi, në të cilin thuhej: "Me rastin e humbjes së parakohshme të Rafi Halilit, veprimtarit të madh të kauzës kombëtare, u shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes dhe gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Vepra e bacit Rafi Halili mbetet monument i kombit shqiptar. Ndërkaq, Çarshia e Epërme, lagjja ku bashkëjetuam, do ta ndiejë mungesën e frymimit të tij. I përjetshëm kujtimi për Rafi Halilin. Lamtumirë, hero!"

Në telegramin e ngushëllimit të Universitetit të Tetovës, nënshkruar nga Rektori prof. dr. Reshat Qahili, thuhet: "Me dhimbje të thellë morëm lajmin për ndar-



jen nga jeta të veprimtarit të njohur të kauzës sonë kombëtare, Rafi Halili. Simboli i rezistencës shqiptare, Rafi Halili, që në rini të hershme u angazhua fuqishëm për të drejtat tona, si në arsim, në kulturë dhe në lëmenj të tjerë. Emri i tij personifikon frymëzuesin më emblematik të atdhetarit, i cili me burrëri, me vepër dhe me sakrificë e flak njëherë e përgjithmonë robërinë e huaj, për të vendosur themelet e historisë sonë më të re.

Rafi Halili do të kujtohet përgjithmonë si atdhetar i papërkullor, si veprimtar i palodhur për parandalimin e tendencave diskriminuese nga regjimi i diktaturës komuniste jugosllave ndaj shqiptarëve në Maqedoni, Kosovë dhe më gjerë.

Në emër të Universitetit të Tetovës, u shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes, miqve dhe mbarë opinionit. I paharruar qoftë kujtimi për të."

Që nga dalja prej burgut, Rafiu, shoku im i shkollës, jetoj me shëndet të rënduar, ashtu i izoluar, i tërhequr në vete dhe fjalëpak në takimet që kisha me të – ka shkruar prof. Vebi Bexheti në faqen e vet në Facebook. Këtë shkrim nekrolog për njeriun që qëndroi vetikalisht dhe i pathyeshëm edhe në torturat më çnjerëzore desha ta mbyll me dy vargje të Azem Shkrelit: Në sytë e tij/ Vetëm harroi përrëndimin dita!

Lavdi jetës dhe veprës atdhetare të Rafi Halilit, modelit të shqiptarit të pathyeshëm, njeriut të pandalshëm për liri e bashkim kombëtar! - ka shkruar prof. Vebi Bexheti.

Poeti dhe veprimtari nga Shipkovicja, Baki Ymeri, që jeton dhe vepron në Bukuresht (Rumani), ka shkruar: Kujtime mbi shqiptarin që e ngriti flamurin në zemër të Dardanisë! Pa heronj na vjen ftohtë në histori. Libri i parë i poetit Marin Kodreanu mban titullin "Pa heronj na vjen ftohtë në histori".

VARROSET NË GAÇKË MULLA BUJAR EF. HASANI

Më 31 janar, 2022, në varrezat e fshatit Gaçkë të Ferizajt, në prani të familjarëve, miqve, përfaqësuesve të institucioneve lokale, hoxhallarëve dhe shumë xhematlinjve, u varros mulla Bujar ef. Hasani, i cili ndërroi jetë një ditë më parë, pas një sëmundje të rëndë, ka njoftuar Këshilli i Bashkësisë Islame Ferizaj, Republika e Kosovës.

Namazit të xhenazes i priu kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili çmoi dhe vlerësoi jashtëzakonisht lart kontributin e mulla Bujarit për institucionin e Bashkësisë Islame në përgjithësi dhe për xhematin ku shërbeu në veçanti. Ai luti Zotin e madhërishtëm që mulla Bujarin ta ketë marrë në mëshirën e Tij dhe ta shpërblejë me Xhenet.

Duanë e xhenazes e bëri imami i Xhamisë së Madhe të Ferizajt, mulla Adem ef. Hoxha, thuhet në njoftimin e Këshillit të Bashkësisë Islame Ferizaj.

Po nga ky Këshill është shpërndarë kjo biografi, në të cilën lexojmë: Bujar ef. Hasani u lind më 19 dhjetor 1978 në Gaçkë të Ferizajt. Shkollën fillore e kreu

në vendlindje, për të vazhduar më pas në medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë, në vitet 1993-1997. Më 1999 regjistrohet në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, të cilin e përfundoi në vitin 2006.

Fillimisht punoi si imam në Xhaminë e Vjetër në lagjen e Berishajve, për të vazhduar më pas në Nikadin, në Cernillë, në Mirash, Doganaj dhe së fundi, nga viti 2007, ushtroi detyrën e imamit, të hatibit dhe të mualimit në xhaminë e fshatit Gaçkë të Ferizajt.

Në periudhën 2016-2020 ushtroi detyrën e Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt, ndërsa në vitin 2017 regjistroi studimet master në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenetin Firdeus! - thuhet në njoftimin e Këshillit të Bashkësisë Islame Ferizaj.

Hoxha nga Sllakovci i Epërm, afër Gjilanit, me qëndrim në Zvicër, Rexhep Gurgurovci, ndërkaq, më 30 janar, 2022, kishte shkruar: "Sot kanë ndërruar jetë dy hoxhallarë, dy dijetarë, dy profesorë,



dy kryetarë, atdhetarë dashamirë e familjarë tanë: Bujar ef. Hasani nga fshati Gaçkë e Ferizajt dhe prof. Naim ef. Ferati nga Tetova, profesor kontributdhënës në Medresenë Isa Beu. Bujar ef. Hasani iu bashkëngjiti babait të tij, hoxhë Avdyll Hasani, i cili vdiq para tri ditëve. I bëjmë lutje Allahut të madhërishtëm që të tre t'i shpërblejë me xhenet, ndërsa familjet, miqtë, shokët, kolegët, xhematet dhe nxënësit e tyre t'i forcojë me sabër e gajret."



"Sot vendosa që bashkë me Myftiun e Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, të jem në përkrahje morale për t'i zbutur dhimbjen hoxhës Jonuz ef. Jonuzi, Imam i fshatit Llakavicë, me rastin e vdekjes së motrës së tij në moshë të re dhe në ngushëllime të bashkëshortit të saj, Jusuf Bilalli dhe familjes së tij nga fshati Negotinë. Këshilluam për durim në këto momente të dhimbjes. Në prezencë të një masoviteti të besimtarëve, bashkërisht i drejtuam lutjet tona Allahut Fuqiptotë që të ndjerës t'i falë xhenetin e amshueshëm", ka shkruar në faqen e vet në Facebook Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (23.01.2022)

LARGOHET NGA KJO JETË PROF. REMZI EF. REXHEPI

Sot, 18 shkurt, 2022, pata nderin të mbaj hytben e xhumasë dhe të prezantoj në ceremoninë e varrimit të rahmetli prof. Remzi ef. Rexhepi në varrezat e fshatit Sullare (Shkup). Ai sot u përcoll për në banesën e fundit nga një xhemat i madh, me pjesëmarrje të gjerë të profesorëve, të udhëhequr nga Drejtori i Medresesë dhe shumë hoxhallarë të kësaj ane, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut, së bashku me organet dhe institucionet e saj edukativo-arsimore, ngushëllon familjen e profesorit të ndjerë, Drejtorin e Medresesë Isa Beu, Këshillin edukativo-arsimor, profesorët, edukatorët, nxënësit dhe miqtë e shumë që i kishte i ndjeri prof. Remzi Rexhepi, i cili tërë jetën ia kushtoi edukimit dhe arsimimit të gjeneratave të reja, brez pas brezi, Medresesë dhe Islamit në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Po ashtu, edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përcolli mesazhe prekëse dhe ngushëllime të sinqerta në faqen e tij personale në rrjetet sociale:

"Me keqardhje dhe dhimbje të thellë mora lajmin e ndërrimit jetë të shokut dhe të hoxhës sonë h. Remzi ef. Rexhepi. Jetoi dhe veprroi tërë jetën në shërbim të familjes, të popullit dhe të Islamit. Me dekada veprroi në SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup. Ishte modest, me kulturë të nivelit të lartë, i urtë, i afërt me njerëzit, gjithmonë i gatshëm në kryerjen e detyrave të tij dhe më gjerë. Unë e kam pasur shok të ngushtë, sepse kemi kryer bashkë Medresenë e Alauddinit në Prishtinë. Në këto momente të rënda, Drejtorit të SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, Këshillit arsimor, Myftinisë së Shkupit, në veçanti familjes së ngushtë, në emër të BFI të RMV dhe në emrin tim u shpreh ngushëllime të thella, duke iu lutur Allahut Fuqiptotë që t'ju japë durim të paluhatshtëm, ndërsa rahmetliut t'i falë xhenetin e amshueshëm."

Lajmi pikëllues u kumtua më 17 shkurt, 2022, nga Medreseja Isa Beu në Shkup: "Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi. Me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga kjo botë të profesorit, edukatorit tonë në "Medresenë Isa Beu", prof. Remzi ef. Rexhepi. Në emrin e Drejtorisë, të Këshillit edukativo-arsimor, të nxënësve/seve, u shprehim ngushëllimet më të

sinqerta familjes, shokëve dhe miqve të tij. E lusim Allahun Fuqiptotë që rahmetliun ta shpërblejë me xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë sabrin."

Drejtori i Medresesë, prof. Ibrahim ef. Idrizi, në faqen e vet në Facebook kishte shkruar: "Më preku thellë në shpirt vdekja dhe ndarja nga kjo botë e mikut tim dhe përkrahësit më të sinqertë, që nga bankat e Medresesë Alauddin në Prishtinë. E lusim Allahun (xh. sh.) që ta përfshijë në rahmetin e Tij dhe Xhenetin Firdaus vendqëndrim t'ia bëjë."

Në mesazhin e ngushëllimit të Myftiut të Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili, thuhet: "Dje morëm lajmin e hidhur dhe të dhimbshëm për ndërrimin jetë të prof. Remzi ef. Rexhepi, Profesor i Medresesë Isa Beu në Shkup. Është një humbje e madhe për të gjithë ne, sepse la gjurmë të pashlyeshme në edukimin e brezave, duke qenë tërë jetën në shërbim të plotë. Në emrin e Myftinisë së Shkupit, në emër të hoxhallarëve e të xhematit të Shkupit dhe në emrin tim personal, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta dhe më të thella familjes, shokëve, xhematit dhe miqve të tij. Allahu e mëshiroftë rahmetli Remzi ef. Rexhepin me xhenetin e amshueshëm", thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftiut dr. Qenan ef. Ismaili.

"Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi: Me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të profesorit-edukatorit në Medresenë Isa Beu në Shkup, prof. Remzi ef. Rexhepi – thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftinisë së BFI-Tetovë.

Në emrin e BFI-Myftiniasë e Tetovës, në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë besimtarëve, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve, nxënësve dhe miqve të tij. E lusim Allahun Fuqiptotë që rahmetliun ta shpërblejë me xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë sabrin", përfundon mesazhi i ngushëllimit i Myftinisë së Tetovës, nënshkruar nga Myftiu prof. dr. Qani ef. Nesimi.



U PËRCOLL NË AMSHUESHMËRI PROF. NAIM EF. FERATI

Më 31 janar, 2022, i dhamë lamtumirën profesorit të Medresesë Isa Beu, Naim ef. Ferati. Xhenazja e merhumit u përgatit në shtëpinë e tij, në Zherovjan, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Përveç Myftiut të Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, në varrim morën pjesë: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përfaqësuesi i Bashkësisë Islame të Kosovës Reshat ef. Mexhiti, Myftiu i Gostivarit Sabahudin ef. Zendeli, Myftiu i Kërçovës Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, Myftiu i Shtëpitë mr. Nasir ef. Rexhepi, Myftiu i Ohrit Samet ef. Ajdari, Myftiu i Velesit Nejazi ef. Murati, Dekani i FSHI prof. dr. Shaban ef. Sulejmani, Drejtori i përgjithshëm i Medresesë Isa Beu Ibrahim ef. Idrizi, ish-myftinjtë e Tetovës Alifekri ef. Esati dhe hfz. mr. Nexhadi ef. Limani, profesorë nga FSHI dhe Medreseja, bashkëpunëtorët e Rijasetit, bashkëpunëtorët e Myftinive, hoxhallarë, imamë të qytetit (të Tetovës) dhe të rajonit, familjarë, miq dhe mysafirë nga vendi, Kosova dhe Sanxhaku. Profetori i nderuar u varros në varrezat e fshatit Zherovjan. Duanë e bëri ish-Kryetari i Këshillit të Prizrenit Ali ef. Vezaj, ndërsa tallkinin e këndoi imami i xhamisë së fshatit Miletinë hfz. Besir ef. Hamidi.

"Kur jeta dhe vepra flasin shumë, vdekja flet edhe shumë më shumë", kishte thënë gjatë përcjelljes së prof. Naim ef. Feratit për në botën tjetër prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myfti i Myftinisë së Tetovës.

Siç raportohet nga BFI, në fjalën e tij Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetari i BFI të RMV, përveç tjerash tha: "Vdekja e birit të këtij populli, shokut tonë, rahmetli Naim ef. Ferati, befasoi të gjitha institucionet e BFI, të gjithë ulematë islamë, sepse ai nuk ishte vetëm i familjes, por ishte i gjithë myslimanëve; ishte bir i këtij populli, ishte bir i këtij vatani. Kur e pyesja në takimet tona, i thosha 'si je Naim efendi?'. Kishte një fjali që e thoshte të parën: 'Më mirë, vetëm në Xhenetin Firdeus'. Sikur ishte i bindur dhe sikur kishte nisur që të kalonte në botën tjetër, por ne nuk mendonim që do të kalonte në botën tjetër mu në moshën kur ne prisnim edhe më tepër prej tij në jetën fetare-islame të Bashkësisë Fetare Islame të RMV".

BIOGRAFIA

Naim ef. Ferati (në Medrese është regjistruar si Neim, ndërsa në librat që ka botuar si Naim) lindi më 27 dhjetor 1960 në fshatin Zherovjan të Tetovës. Shkollimin fillor do ta mbarojë në fshatin e lindjes, ndërsa atë të mesëm në medresenë "Alauddin" në Prishtinë, në vitet 1976-1981. Pas mbarimit të Medresesë, në vitin 1981, ai i vazhdon studimet në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, ku me sukses përfundon studimet dhe diplomon në vitin 1986.

Pas përfundimit të studimeve, Naim ef. Ferati punësohet si imam, fillimisht në Mal të Zi, gjatë viteve 1986-1988, dhe më pas, nga viti 1988 deri në vitin 1991, në fshatin Llabunishtë (Labënishtë) të Strugës.

Nga viti 1991 deri në vitin 2013 angazhohet si profesor në Medresenë Isa Beu në Shkup dhe më pas, nga viti 2013 deri në vitin 2022, kalon si profesor në Medresenë Isa Beu, Paralelja e Shtrirë në Tetovë.

Naim ef. Ferati ishte një pedagog i palodhur, me horizont të gjerë, i cili një pjesë të jetës së tij, me dashamirësinë dhe zemërgjerësinë që e karakterizonte, ia kushtoi përgatitjes së brezit të ri. Ai do të mbetet i paharruar, si për kolegët, ashtu edhe për të gjithë nxënësit e Medresesë. Profesor Naim ef. Ferati ndërroi jetë më 30 janar 2022. Lajmi për vdekjen e tij pikëlloi jo vetëm familjen e tij, por edhe të gjithë ata që e njihnin. Allahu e pastë mëshiruar! – thuhet në njoftimin e BFI-së dhe të Myftinisë së Tetovës.

Ditën që kishte ndërruar jetë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu kishte bërë një mesazh ngushëllues për familjen, për miqtë dhe kolegët e Profesorit të respektuar Naim ef. Ferati. Në mesazh thuhet: "Me caktimin e Zotit, u nda nga ne dhe i fali shpirtin Allahu Fuqplotë profesori dhe teologu i madh dhe i mirënjohur Naim ef. Ferati. Dhimbje dhe humbje e madhe për të gjithë ne: për BFI e RMV, për Myftininë e Tetovës, për Medresenë Isa Beu, së cilës ia fali tërë jetën, për nxënësit, për besimtarët, për shokët, për vendin dhe kudo që veproi. Ndërsa për mua: dhimbje, jo vetëm të një mësimit, por të një shoku të jetës sime fetare, kombëtare dhe familjare. Ishte një inspirues i madh i da-



shurisë ndaj Zotit, Islamit, mësimit dhe shkencës, i urtë dhe i mençur si pedagog, i afërt me nxënësit sikur të jetë prind i tyre, solidar me shokë në çdo moment dhe situatë dhe i palodhshëm në shpjegimin e vlerave islame, jo vetëm në vendin tonë, por edhe jashtë. Për këtë e donim dhe e respektonim të gjithë. Ishte inspirues i gjallë i vlerave në jetë; ngel i tillë edhe pas ndërrimit jetë. Me gjithë dhimbjen e madhe që kemi, i mbështetemi caktimit të Allahut Fuqplotë, sepse ne jemi të Tij dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë. Ngushëllime të thella familjes. Allahu i faltë xhenetin e amshueshëm, ndërsa familjes durim të paluhatshëm. Allahu e mëshiroftë."

DHIMBJE DHE PIKËLLIM

Me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga kjo botë të profesorit në Medresenë Isa Beu, Paralelja e Vajzave në Tetovë, prof. Naim ef. Ferati, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, ku rahmetliu punonte.

Në emrin e Drejtorisë, të Këshillit edukativo-arsimor, të nxënëseve/të nxënësve, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve dhe miqve të tij. I bëjmë lutje Allahut Fuqplotë që profesorin tonë ta shpërblejë me xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë sabrin, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Në telegramin e ngushëllimit të Fakultetit të Shkencave Islame-Shkup, ndërkaq, thuhet:

"Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të profesorit Naim Ferati, njërit prej profesorëve më ambicioz e më të dashur jo vetëm për familjen, por edhe për miqtë e tij.

Profesori Naim Ferati iku nga kjo botë, por gjithnjë do të mbetet në zemrat tona.

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup me dhimbje të thellë e pranoi këtë lajm dhe i bën lutje Allahut të Gjithëmëshirshëm që ta pranojë në mesin e robve të Tij të devotshëm dhe të sinqertë.

Xheneti qoftë vendbanimi i tij i përhershëm. Allahu e falte dhe e mëshiroftë! – thuhet në telegramin e ngushëllimit të FSHI, nënshkruar nga Dekani, prof. dr. Shaban Sulejmani.

"Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi." Me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të profesorit në Medresenë Isa Beu, Paralelja e Shtrirë - Tetovë, prof. Naim ef. Ferati, thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftinisë së BFI-Tetovë.

Në emrin e Myftinisë së Tetovës, në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë besimtarëve, hoxhallarëve, shokëve, nxënëseve/nxënësve, profesorëve të Medresesë, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve dhe miqve të tij. I bëjmë lutje Allahut Fuqplotë që rahmetliu ta shpërblejë me xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë sabrin, thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftinisë së Tetovës, të nënshkruar nga Myftiu prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Me dhimbje të thellë, me mërzi të madhe, por me besim të fuqishëm në Zotin e Madhërishtëm, morëm lajmin për ndarjen nga jeta e kësaj bote të profesorit të SHMI "Medreseja Isa Beu", prof. Naim ef. Ferati, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Gostivar.

Profesori i nderuar, thuhet në njoftim, do të mbahet mend ndër breza si edukator, këshillëdhënës, i afërt me secilin, vizitues te çdonjëri për të mirë e për raste të ndryshme, i këndshëm, dijetar dhe sqarues i njohurive islame dhe të përgjithshme, mësimitdhënës i shumicës së kuadrove të ndryshme të dala nga Medreseja.

Në emër të Myftinisë së BFI-Gostivar, stafit të Myftinisë, të nëpunësve fetarë, të Këshillave të xhamive, të besimtarëve në përgjithësi, familjes së ngushtë Ferati i shprehim ngushëllimet më të sinqerta, që këtë dhimbje ta përballojë me lehtësim dhe profesorit tonë të dashur t'ia falë Xhenetin, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit, nënshkruar nga Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli.

Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, është shprehur: Me pikëllim e dhimbje të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta e kësaj bote të profesorit të SHMI "Medreseja Isa Beu", prof. Naim ef. Ferati.

Profesor Naimi do të mbahet mend në



Zherovjan: Përcillet në Ahiret prof. Naim ef. Ferati.

kujtesën tonë si edukator, si këshillëdhënës, i dashur me secilin, i këndshëm, dijetar dhe sqarues i njohurive islame, mësimitdhënës i shumë gjeneratave të diplomuara nga Medreseja Isa Beu.

Në emrin tim dhe në emër të Myftinisë së BFI-Shkup, të stafit operativ të Myftinisë, nëpunësve fetarë e hoxhallarëve të Shkupit, familjes Ferati u shprehim ngushëllimet më të sinqerta që në këtë sprovë t'u falë durimin, ndërsa profesorin tonë ta radhit në kategorinë e njerëzve të shpëtuar në Botën Tjetër!

Qofsh i xhenetit, profesor i dashur! – thuhet në fund të deklaratës publike të Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

توبوعجار هيل آنا و هل آنا! Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. Me pikëllim të thellë morëm lajmin se ka ndërruar jetë Profesori i Medresesë Isa Beu, prof. Naim Ferati, shkruan në njoftimin e Myftinisë së Ohrit.

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet profesorin tonë dhe e gradoftë në gradën më të lartë në Xhenet. Do ta kujtojmë përjetë si një mësues, si edukator i cili për disa dekada punoi pareshtur në Medresenë Isa Beu në Shkup dhe në Tetovë, si punëtor i dalluar, profesor i çmuar dhe një personalitet shumë i dashur nga medresantët. Do të na mungojë buzëqeshja e tij, mësimet e këshillat e tij me plot kujtime.

Në emër të Myftinisë, në emrin tim personal, në emër të kolegëve dhe në emër të të gjithë besimtarëve të qytetit të Ohrit, u shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes, Medresesë Isa Beu, shokëve, kolegëve dhe të gjithë nxënësve.

MIB: Hatme për Profesorin

Më 4 shkurt, 2022, para faljes së namazit të xhumasë, në Mesxhidin e Medresesë Isa Beu në Shkup u bë dua ja e hatmes, e lexuar nga ana e nxënësve, për të ndjerin profesor Naim ef. Ferati, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu (MIB).

Në emrin e Drejtorisë dhe në emër të profesorëve të Medresesë, në emër të nxënëseve dhe të nxënësve, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve dhe miqve të Profesorit. I bëjmë lutje Allahut Fuqplotë që rahmetliu ta shpërblejë me xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë sabrin, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu në Shkup, shpërndarë edhe nga BFI.

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet – thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Ohër, nënshkruar nga Myftiu Samet ef. Ajdari.

Salim ef. Sulejmani, Myfti i Myftinisë së Strugës, ka shkruar: Me dhimbje të madhe e mora lajmin e hidhur për ndërrimin jetë të profesorit tonë të dashur, Naim ef. Ferati. Prof. Naimi ishte më shumë se profesor; ai ishte si prind, si shok, si familjar dhe si dashamir.

Ishte shumë i lidhur me Strugën, sepse një kohë ka shërbyer si imam në fshatin Labënishtë. Përveç kësaj, shpesh vinte e na vizitonte dhe më zëvendësonte si imam tek Xhamia Lulishte.

Para katër ditëve u dëgjova në telefon dhe akoma i kam në mendje fjalët që m'i tha: "Salim efendi, unë ju dua; i dua miqtë, i dua nxënësit e mi; dukuni, mos na harroni."

Prof i dashur, Zoti të paska dashur më shumë dhe të mori afër Vetes, por ne asnjëherë nuk të harrojmë dhe gjithmonë do t'i kujtojmë nasihatet dhe këshillat tua. Zoti të mëshiroftë, profi ynë i dashur. Qoftë takimi ynë në xhenet e Zotit.

Në emrin tim dhe në emër të Myftinisë së BFI-Strugë, të stafit operativ të Myftinisë, nëpunësve fetarë e hoxhallarëve, familjes Ferati u shprehim ngushëllimet më të sinqerta! – thuhet në deklaratën publike të Salim ef. Sulejmanit, Myfti i Myftinisë së Strugës.

"ГИ ЗНАЕШЕ СИТЕ СВОИ ЏЕМАТЛИИ"

Hoxhë Jakub Qazimovski nga Labënishti (Llabunishti), Strugë, ka shkruar:

Си замина уште еден драг пријател,



Kemi shkuar për ngushëllime te familja Rexhepi në Tetovë, përkatësisht te familja e Myftiut të Shtipit prof. Nasir Rexhepi, me rastin e ndërrimit jetë të gjyshit të tij. Patëm një pritje të sinqertë dhe ndamë ngushëllimet tona, duke i bërë lutje Allahut Fuqplotë që familjarëve t'u japë durimin, ndërsa rahmetiut xhenetin e amshueshëm. Falënderojmë për organizimin Myftininë e Tetovës, në krye me Myftiun prof. dr. Qani ef. Nesimi dhe kolegët e tij – ka shkruar Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 9 shkurt, 2022.

ненадејно по наше сфаќање, но по одредба на Оној Кој ни дава живот и кај Кого сите ние се враќаеме.

Си замина уште еден драг пријател, кој по многу нешта беше посебен, и единствен.

Неговата искрена и благородна насмевка при секоја наша средба беше прво што се гледаше на неговото нурли лице.

Секој негов збор извираше од срце и зрачеше со искреност и едноставност.

Беше Имам во Долна џамија во Лабуншта во времето кога јас бев на студии во Сараево.

Беше Имам кој беше пример и инспирација за секој студент и ученик каков треба да биде денес еден современ имам.

Беше Имам кој по име и презиме ги знаеше сите свои џематлии, сите свои лабуништани, млади и стари, и никогаш не ги заборави.

Секоја негова хутба/говор и секој негов дерс/предавање беа едноставни, јасни, аргументирани и корисни.

Си замина мојот драг пријател, Наим еф. Ферати, кој со своето заминување ќе остави празнина и тага кај сите негови пријатели, така и кај мене, пријател кого никогаш нема да го заборавам.

Секое негово доаѓање во Струга, секоја наша средба за нас беше радост и привилегија.

Го молам Возвишениот Аллах да ти се смилува, да ти опрости и да те израдува со награда во Џеннет, мој драг Наим ефендија. Амин.

Ел-Фатиха – ка shkruar hoxhë Jakub Qazimovski nga Labënishti, Strugë.

Me telegram ngushëllimi ka dalë edhe Myftinia e Kumanovës. Në të thuhet: Lajmi për vdekjen e profesorit Naim Fe-

rati na pikëlloi dhe na tronditi rëndë në shpirt të gjithëve. Me këtë rast, duam që me fjalët që burojnë nga zemra sinqerisht të ndajmë dhimbjen bashkë me ju, duke qenë të bindur se si gjithnjë deri më sot, familja juaj do të qëndrojë e fortë dhe do ta përballojë këtë goditje të rëndë.

Në emër të Myftinisë së BFI-Kumanovës, në emër të të punësuarve në Myftini, i shprehim ngushëllime familjes së profesorit dhe i bëjmë lutje Allahut të Madhërishtëm që t'u japë forcë që ta përballoni këtë goditje të rëndë.

Pa dyshim se puna juaj si profesor në Medresenë e Isa Beut ka një vlerë të madhe dhe kontributi juaj kurrë nuk do të harrohet. Allahu të mëshiroftë dhe të shpërbleftë me Xhenetin Firdeus – thuhet në deklaratën publike të Myftinisë së BFI-Kumanovës, nënshkruar nga Myftiu Abedin ef. Imeri.

Më 30 janar, 2022, Xhamia Hëna e Re në Kreuzlingen (Kanton Thurgau), Zvicër, ka shkruar: „Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem.“ „Sot ka ndërruar jetë profesor i Medresesë Isa Beu në Maqedoni të Veriut, z. Naim ef. Ferati nga fshati Zherovjan i Tetovës.“

Xhemati ynë ka pasur nderin ta ketë imam këtu në Kreuzlingen dy Ramazane radhazi - në vitin 1998 dhe 1999.

Allahu i Plotmëshirshëm të ndjerin e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenetin Firdeus, ndërsa familjes, shokëve, miqve dhe mbarë komunitetit mysliman u dhëntë fuqi dhe sabër! – përfundon njoftimi i Xhamisë Hëna e Re në Kreuzlingen, nënshkruar nga Imami Rejhan Neziri.

“Në vend të lamtumirës”, nga Evzal ef. Sinani, nga Gostivari. Në të, përveç tjerash, thuhet:

I dashur profesor, vdekja nuk ka fuqi ta mbyt emrin e një njeriu që njeh zot veç Allahut dhe e njeh Atë siç duhet; e, si do të

ketë fuqi ta mbyt emrin tënd që gjithë jetën dert të vetëm kishe Atë në çdo punë që bëje?!

I dashur profesor, shpirti yt tash është i lirë të fluturojë në xhenetet të cilat me aq bindje i doje, të cilat me aq zell e ëndje i kërkoje!

I dashur profesor, vdekja nuk ka fuqi ta fshijë ndikimin e shtrëngimit të fjalës “elhamdulillah” që dilte nga zemra jote e kënaqur. Ti çdoherë kënaqeshe me pak dhe nuk kërkoje për vete asgjë.

I dashur profesor, si mund të ketë vdekja fuqinë që të fshijë emrin e një bujari, i cili për qindra medresantë ishte mbështetja që u mungonte nga familjet?

Si mund të humbet emri i një njeriu që nuk u tundua nga asnjë e mirë materiale e kësaj jete për të hequr dorë nga parimet?!

Si mund të shuhet emri i një dijetari, i një mendimtari, i cili para se të dinte vepronte dhe para se të vepronte ishte i sinqertë?!

I dashur profesor, mijëra medresantë e medresante sonte e ndiejnë dhimbjen e familjes sate, së cilës do t'i mungosh shumë. Do u mungosh miqve, do u mungosh nxënësve, do i mungosh shoqërisë. Do na mungosh, edhe atë shumë...

I dashur profesor, ka thënë drejtë i urti: të tillët si ti nuk humbin, por i humbim.

Ishe i mirë në dynja, mirë qofsh edhe në ahiret. Dëshmojmë se goja jote diti të nxjerrë vetëm fjalë kënaqësie me caktimin e Allahut dhe pate mendim të mirë për Krijuesin tënd!

Profesor i dashur, me dhimbje, me plot dhimbje, lutemi për ty, po edhe për veten, se kemi humbur shumë. Të rrallë janë lundërtarët me besim se do të vijë deti i qetë në kohët plot stuhi, e ti ishe i tillë.

Qofshin sinqeriteti yt, jeta jote për dijen, dashuria jote për kërkuesit e dijes, bujaria, kënaqësia me Zotin, pozitiviteti dhe mirësia jote, çelës i mikpritjes së Zotit ndaj teje!

Lutemi nga Ai të të thuhet: “O shpirt i kënaqur me Zotin e vet. Kthehu te Zoti yt i kënaqur me Të dhe Ai i kënaqur me Ty! Bashkohu me robërit e Mi! Hyn në xhenetet e Mia!” – përfundon Evzal ef. Sinani, nga Gostivari, më parë Shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Familjes Ferati nga Zherovjani i kanë shkruar edhe më shumë telegrame të tjera ngushëllimi pas kalimit në amshim të prof. Naim ef. Ferati. BFI e RMV telegram ngushëllimi ka marrë nga Komuniteti Mysliman Shqiptar i Austrisë (ALKIG) me seli në Vjenë etj.

NGUSHËLLOHET FAMILJA QERIMI NË KUMANOVË

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri dhe bashkëpunëtorët, më 1 shkurt, 2022, ishin në një vizitë ngushëllimi te familja Qerimi në Opajë të Kumanovës, me rastin e kalimit në amshim të Rexhail Qerimit në Burgun e Idrizovës, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në organizim të Myftinisë së Kumanovës, në krye me Myftiun Abedin ef. Imeri, ngushëllimtarët patën një pritje të ngrohtë dhe vëllazërore. Reis'ul-Ulemaja në emër të BFI-së familjes Qerimi i dha përkrahje dhe kurajo në këto momente të një dhimbjeje të madhe familjare, duke lutur Allahun fuqplotë që familjarëve t'u japë durimin, ndërsa rahmeti Rexhailit Zoti t'i falë xhenetin, thuhet në njoftimin e BFI-së. Sipas Televizionit Alsat-M, Rexhail Qerimi kishte ndërruar jetë më 27



janar, 2022, në moshën 53-vjeçare. Ish-ushitari i UÇK-së dhe ish-i burgosuri në vitet 80-të për paralelet shqipe në Kumanovë, gjeti vdekjen në kërkim të drejtësisë për rastin “Alfa”, shkruan TV Alsat-M.

Në qershor të vitit 2021 mbrojtja në rastin “Alfa” bëri ekspertizë të video-incizimit. Qendra për hulumtime forenzike në Serbi konstatoi se personat që vuajnë dënime me burg të përjetshëm për rastin

“Alfa” nuk kanë asnjë lidhje me personat nga video-incizimi i marrë si dëshmi për vendime gjyqësore të nivelit më të lartë. Për gati një vit Gjykata Penale dhe Prokuroria Publike e kishin zvarritur procedurën për rigjykimin e rastit, edhe pse Ligji i procedurës penale garanton se pas dëshmimeve që sjellin momente të reja rastet shkojnë në rigjykim, thuhet në raportin e Televizionit Alsat-M.

BËHET PËR RAHMET HAXHI HAMZI SINANI

Më 31 janar, 2022, është varrosur babai i shokut tonë Zulqfli ef. Sinani, rahmetli haxhi Hamzi Sinani, ka bërë të ditur Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Ai u përcoll për në banesën e tij të fundit nga një xhemat i madh, me pjesëmarrje të gjerë të hoxhallareve nga vendi ynë dhe jashtë, duke e lutur Allahun e Madhërishtëm që ta falë, ta mëshirojë dhe t'ia bëjë varrin e tij bahçe xheneti.

Haxhi Hamzi, rahmet i pastë shpirti, ishte i lidhur ngushtë me xhaminë, i gjallë e i pranuar në mesin e besimtarëve.

Përveç këtij fakti, familja e nderuar Sinani në Shkup e më gjerë njihet si një familje e cila gjithnjë është në shërbim të çështjes kombëtare dhe fetare, në shërbim të Islamit dhe të mbarë myslimanëve. Allahu (xh. sh.) e shpërbleftë me xhenet! – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në faqen



Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me myftinjtë dhe shoqëruarit tjerë, në ngushëllime te familja Sinani në Shkup.

e vet në Facebook.

Më 3 shkurt, 2022, në ngushëllime te familja Sinani në Shkup ka shkruar edhe Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Në faqen e vet në Facebook me këtë rast ai ka shkruar: “Vizitë ngushëllimi te familja Sinani, me rastin e ndërrimit jetë të haxhi Hamzi Si-

nanit, babait të hoxhës së nderuar Zulqfli Sinani. Vizitës i priu Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili. Me ne ishin edhe myftinjtë h. Sabahudin ef. Zendeli dhe z. Qamil ef. Rushiti, me bashkëpunëtorët e tyre. I bëjmë lutje Allahut Fuqplotë që rahmetiut t'i fal xhenetin, ndërsa familjes durimin.”

SHUHET DIJETARI EL-BENNA

Vdekja e dijetarëve është sikur shuarja e një ylli – ka shkruar në faqen e vet në Facebook hoxhë Besir Limani (Tetovë), duke njoftuar ndarjen nga jeta të dijetarit egjiptian, profesor në Amman (Jordani), Abdurrahim el-Benna.

Në njoftim më tej ai thotë: E ndaj

këtë pikëllim për vdekjen e profesorit tim nga Egjipti, që ligjëroi lëndët e Kiraeteve në Amman. Ishte dijetar, hafëz i dalluar i Kuranit dhe studiues i Kiraeteve. Do ta mbaj mend për historitë e ndryshme nga jeta e tij me lexuesit e mëdhenj të Kuranit që na tregonte, sepse i kishte shokë të

ngushtë: Menshaviun, Abdussamedin, Shaeshanin, Shahhatinin e të tjerë.

Më donte shumë dhe në ligjëratat e tij çdoherë, në mënyrë të veçantë, me çonte që t'i lexoja me Kiraete dhe pastaj do të më bënte komplimente me duatë e tij dhe më thoshte: “Ti je yll dhe ambasadori ynë në Evropë për Kiraetet.”

Allahu e mëshiroftë profesorin dhe dijetarin Abdurrahim el-Benna, thekson hoxhë Besir Limani. (26.01.2022)

STAMBOLL: NDËRRON JETË PACIFISTI DHE MENDIMTARI XHEVDET SAID

Më 30 janar, 2022, në një spital të Stambollit ndërron jetë mendimtari i njohur çerkezo-sirian Xhevdet Said. Gjyshi i tij, me origjinë çerkeze nga Kaukazi, në përfundim të luftës ruso-kaukaze në vitin 1864 bashkë me shumë refugjatë të tjerë të dëbuar vendoset në Bi'rul-Axhem, rrëzë maleve të Xhulanit (Golanit) në Siri.

Xhevdet Said ka lindur në fshatin e nënës së tij, në Ajn Zivan, më 9 shkurt 1931. Shkollën fillore e kryen në vendlindje. Në vitin 1958 shkon në Egjipt, për të studiuar në Universitetin e Ez'herit. Fillimisht mbaron studimet në lëmin e gjuhës dhe të letërsisë arabe, më pastaj vazhdon studimet e veçanta në degën e pedagogjisë.


Pjesën më të madhe të kohës e kalon në bibliotekat e Kajros dhe me këtë rast njoftohet me veprat e mendimtarëve më të njohur të botës islame, të së kaluarës dhe të kohës së tij. Është ndikuar shumë nga veprat e mendimtarit pakistanez Muhammed Iqbal. Mendimtarin algjerian Malik bin Nebi fillimisht e njeh nëpërmjet veprave të tij, ndërsa në vitin e fundit të tij në Egjipt e takon edhe personalisht.

Pas studimeve shkon në Arabinë Saudite, për të ligjruar në entet për shkollimin e arsimtarëve të rinj. Më vonë kthehet në Damask dhe fillon të punojë si mësues. Për shkak të mendimeve të tij, ai disa herë është arrestuar dhe liruar nga pushteti i partisë Ba'th në Siri.

RUAJTI PAVARËSINË E MENDIMIT DHE TË VEPRIMIT

Në vitet e 1970-ta kthehet në vendlindje, për t'u marrë me bujqësi dhe bletari. Ai në jetën e tij nuk është anëtarësuar në asnjë parti politike apo grup fetar. Ai gjithnjë e ka ruajtur pavarësinë e tij të mendimit dhe të veprimit.

Libri i parë i tij u botua në vitin 1966 me titull "Medh'hebi i parë i birit të Adem-it", ku ai e trajton çështjen e dhunës në lëvizjet islame nga fillimi i historisë islame e këndej. Ndër të tjera, në këtë libër ai e thekson faktin se "pejgamberët e Zotit gjithnjë e kanë zgjedhur metodën paqësore të veprimit dhe në procesin e ndryshimit social ata e kanë refuzuar për-



dorimin e dhunës."

Më pas, i ndjeri Xhevdet Said ka shkruar edhe libra të tjerë, ku ai e trajton në mënyrë të regjitur çështjen e ndryshimit shoqëror nga perspektiva islame. Të kësaj lloji janë veprat: "Derisa ata nuk e ndryshojnë atë që kanë në vetvete - Ligjet e ndryshimit individual dhe shoqëror", të cilin kam pasur mundësinë ta lexoj në përkthimin turqisht gjatë studimeve të mia në Bursa të Turqisë; pastaj "Humbja e baraspeshës shoqërore"; "Puna është aftësi dhe vullnet"; "Lexo, se Zoti yt është fisnik"; "Ji si i biri i Adem-it"; "Erërat e ndryshimit"; "Islami, Perëndimi dhe demokracia"; "Feja dhe ligji, një perspektivë kuranore" etj.

Ai i ka lexuar dhe studiuar mirë jo vetëm veprat e mendimtarëve myslimanë, por edhe të tjerë, botërorë, si: Herbert George Wells, Will Durant, Arnold Toynbee, Muhammed Arkoun, Michel Foucault, Jürgen Habermas, Pierre Bourdieu, Karl Popper etj.

KURANIN TA LEXOJMË BASHKË ME AJETET E GJITHËSISË

Besimi në një Zot (monoteizmi/tevhidi), sipas Xh. Saidit, nuk është thjesht

një çështje metafizike, qiellore, porse më tepër një çështje politike, sociale dhe tokësore. Të pranosh se ka vetëm një Zot të vetëm, nënkupton që edhe të gjithë njerëzit në sipërfaqen e tokës janë të barabartë. Ai priret dhe na këshillon që ajetet e Librit të Shenjtë (Kuranit) t'i lexojmë bashkë me ajetet (shenjat) e gjithësisë... Arsyeja njerëzore (el-akl) nënkupton një funksion si p. sh. shkrimin e një teksti, dhe nuk është një mjet si p.sh. lapsi. Është për të ardhur keq që njeriu kalon një jetë analfabeti dhe injoranti, që nuk e përdor arsyen e dhënë nga Zoti... Elektriciteti nuk përçohet përmes sendeve të thata dhe drurit; po kështu edhe ndryshimi i njeriut dhe i shoqërisë nuk bëhet përmes dhunës... Midis dhunës dhe mendimit (arsyetimit) ka një lidhje të kundërt. Sa më shumë që të shtohet mendimi dhe sa më shumë që të përndritet njeriu, aq më e qartë bëhet se sa e padobishme dhe e pakuptimtë është dhuna... Kurani nuk është doracak shkollor apo burim kryesor i njohurive mbi njeriun, mbi jetën dhe për atë se si është krijuar gjithësia. Burimi kryesor i këtyre është vetë gjithësia dhe hulumtimet shkencore... Gjithësia, duke u mbështetur në mësimet kuranore, nuk është një gjë "e krijuar dhe e mbyllur",

porse ajo vazhdon të krijohet vazhdimisht... Studimi dhe përcjellja e thatë e veprave të kulturës tradicionale islame, të shkruara nga ana e mendimtarëve myslimanë, nuk mjafton për ne sot për të dalë nga terri ku gjendemi... Elektricitetin në qoftë se e përdor sipas ligjeve të tij, ai do të të shërbejë ty pa asnjëfarë kushti, por në qoftë se e keqpërdor atë, ai do të godasë ty pa marrë parasysh fenë, ngjyrën apo racën tënde... Në qoftë se ti zbulon një fe dhe arrin t'i bindësh njerëzit në të, ty duhet shprehur urime për këtë! Mirëpo, në qoftë se ti ua imponon me dhunë njerëzve një fe, një mendim apo një doktrinë, kjo është në kundërshtim edhe me Zotin, edhe me natyrën njerëzore, por edhe me të vërtetën... Kjo nuk mund të pranohet në asnjë mënyrë... Ai që mundohet që fenë t'ia imponojë dikujt me dhunë, ai as nuk i beson Zotit e as që mbështetet në Fjalët e Tij kur thotë se "nuk ka dhunë në fe". Njeriu që ushtron dhunë për fenë, ai sikur nuk beson në vërtetësinë e kësaj feje dhe sikur dyshon në këtë fe. Në të njëjtën mënyrë ky nuk i beson as edhe njeriut, të cilit Zoti ia besoi "emanetin" (përgjegjësinë) universal...

Vrasja e "murteidit" (apostatit, atij që e braktis një fe) nuk ka të bëjë asgjë me Islamin e vërtetë. Ta pretendosh të kundërtën e kësaj, nënkupton abrogimin e parimit më themeltar të Kuranit fisnik... - janë disa nga mendimet dhe bindjet e Xhevdet Saidit, të cilat ai i ka përcuar me anë të ligjëratave, konferencave, intervistave të shumta nëpër vende të ndryshme islame dhe joislame, si: në Arabinë Saudite, në Emiratet e Bashkuara Arabe, në Algjeri, Egjipt, Liban, Katar, Bahrejn, Libi, Maroko, Iran, SHBA, Kanada, Gjermani, Francë, Belgjikë, Itali, Rusi, Kaukaz etj.

PËR NDRYSHIM PAQËSOR

Që nga fillimi i "Pranverës Arabe" ai është angazhuar për ndryshimin paqësor të individit dhe të shoqërisë dhe ka bërë thirrje të vazhdueshme kundër përdorimit të dhunës dhe formave të ndryshme të saj.

Me shpërthimin e luftërave në Siri, edhe vendbanimi i tij nuk u kursye nga dhuna, me ç'rast edhe vëllai i tij ndërron jetë. Për pasojë, ai me familjen e tij detyrohet të ikë për në Damask, e prej atje pa-

staj kalon në Stamboll të Turqisë. Mirëpo, librat e tij, mbi dhjetë sosh, kishin ardhur në Turqi para ardhjes së tij fizike në këtë vend, pasi që nga vitet e 1980-ta veprat më kryesore të tij ishin përkthyer tanimë në gjuhën turke. Duke qenë se ai e njihnte mirë gjuhën e çerkezëve, në Turqi ai ka krijuar kontakte me shumë shoqata e qarqe çerkeze, për të cilët ka mbajtur me qindra ligjëratat në gjuhën e tyre.

Në fillim të vitit 2021, në moshën 90-vjeçare, ai e ndërpret daljen në publik dhe mbajtjen e ligjëratave, duke iu përkushtuar familjes, fëmijëve dhe nipave e mbesave.

Ndërron jetë në moshën 91-vjeçare në një spital të Sambollit. Allahu e mëshiroftë, e mbuloftë me rahmetin e Tij të plotë dhe e shpërbleftë me Xhenetin Firdaus! Amin!

P.S.: Në web-faqen personale www.jawdatsaid.net mund të lexoni libra dhe artikuj të tij në gjuhën arabe dhe disa në atë angleze.

Përgatiti: **Rejhan Neziri, Kreuzlingen, Zvicër**

KALON NË AHIRET DR. SALAH EL-KHALIDI

Më 28 janar, 2022, ka ndërruar jetë njëri prej kolosëve të Islamit, dr. Salah el-Khalidi, ka shkruar dijetari islam nga Klina (Kosovë), Artan Musliu. Kush është Salah el-Khalidi? Në këtë pyetje përgjigjet mr. Artan Musliu, i cili në vitin 2012, në Prishtinë, ka botuar librin "Nga kolosët e kësaj feje".

Salah el-Khalidi, thotë ai në këtë libër, është një njohës shumë i mirë i komentimit të Kuranit. Ai është një personalitet i kalitur në duar të dijetarëve më eminentë të kohës, andaj edhe shquhet për diapazonin e gjerë të dijes.

Salah el-Khalidi është i lindur në qytetin e Xheninit, në Palestinë, më 1.12.1947. Fëmijëria i kalon në vendlindje, më pas shkon në Nabuls, për të vazhduar mësimet dhe njëkohësisht ky ishte edhe fillimi i rrugëtimit dhe i jetës së tij jashtë vendlindjes. Ka jetuar në Jordani. Shkollën e mesme dhe Fakultetin e Shkencave Islame i kryen në Az'har (Egjipt).


Në vitin 1977 regjistrohet për studime postdiplomike në universitetin islam "Imam Muhamed ibn Seud" në Riad të

Arabisë Saudite. Disertacioni i magjistraturës kishte temën "Sejid Kutubi dhe ilustrimi artistik në Kuran". Më vonë, në të njëjtin universitet, mbron doktoratën, ku për disertacion kishte zgjedhur tefsirin e Sejid Kutubit. Disertacioni titullohet "Fi Dhilal el-Kuran" (Nën hijen e Kuranit; studim dhe vlerësim).

Është autor i 44 librave. Nga librat e tij më të njohur do të theksojmë: Sejid Kutub, esh-shehid el-haji; Thevabit li el-muslim el-muasir; Ixhaz el-Kuran el-bejani; Hakaik kuranije havle el-kadije el-filistinije etj.

Kur përmendet emri i tij, shumicës së njerëzve u shkon mendja tek Sejid Kutub dhe mendojnë se në mes tyre ka ndonjë lidhje, por këtë e ka mohuar vetë dr. Salah el-Khalidi, i cili ka treguar se asnjëherë nuk është takuar personalisht me të, por se e ka njohur përmes librave dhe shkrimeve të tij – thuhet në librin "Nga kolosët e kësaj feje" të mr. Artan Musliu.

Për dr. Salah el-Khalidin kanë shkruar edhe Muhamed Stublla, dr. Rijad Imeri, Eljasa Mahmudi e të tjerë. Allahu e mëshiroftë dijetarin e Ummetit dhe në Ahi-



ret e bashkoftë me pejgamberët, me shehidët, me dijetarët dhe me njerëzit e devotshëm – kanë shkruar tre dijetarët e përmendur shqiptarë.



Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com